




TERRENE

*tetë vështrime
mbi Spaçin*



Artan Puto Nebi Bardhoshi Anna Shkreli
Alen Bejko Ledi Shamku-Shkreli
Sokol Çunga Arba Baxhaku
Antonela Pepkolaj







Ky botim është realizuar në kuadër të projektit SHPIRTËRIM i cili zbatohet nga Tek Bunkeri me mbështetjen e programit EU4Culture, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga UNOPS, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Tek Bunkerit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS.

Tekstshkrues:

Artan Puto, Nebi Bardhoshi, Anna Shkreli
Alen Bejko, Ledi Shamku-Shkreli, Sokol Çunga,
Arba Baxhaku, Antonela Pepkolaj

Përgatiti për botim:

Anna Shkreli

Redaktoi:

Antonela Pepkolaj

Korrektoi:

Antonela Pepkolaj



Dizajni dhe grafikati:

Trivet

Printimi:

West Print

Botues:



Tek Bunkeri

@2025

TERRENE

*tetë vështrime
mbi Spaçin*

PËRMBAJTJA

06

PARATHËNIE

*KUJTESA DHE PËRFAQËSIMI NË
HISTORIKUN E KAMPIT TË SPAÇIT*

16

SIGURIMI I SHTETIT DHE RRJETI
I BASHKËPUNËTORËVE NË KAMPIN E SPAÇIT

Artan Puto

30

MBI FIGURËN E ARMIKUT
NË SHOQËRINË E LUFTËS

Nebi Bardhoshi

46

KAMPI SI LABORATOR I KONTROLLIT
TË DYFISHTË:
ROLI I EFEKTIVIT NË MAKINERINË E SPAÇIT

Anna Shkreli

60

MINIERA-KAMP E SPAÇIT: MAKINA
E KAPITALIZMIT SHTETËROR

Alen Bejko

70

SPAÇI SI KRIPTË E FJALËS

Ledi Shamku-Shkreli

92

PEIZAZHI I HESHTJES ARKIVORE:
RASTI I REPARTIT 303, SPAÇ, MIRDITË

Sokol Çunga

104

MUZEALIZIMI I SPAÇIT?
(OSE RREZIKU I HARRESËS SË XHELATËVE DHE
VIKTIMAVE TË TYRE)

Arba Baxhaku

118

DIELLI KA NGJYREN E PIRITIT

Antonela Pepkolaj

PARATHËNIE

KUJTESA DHE PËRFAQËSIMI NË HISTORIKUN E KAMPIT TË SPAÇIT

“I live beneath the heartbeat of this crime like peeling an onion to reveal a bruise.”

Vi Khi Nao, Opium

Ky vëllim mbledh tetë shkrime që i qasen kampit të punës së Spaçit nga këndvështrime të ndryshme, duke ndjekur një metodë ndërdisiplinore që vendos në dialog fusha të shumta: historinë politike, që ndriçon mekanizmat e pushtetit dhe represionit, nga Artan Puto dhe Anna Shkreli; ekonominë, që zbulon dimensionin e shfrytëzimit përmes punës së detyruar, nga Alen Bejko; antropologjinë, që shqyrton figurën e “armikut të popullit” dhe pasojat e saj, nga Nebi Bardhoshi; arkivistikën, që e sheh Spaçin edhe përmes boshllëqeve e heshtjeve dokumentare, nga Sokol Çunga; arkitekturën, që merret me dilemën e ruajtjes apo transformimit të vendit si hapësirë përkujtimore, nga Arba Baxhaku; gjuhësinë, që vë në dukje mënyrat se si fjala e fshehtë u bë mjet identiteti dhe rezistence, nga Ledi Shamku-Shkreli; dhe, së fundi, letërsinë, e cila rikrijon përmes trillimit atmosferën dhe përjetimet që shpesh mungojnë në dokumentin historik, nga Antonela Pepkolaj.

Përmbledhja nuk synon të japë një përkufizim të vetëm mbi Spaçin, por të nxisë një proces mendimi dhe reflektimi mbi këtë hapësirë. Secili tekst rrok një objekt të veçantë dhe një stil e metodologji të ndryshme, por të gjitha e trajtojnë Spaçin si një pikëtakim të dhunës politike, përvetësimit të trupit individual dhe kolektiv, ekonomisë shtetërore, kontrollit shoqëror dhe etikës së kujtesës. Këto “pika nervore” nuk qëndrojnë në distancë nga njëra-tjetra; përkundrazi, ndërveprojnë si shtresa që zbulojnë të njëjtën hapësirë nga kënde të ndryshme dhe përndonjëherë kontradiktore.

Për shembull, leximi historik i Spaçit si repart i lëvizshëm pune i shfrytëzuar për objektiva industriale, nuk bie ndesh me përshkrimin e tij si një kamp represiv — përkundrazi, e thëllon kompleksitetin e makinës bluajtëse të dhunës shtetërore. Spaçi përfaqëson dualitetin karakteristik të kësaj dhune: të dënuarit

nuk ishin vetëm armiq ideologjikë, por edhe burim i llogaritur fuqie punëtore për një regjim që ngrinte objekte industriale në emër të popullit, ndërkohë që një pjesë të tij e shfrytëzonte dhe e mbante të nënshtruar. Kjo marrëdhënie midis shtetit, punës së detyruar dhe ideologjisë, e trajtuar në tekstin mbi Repartin 303, gjen rezonancë në analizën antropologjike të mënyrës se si shteti shpiku, prodhoi dhe trashëgoi figurën e armikut. Këto dy qasje, ekonomiko-institucionale dhe antropologjike, të shoqëruara dhe nga analiza strukturës së mekanizmit represiv, vendosen më pas në marrëdhënie me problemin e përfaqësimit, që e tejshkon përmbledhjen si fill i kuq: si mund të rrëfëhet Spaçi sot? A kemi mjaftueshëm dokumentacion? A mund të mbrohet kujtesa pa u kthyer në spektakël? A ekziston një mënyrë për të ruajtur autenticitetin e traumës pa e estetizuar, apo neutralizuar, përmes diskursit muzeal? A është kujtesa një set praktikash në kohë? Këto pyetje shfaqen në mënyrë të drejtpërdrejtë në analizat e këtij libri rreth Spaçit.

Pavarësisht stilit dhe gjuhës së ndryshme, të gjithë shkrimet orientohen nga qasja reflektuese kritike, një nevojë e domosdoshme e kohës dhe qëllim kryesor i nismës për të hartuar këtë libër. Me ndërrimin e kohëve, rënia e “mureve” politike nuk u reflektua në mënyrë të menjëhershme edhe në psikën kolektive. Ndaj dhe fill në këtë hapësirë transitore mes represionit drejt lirisë, aty në mes, reflektimi kalon dytësor ndaj komunikimit. Kësisoj, shumë prej prodhimeve kulturore e letrare të kohës së tranzicionit u shkruan për të qenë tepër të drejtpërdrejta dhe imediate.

Ky konstatim është i rëndësishëm për të kuptuar mënyrën se si është ndërtuar diskursi mbi burgun e Spaçit. Gjatë viteve të para pas përfundimit të diktaturës, pjesa më e madhe e shkrimeve dhe dëshmimeve mbi këtë kamp u prodhuan në një nivel *memoiristik*. Kjo formë e shkrimit ishte një nevojë e menjëhershme: dëshmia individuale edhe rrëfimi i drejtpërdrejtë përbënin një akt të domosdoshëm shëruës, si për individin që e shkruante, ashtu edhe për shoqërinë që e lexonte. Në këtë periudhë, komunikimi i shpejtë dhe i drejtpërdrejtë mbizotëronte ndaj reflektimit, duke pasqyruar një gjendje ku, edhe pse individët ishin liruar tashmë nga struktura e shtetit represiv, hija e tij vazhdonte të rëndonte mbi shprehjen kolektive.

Pas më shumë se tri dekadash, është krijuar një distancë kohore që mundëson një tjetër lloj qasjeje: atë të shkrimit kritik-kontemplativ. Kjo qasje shkon përtej përshkrimit të

dhimbjes dhe dëshmisë emocionale, duke hapur rrugë për një analizë më të thelluar. Kështu, teksa rrëfimet e para kishin funksionin e ruajtjes së kujtesës së drejtpërdrejtë dhe të shërimit shoqëror, sot bëhet e domosdoshme një fazë e dytë: ajo e analizës kritike.

Zgjedhja stilistike për të vendosur pranë njëri-tjetrit autorë me formime të ndryshme nuk është rastësi. Stilet e larmishme janë të nevojshme për të sjellë në dritë një realitet të shumëfishtë si Spaçi. Shkenca historike e ka kufizimin e vet: shpesh dokumentacioni është i cunguar, i humbur, i manipuluar apo i mbyllur nga burokracia e kohës. Këto shqetësime përfaqësimi përforcohen nga problemet e dokumentimit, të ngritura dhe nga dy prej esëve në libër. Edhe pse tekste të veçanta në këtë vëllim mbështeten në punë kërkimore mbi burime arkivore, qasja ndaj Spaçit si objekt historik përballet me boshllëqe të mëdha dokumentare.

Në arkiva, Spaçi është i dokumentuar si objekt sigurie, por jo si përvojë njerëzore. Mungesa e të dhënave mbi jetesën e përditshme, mbi vdekjet dhe mbi kushtet në kamp zhvendos gjithë procesin e kujtesës të dëshmitë individuale. Kështu, kujtesa historike ndërtohet jo mbi bazën e autoritetit shtetëror, por përkundër tij. Ndaj pra është menduar që në krye të herës që ky libër të projektohet për t'u mbyllur me një tregim, i cili vjen si *memento* i rëndësisë së letërsisë në ruajtjen e kujtesës historike. Këtu dëshiroj të hap edhe shtegun e fundit të mendimit, pasi në këtë kuptim, përfshirja e një tregimi fiksional në fund të këtij vëllimi nuk është thjesht një shtesë formale, por një zgjedhje thelbësore editoriale për vetë diskutimin rreth proceseve të kujtesës kolektive.

Si mund t'u referohemi historive të parrëfyera? Atyre që nuk kanë hyrë në "historinë zyrtare", që nuk mbijetojnë në dokument? Letërsia, përmes imagjinimit, bëhet një mënyrë për të përfytyruar atë që mungon, për të rikrijuar atmosferën dhe përjetimin njerëzor atje ku historia e shkruar nuk arrin. Tregimi i fundit, i bazuar mbi qindra rrëfime të ngjashme, i jep trajtë një përvojë që është njëherësh sa individuale aq edhe kolektive. Ai është një mënyrë *për të kujtuar duke imagjinuar*.

Kështu, vëllimi nuk mbyllet me një "përfundim", por me një hapje: duke e lënë kujtimin si proces, të papërfunduar, të aftë të prodhojë ende hapësira të reja. Të ndalesh të kujtesa, duke e përdorur si emër do të thotë të mbyllësh një proces, ta bësh të duket i përfunduar. Të mendosh ama për të kujtuarin si folje, si një veprim që ndodh, që

vazhdon, është ta shohësh kujtesën si një akt që na përfshin sot e përgjithmonë. Të kujtuarit nuk është vetëm rikthim i së kaluarës, por edhe njohje e potencialit të ndryshimit. Borges na kujton se mes kujtesës dhe procesit të kujtimit, çelet një hapësirë shoqërore, me praktika të vetat dhe procese të tëra. Të kujtosh, do të thotë të hysh në atë hapësirë shoqërore dhe ta transformosh. Ndaj do të thotë gjithashtu të imagjinosh.

Nëse kujtimi është një mënyrë për të dhënë llogari për historinë, atëherë vetë historia është në lëvizje të vazhdueshme, në mutacion të pandërprerë. Ky libër, me stilet e tij të ndryshme dëshmon se të kujtuarit nuk është një arkiv i ngrirë, por një proces i hapur që krijon hapësira të reja dialogu, dhe ashtu projektohet drejt së ardhmes.

Pyetja rreth zërave të munguar në rrëfimin e historisë rikthehet pra: Kush tregon? Si në rastin e arkivave, ashtu edhe në atë të muzealizimit fizik, ndonëse palët e “heshtura” janë të kundërtat, në dukje kontradiktore, sërish shqetësimi i ngritur konvergjon. A mund të jetë kjo ‘histori e ritreguar’ plotësisht përfaqësuese?

Ky botim është realizuar në kuadër të projektit SHPIRTËRIM i cili zbatohet nga Tek Bunkeri. Qëllimi i tij është të shtojë një gur në themelet e kulturës së kujtesës, duke u ofruar lexuesve jo një të vërtetë të mbyllur, por një mozaik reflektimesh që i afrohen së shkuarës nga kënde të ndryshme. Projekti është mbështetur nga programi EU4Culture, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga UNOPS, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

*SIGURIMI I SHTETIT
DHE RRJETI
I BASHKËPUNËTORËVE
NË KAMPIN E SPAÇIT*

ARTAN PUTO




KUJTESA DHE PËRFAQËSIMI NË HISTORIKUN E KAMPIT TË SPAÇIT

Pushteti komunist që u vendos në Shqipëri në nëntor të 1944, dhe pa fundin e tij në dhjetor të 1990, ka qenë më jetëgjati dhe, pa dyshim, më dogmatiku, më represivi dhe më gjakësori në krejt Europën Lindore. Ai mbeti një regjim i modelit më të ashpër stalinist. Në këtë pikë duhet thënë se ndryshe nga vendet e kampit socialist të Evropës Lindore, të cilët njohën njëfarë moderacioni në sistemin e tyre pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, mbajtur në shkurt të 1956, Shqipëria komuniste i mbeti besnike deri në fund dogmës staliniste.

Në atë kongres, udhëheqësi i atëhershëm komunist sovjetik, Nikita Hrushov, denoncoi krimet e Stalinit dhe më pas në vendet e “demokracive popullore” të Evropës Lindore filloi një valë zbutjeje e politikave represive ndaj atyre që konsideroheshin si “elementi armik” brenda vendit. Kështu, filloi ai proces që mori emrin “destalinizimi”.

Përkundër kësaj, Shqipëria komuniste e Enver Hoxhës mbeti deri në fund shembulli më emblematic i shtypjes politike ndaj atyre njerëzve që, në mënyrë arbitrare e pa respektuar asnjë të drejtë njerëzore, cilësoheshin si “armiqtë e popullit”. Një regjim i tillë i pamëshirshëm ishte rezultante e disa faktorëve. Në radhë të parë komunistët erdhën në pushtet pas Luftës së Dytë Botërore, një luftë që i kishte parë ata të luftonin, kryesisht si guerilas, ndaj pushtuesve të huaj, por që i kishte vënë në barrikada të ndryshme edhe kundër atyre grupeve politike shqiptare që kishin bashkëpunuar me fashistët italianë dhe nazistët gjermanë.

Fakti që rreshtimi i komunistëve shqiptarë kundër Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore përcaktoi edhe të ardhmen e vendit: Shqipëria pas luftës u bë pjesë e kampit socialist të Evropës Lindore e udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik i Stalinit. Ndërkohë, konflikti i përgjakshëm i Luftës së Dytë Botërore do të vinte edhe vetë shqiptarët kundër njëri-tjetrit në një luftë për pushtetin e pasluftes, komunistët kundër nacionalistëve dhe legalistëve. Kjo përçarje e thellë do të përcaktonte edhe situatën e represionit në vend menjëherë pas Çlirimit. Komunistët fitimtarë do të hakmerreshin me të mundur duke i përndjekur, izoluar dhe eliminuar ata që



konsideroheshin si “tradhëtarë, bashkëpunëtorë të pushtuesit, armiq të pushtetit popullor” etj.

Situata e terrorit dhe e represionit e pasluftës do të ishte një konstante e pushtetit të komunistëve në Shqipëri gjatë gjithë ekzistencës të tij edhe për shkak të ideologjisë komuniste që ai propagandonte. Një element qendror i saj ishte e ashtuquajtura “lufta e klasave”, e cila synonte të krijonte në vend një gjendje tensioni të vazhdueshëm, një terror psikologjik ndaj atyre që mendoreshin se ishin elementë “armiq të brendshëm” që komplotonin ndaj sistemit socialist, por dhe një ndjenjë paranoje në krejt shoqërinë. E tërë kjo tablo shkaqesh duhet të shikohet edhe në një kontekst të caktuar historik e social të vendit.

Natyra e egër dhe represive e regjimit komunist në Shqipëri nuk duhet parë e ndarë nga historia e shtetit dhe e shoqërisë shqiptare. Këta komponentë historiko-kulturorë janë shumë të rëndësishëm për të shpjeguar pse komunizmi shqiptar ishte ai që ishte dhe nuk njohu asnjëherë ndonjë fazë moderacioni, siç ndodhi në vendet e tjera të Evropës Lindore.

Pa mohuar interesat e pushtetit personal të Enver Hoxhës dhe të faktit se udhëheqësi i Partisë së Punës me kalimin e kohës do të kthehej në një despot absolut në vend, vështirimi duhet të përfshijë edhe krejt historinë e shtetit shqiptar dhe të natyrës së shoqërisë shqiptare. Shteti shqiptar, që u shpall si i pavarur në nëntor 1912 nga Ismail Qemali, por që filloi të hedhë hapat e parë të ekzistencës reale të tij vetëm nga fillimi i viteve 1920, do të ishte fillimisht pré e Luftës së Parë Botërore e më tej e kaosit dhe trazirave brenda vendit që shkaktonin përplasjet midis grupeve të ndryshme politike për pushtet. Më tepër se grupe politike ato ishin, në radhë të parë, grupime interesash të caktuara klanore, krahinore, të cilat arbitrarisht visheshin me petka të përkatësive politike, si “progresistë, nacionalistë, demokratë” etj.

Më tej sundimi u përqendrua te figura e një njeriu të vetëm si Ahmet Zogu, që ishte fillimisht një president dhe më tej u vetëshpall si mbret (1925-1939). Tërë periudha e sundimit të tij u karakterizua nga autokracia dhe, kështu, ky vend nuk njohu asnjëherë formë të qeverisjes demokratike. Për më tepër, format e regjimeve varen edhe nga lloji i shoqërive mbi të cilat ata sundojnë. Shoqëria shqiptare që doli nga Lufta e Dytë Botërore ishte një shoqëri tejet e prapambetur rurale e malësore, thellësisht patriarkale dhe fisnore, ku shumë më tepër se individit kishte rëndësi klani dhe mjedisi i origjinës.

Një shoqëri e tillë, me një ind urban të pazhvilluar, do të ishte vazhdimisht nën peshën e dhunës.

Autoriteti të cilin kjo shoqëri njihte më mirë ishte pushteti i njeriut të fortë, i atij që ushtronte në mënyrë arbitrare dhunën, shtypjen e eliminimin e kundërshtarit për të përçarur politikat e tij. Ndaj këtij lloj pushteti shoqëria shqiptare reagoonte po me akte dhune sporadike, ose më shpesh duke u përshtatur e duke përfunduar e nënshtruar.

Ky kuadër është i nevojshëm për të kuptuar atmosferën e frikës dhe terrorit që u vendos nga komunistët në vend menjëherë pas Luftë, e gjithashtu për të shpjeguar edhe ekzistencën e gjatë të pushtetit të tyre gati gjysmëshekullor. Gjithsesi, këtu duhet nënvizuar se kohëzgjatja e regjimit komunist në Shqipëri i detyrohet shumë edhe ndarjes së Evropës në dy kampe armike gjatë Luftës së Ftohtë (1944-1990). Ky kontekst gjeopolitik i kishte ngrirë sistemet politike në kontinent duke pamundësuar ndryshime rrënjësore në vendet që u përkisnin bllokut të NATO-s në Perëndim dhe kampit socialist në Lindje.

INSTITUCIONET E REPRESIONIT: SIGURIMI I SHTETIT, BURGJET DHE KAMPET

Për t'u kthyer te natyra e regjimit komunist në Shqipëri, ajo mund të shpjegohet edhe më mirë nëpërmjet njohjes së institucioneve të tij të represionit. Dy ishin drejtimet kryesore të represionit: 1-për të mbajtur në gjendje frike dhe tensioni të vazhdueshëm shoqërinë, u krijua që në krye të herës Sigurimi i Shtetit, ose ajo që mund të përshkruhej si “policia sekrete e regjimit komunist”, dhe 2- për të izoluar dhe ndëshkuar ata individë që konsideroheshin si “armiqtë e pushtetit popullor” u ngritën burgje e kampe të punës së detyruar.

Deri në vitin 1948, regjimi i Enver Hoxhës ishte nën ndikimin e fortë të Jugosllavisë së Titos. Komunistët jugosllavë e ndihmuan Hoxhën të merrte drejtimin e Partisë Komuniste kur ajo u krijua në nëntor 1941, të ushtronte rolin e udhëheqësit gjatë zhvillimit të Luftës dhe në vitet e para pas Çlirimit. Kjo ndihmë ishte një ndihmë politike, ekonomike, por edhe në krijimin e një aparati shtetëror represiv, sipas modelit bolshevik. Këtu hynte edhe krijimi i një strukture që do të merrej me shërbimet e inteligjencës, që duhej të godiste

[1] Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH). (1945). Fondi 14/AP, dosja 7.

[2] Dervishi, K. (2012). Sigurimi i Shtetit 1944–1991: Historia e policisë politike të regjimit komunist (f. 25). Shtëpia Botuese 55.

[3] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AMPB). (1948). Fondi 48, dosja 29 (fl. 1).

[4] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AMPB). (1954). Fondi 48, dosja 160 (fl. 37).

[5] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AMPB). (1958). Fondi 49, dosja 378.

[6] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AMPB). (1966). Fondi 49, dosja 862.

[7] Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH/AP). (1977). Fondi 14, dosja 28.

[8] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AMPB). (1985). Fondi 4, dosja 18 (ff. 3–4).

[9] Po aty.

armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të pushtetit komunist të Hoxhës.

Për vetë rëndësinë e tij, shërbimi i inteligjencës u krijua nga pushteti komunist në dhjetor të 1944, vetëm 2 javë pas mbarimit të Luftës.¹ Duke ndjekur modelin jugosllav, fillimisht ai quhej Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit. Në vitet e para të ekzistencës së saj Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit ishte më shumë një forcë agresive ushtarake sesa një zyrë e shërbimit të inteligjencës. Në vitin 1946, përsëri nën shembullin jugosllav u kthye në *Sigurimi i Shtetit*. Sigurimi i Shtetit u bë një nga drejtoritë më të rëndësishme të Ministrisë së Brendshme. *Sigurimi i Shtetit* u bë tani një strukturë që u shtri në të gjithë territorin e vendit, duke bërë të mundur që çdo rreth të kishte degën e tij. Rëndësia e Sigurimit brenda strukturave të Ministrisë së Brendshme do të shtohet gjithnjë e më shumë. Ministria e Brendshme tani do të kishte 2 drejtori kryesore, Drejtorinë e Sigurimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.²

Pas shkëputjes me Jugosllavinë më 1948, Shqipëria komuniste hyri në periudhën e miqësisë shqiptaro-sovjetike që vazhdoi deri në vitin 1961. Sigurimi i Shtetit në periudhën sovjetike do të shënonte edhe institucionalizimin e kësaj strukture brenda Ministrisë së Brendshme si një njësi “sigurimi”, por mbi të gjitha si një strukturë që ushtronte terror. Një nga pasojat më direkte dhe të rëndësishme ishte konsolidimi i rolit primar të Partisë së Punës së Shqipërisë mbi Sigurimin e Shtetit, dhe hartimi periodik i platformave të Sigurimit nga Byroja Politike e PPSH.

Në këtë mënyrë platformat e ndryshme të Sigurimit të Shtetit, të hartuara nga Byroja Politike në 1948³, 1954⁴, 1958⁵, 1966⁶, 1977⁷, 1985⁸ dhe 1989⁹, konfirmuan dhe përforcuan supremacinë e Partisë dhe kontrollin e vazhdueshëm dhe ciklik të organeve të Sigurimit nga strukturat e Partisë. Këto platforma përcaktuan edhe 4 nivelet e bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit, që në vija të përgjithshme nuk do të ndryshonin me kalimin e kohës.

Shteti komunist e kishte organizuar shoqërinë e asaj kohe mbi bazë klasore, ku klasa më e rëndësishme ishte “klasa punëtore” dhe e “fshatarësisë kooperativiste”, të shoqëruara nga ajo që quhej “inteligjencia popullore”. Teorikisht kjo ishte baza sociale mbi të cilën mbështetej regjimi, por në praktikë gjërat ndryshonin, sepse “të dënuarit politikë” në një pjesë të mirë vinin edhe nga këto shtresa. Ajo që nuk ndryshonte

ishte ekzistenca e përhershme e “elementit armik”. Pushteti komunist kishte gjithmonë nevojë për armiq, në mënyrë që të legjitimonte parimin e “luftës së klasave”. Kësisoj, shoqëria ndahej edhe në familje me “biografi të mirë”, familje komuniste dhe mbështetëse të regjimit dhe, nga ana tjetër, në familje me “biografi të keqe”, që konsideroheshin si armike ndaj sistemit.

Në kushtet e një sistemi politik tejet të centralizuar, siç ishte ai komunist, çdo individ, apo grup social e kishte të përcaktuar vendin dhe rolin e tij në shoqëri. Edhe në aspektin e bashkëpunimit me Sigurimin e Shtetit rolet ndaheshin në varësi të prejardhjes sociale të personit. Ata bashkëpunëtorë që vinin nga “familjet me biografi të mirë” dhe ishin besnikë të regjimit kryenin rolin e “bashkëpunëtorit rezident” apo atij që quhej “strehuesi”. Këto dy lloje bashkëpunëtorësh mbanin të informuar organet e Sigurimit nëpër qendra pune dhe ofronin shtëpitë e tyre për takimet sekrete që punonjësi i Sigurimit organizonte me bashkëpunëtorët e tij në terren. Bashkëpunëtorët e Sigurimit në terren duhej të vinin, nga ana tjetër, nga ato familje që kishin “biografi të keqe”. Këta ishin “informatori” dhe “agjenti”. Bashkëpunëtorët e këtyre kategorive vinin nga shtresa e “familjeve me biografi të keqe”, sepse vetëm nëpërmjet tyre mund të depërtohej në ambientet e elementit “reaksionar” dhe, nga ana tjetër, ishte një grup social më i shantazhueshëm duke qenë se jetonin në kushte shumë të vështira si të persekutuar të regjimit.¹⁰

Pas prishjes me sovjetikët në vitin 1961, Enver Hoxha do të fillojë të hedhë themelet e një aleance të re ideologjike, por mbi të gjitha ekonomike, me Kinën komuniste të Mao Ce Dunit. Kjo periudhë do të vazhdonte deri në vitin 1978. Ndihma kineze për Sigurimin ishte më tepër një ndihmë teknike duke sjellë në vend mjete dhe aparatura të reja që ndihmonin kryesisht në përndjekjen dhe përgjimin e popullsisë.

Pas periudhës së miqësisë shqiptaro-kineze, nga viti 1978 e deri në 1990, do të pasojë ajo që quhet “periudha e izolimit” dhe që do të shënojë edhe fundin e pushtetit komunist në vend. Përveç rolit udhëheqës të Partisë në çështjet e Sigurimit, një karakteristikë e kësaj periudhe është përqendrimi gjithnjë e më i madh i goditjes ndaj atyre që konsideroheshin si “armiq të brendshëm”. Sa më shumë që vendi rrëshkiste drejt izolimit nga bota e jashtme, aq më agresiv bëhej Sigurimi në “zbulimin e armikut të brendshëm” dhe të “mbrojtjes së jetës së udhëheqësve të partisë”. Izolimi ishte një faktor vendimtar në përfitim të një sensi paranoje dhe të të jetuarit si në rrethim.

[10] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AMPB). (1954). Fondi 48, dosja 160 (ff. 24–32).

[11] Artan Puto, *Historik i shkurtër i Repartit të riedukimit 303 në Spaç-Mirditë 1951–1991* (Tiranë: CHWB, 2022), f. 30. Shih edhe, Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste* (Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, 2015). Femi Sufaj, *Historia e Burgjeve të Shqipërisë gjatë shekullit XX* (Tiranë: Shtëpia Botuese Albin, 2000).

[12] Të gjitha të dhënat në lidhje me kampin e Spaçit janë marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, Dega e Punëve të Brendshme Mirditë, Dosja e objektit të rëndësisë së veçantë Rep. 303 Spaç (Nr. 123, 21 maj 1979), Arkivi i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, deklasifikuar me vendimin nr. 7, 5 prill 2018.

Metoda e dytë e rëndësishme e ushtrimit të terrorit në vend ishte edhe krijimi i një rrjeti të tërë burgjesh dhe kampesh të punës së detyruar. Kjo karakteristikë e regjimit u duk që në vitet e para të regjimit. Kështu në vitin 1950, kur vendi kishte rreth 1.2 milionë banorë, 1 në çdo 132 vetë ishte në burg, ose 753 të burgosur për 100.000 banorë.¹¹ Një ndër vendet më të tmerrshme të vuajtjes ishte i ashtuquajtimi “Reparti 303 i riedukimit në Spaç-Mirditë”, ose siç njihet gjerësisht me emrin, **Kampi i Spaçit**.

“Reparti 303 i riedukimit” u krijua në vitin 1951 dhe deri në vitin 1968 shërbeu si kamp lëvizës i punës së detyruar.¹² Në vitin 1968 u vendos përfundimisht në Spaç të Mirditës dhe do të shfrytëzonte punën e detyruar të të burgosurve në minierën e bakrit aty. Më tej bakri do të çohej në fabrikën e pasurimit të Repsit, që ndodhej jo larg nga miniera. Vetëm disa kohë më vonë, në fillim të 1969, Kampi i Spaçit do të kishte dosjen e tij si “objekt i rëndësisë së veçantë” në Degën e Punëve të Brendshme (ana e Sigurimit të Shtetit). Kjo donte të thoshte se Kampi i Spaçit do të kishte një status të veçantë për sa i përket kontrollit të rreptë, të cilit do t’i nënshtroheshin të burgosurit.

Nga pikëpamja administrative, kampi i Spaçit kishte të njëjtin organizim me atë të një reparti ushtarak: komandanti i kampit, komisari, operativi i Sigurimit, që ishin ushtarakë, së bashku me disa oficerë të tjerë që kryenin detyra të posaçme. Në bazë ishte toga e policisë për shërbimin e brendshëm, toga e ushtarëve për shërbimin e jashtëm dhe prapavija, ku përfshiheshin shefi i stërvitjes, kartelisti, financieri, mjeku ushtarak dhe mjeku i dënuar, zyra teknike, këshilli i riedukimit. Komandanti i kampit ishte i ngarkuar me mbarëvajtjen administrative ushtarake të kampit dhe me sigurimin e rregullit. Komisari merrej më shumë me pjesën riedukuese në kamp dhe ndiqte punën ideologjike, siç ishte leximi i veprave të E. Hoxhës, i gazetës, mbikëqyrte shkrimin e parullave politike nëpër muret e godinave të kampit, ndiqte dhe atë që quhej “përgatitja ideo-politike” e efektivit të policëve dhe ushtarëve.

Oficer tjetër i rëndësishëm i kampit ishte edhe kartelisti. Kartelisti ishte i ngarkuar me mbajtjen e kartelës së çdo të burgosuri në kamp. Ai kishte si detyrë edhe leximin/kontrollin, po ashtu edhe censurën e të gjitha letrave që familjarët u dërgonin të burgosurve dhe, anasjellas, të letrave që të burgosurit u dërgonin familjarëve apo institucioneve shtetërore. Te këto letra bënin pjesë edhe raportimet e fshehta që të dënuarit bashkëpunëtorë i dërgonin oficerit operativ me denoncimet e tyre për bashkëvuajtësit.

OPERATIVI DHE RRJETI I BASHKËPUNËTORËVE NË SPAÇ

Spaçi ishte kamp i punës së detyruar për të burgosurit, qofshin këta politikë, por edhe ordinerë. Ai ishte parashikuar të mbante deri në 500 të burgosur, por në të vërtetë në kohë të caktuara, si në fillimvitet 1980, mbajti afërsisht 1.100 të burgosur. E tërë kjo masë njerëzore duhej shfrytëzuar jo vetëm për të punuar në kushte çnjerëzore në minierë, por edhe duhej mbikëqyrur vazhdimisht. Dhe në këtë pikë vijmë te detyrat që kryenin oficeri i Sigurimit në kamp (operativi) dhe rrjeti i bashkëpunëtorëve të tij në mesin e të burgosurve.

Oficeri i Sigurimit (operativi) në kamp ishte ndër figurat më të rëndësishme. Ai ishte njëkohësisht ushtarak në administratën e kampit, por varej drejtpërdrejt nga Dega e Punëve të Brendshme të rrethit ku ndodhej kampi, në rastin tonë të Mirditës. Rrjeti agjenturor i operativit të kampit përbëhej nga “rezidenti”, “agjenti” dhe “informatori”. Këtu duhet nënvizuar se rrjeti agjenturor që ngrihej në kamp nuk kishte si objektiv vetëm të burgosurit, por edhe efektivin ushtarako-policor që punonte aty, me qëllim kontrollin e besueshmërisë së tyre dhe moskomprometimin e tyre nga të burgosurit.

Bashkëpunëtorët e operativit në kamp rekrutoheshin me “shtrëngim” kryesisht nga radhët e të dënuarve për agjitacion e propagandë dhe, në radhë të dytë, nga ata të dënuar për arratisje. “Shtrëngimi” presupozonte se i dënuari, që duhej rekrutuar si bashkëpunëtor i operativit, vihej para alternativës “ose të bashkëpunonte, ose të ridënohej përsëri”.

Agjentura punonte në bazë turni (i punës në minierë), në bazë brigade (në bazë të grupit të punës brenda në minierë) dhe në bazë dhome (fjetine). Nga ana tjetër, të dënuarit bashkëpunëtorë punonin në bazë të vendbanimit, d.m.th., bashkëpunëtorët nga Tirana informonin për të dënuarit nga Tirana dhe në bazë të rrethit shoqëror që krijonin të dënuarit në kamp.

Puna e operativit në kamp edhe e bashkëpunëtorëve të tij duhet parë në evolucion dhe në varësi të situatave politike që kalonte vendi. Në vitin 1978, kur Enver Hoxha do t'i ndërpriste marrëdhëniet me Kinën dhe vendi do të hynte në izolim nga bota e jashtme, do të vërehet një rritje e numrit të të burgosurve politikë. Në maj 1978, në kampin e Spaçit do të kemi 850 të dënuar politikë kundrejt vetëm 40 të burgosurve ordinerë. Këtë masë të dënuarish operativi i kampit e mbulonte me 48 bashkëpunëtorë, nga të cilët 6 informatorë kontrollonin “pastërtinë” e efektivit ushtar e polic.¹³ Meqë vendi ishte gjithnjë e më i izoluar nga bota e jashtme, do të shtohet frika e veprimtarive “armiqësore” brenda vendit dhe kjo do të shoqërohet me më shumë të dënuar nëpër kampe dhe burgje. Agjencia në Spaç do të punonte kryesisht për të zbuluar ato që quheshin si “grupazhet armiqësore”, “agjentët jugosllavë dhe ata grekë”.

Disa muaj më vonë, në nëntor 1978, të dënuarit politikë do të ishin 934 dhe vetëm 27 të dënuar ordinerë. Në këtë rast do të kemi edhe më shumë mbikëqyrje ndaj efektivit të kampit, përderisa numri i bashkëpunëtorëve që do ta kontrollonte atë do të rritej në 9. Atmosfera e represionit dhe e paranojës do të shikohet edhe nga fakti që në vitet 1977-1978 janë ridënuar për “krime kundër shtetit” 9 të dënuar, ndërsa në vitin 1979 janë ridënuar 40 vetë.¹⁴

Puna e të dënuarve bashkëpunëtorë të operativit në kamp do të mbetet gjithmonë aktive edhe kur nga mesi i viteve '80 numri i të dënuarve politikë në Spaç do të pësojë rënie në krahësim me të dënuarit ordinerë. Kriza e thellë ekonomike dhe varfërimi i skajshëm i viteve '80, që u ndie shumë pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën në 1978, do të shtonte krimet ordinere, gjë që do të reflektohet te rritja e numrit të të dënuarve të kësaj kategorie edhe në Spaç. Në vitin 1985 në kampin e Spaçit do të kishte 294 të dënuar politikë, ndërkohë që kishte rreth 900 të dënuar ordinerë. Në këtë kohë një i dënuar bashkëpunëtor do të mbikëqyrte 21 të dënuar politikë, ndërkohë që për të dënuarit ordinerë kjo mesatare do të ishte një për 90 të dënuar.¹⁵

[13] Puto, A. (2022). *Historik i shkurtër i Repartit të Riedukimit 303 në Spaç-Mirditë*. Cultural Heritage Without Borders.

[14] Puto, A. (2022). *Historik i shkurtër i Repartit të Riedukimit 303 në Spaç-Mirditë*. Cultural Heritage Without Borders.

[15] Po aty.

Edhe nga pikëpamja teknike, puna e oficerit operativ në kampin e Spaçit do të ndryshonte nga mesi i viteve '80, sepse do të futej më tepër në përdorim Teknika Operative (TO), mikrofona të vegjël që mbaheshin në trup nga të dënuarit bashkëpunëtorë për të përgjuar bashkëvuajtësit. TO do të shërbente për të bërë përpunimet e të dënuarve që ishin objekt hetimesh në kamp, por gjithashtu edhe për të vërtetuar besnikërinë e agjenturës në mesin e të dënuarve. Kjo do të thoshte se edhe vetë i dënuari bashkëpunëtor kontrollohej nga një tjetër bashkëpunëtor.

Megjithatë, puna e oficerit operativ të kampit të Spaçit nuk mjaftohej vetëm brenda kampit. Duke qenë se Spaçi ishte një “objekt i rëndësisë së veçantë”, dilnin detyra edhe në drejtim të popullsisë së zonës përreth, në mënyrë që ajo të ruante sekretin e ekzistencës së kampit dhe të ishte në gatishmëri me çeta vullnetare në rast se do të kishte arratisje nga kampi. Nga ana tjetër, oficeri operativ kishte përgjegjësi që edhe i gjithë personeli ushtarak e civil i Spaçit të ruante sekretin e “objektit të rëndësisë së veçantë”. Për këtë arsye, edhe vetë personeli i kampit do të mbahej nën mbikëqyrje të fshehtë nga bashkëpunëtorët e oficerit operativ.

Kampi i punës së detyruar në Spaç është një pasqyrë në miniaturë, ndonëse në kushte shumë ekstreme, e krejt kondicionit të shoqërisë shqiptare në atë kohë. Një shoqëri e izoluar nga bota e jashtme, e përgjuar, e kontrolluar në çdo hap të jetës, por edhe e dorëzuar para faktit se kishte përballë një pushtet që dukej në të njëjtën kohë si i gjithëfuqishëm dhe i përjetshëm.

Spaçi mund të shërbejë më mirë se cilido vend tjetër në Shqipëri për të kuptuar se deri në çfarë mase shkonte shtypja, tmerrri pa fund i vuajtjes, por edhe shpresën e vakët e përpjekjet për mbijetesë. Këto të fundit përmbledhnin sa shfaqjet e rralla të dinjitetit njerëzor, aq edhe atë që gjendet rëndom mes njerëzve: dobësinë, mjerimin e degradimin moral të qenies njerëzore kur gjendet e vetme para forcës shtypëse të një shteti totalitar dhe kur zgjedhja mes jetës a vdekjes shndërrohet në një ritual të përditshëm. Për të gjitha këto arsye Spaçi duhet ruajtur e kthyer në një vend kujtese edhe për faktin se rritja e distancës kohore nga periudha e regjimit komunist, e bën gjithnjë e më të vështirë për brezat e rinj ta kuptojnë drejt atë kohë; dhe ajo kohë duhet kuptuar mirë, pasi na ndihmon shumë për të kuptuar edhe të tashmen tonë.

REFERENCA

Dervishi, K. (2012). *Sigurimi i Shtetit 1944–1991: Historia e policisë politike të regjimit komunist*. Shtëpia Botuese 55.

Dervishi, K. (2015). *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*. Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Lubonja, F. (1994). *Ridënimi*. Botime Përpyjekja.

Lubonja, F. (2021). *Jetë burgu*. Skanderbeg Books.

Puto, A. (2022). *Historik i shkurtër i Repartit të Riedukimit 303 në Spaç-Mirditë*. Cultural Heritage Without Borders.

Sufaj, F. (2000). *Historia e burgjeve të Shqipërisë gjatë shekullit XX*. Albin.

*MBI FIGURËN
E ARMIKUT
NË SHOQËRINË E LUFTËS*

NEBI BARDHOSHI



Me fitoren e revolucionit tonë popullor, Partija mori masa që mbi gjëmadhat e pushtetit të vjetër feudal-borgjez në Shqipëri të ngrihej pushteti popullor. Bashkë me vendosjen e pushtetit popullor në vendin tonë, Partija komuniste sot P.P. SH, duke u mbështetur në mësimet e pavdekshme të Marksizëm-Leninizmit, mori masa për krijimin e Organeve të diktaturës së proletariatit të cilët do të mbrojnë nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm pushtetin popullor dhe punën paqësore të popullit tonë gjatë periudhës së ndërtimit socialist të vendit.

(Historiku i Burgut të Spaçit, 2022)

Armiku ‘nën ruajtje’ ishte emërtimi burokratik që shteti komunist u jepte të burgosurve politikë. Kjo ese është një reflektim mbi figurën e armikut dhe të shtetit brenda burgut, brenda kampit të riedukimit, i njohur si burgu i Spaçit. Në fund, do t’u rikthehem mëtimeve teorike, të cilat përmbajnë një skicë për mënyrën se si mund të analizohet më tej regjimi komunist në Shqipëri, parë si regjim që shpiku dhe mbajti brenda vetës gjendjen e luftës dhe të revolucionit si gjeneratorin kryesor të shpikjes së armikut. Një luftë dhe revolucion, paraqitur bazuar në materializmin historik, që në praktikën staliniste-shtetërore kërkoi të jetë edhe i shenjtë.

ARMIKU I POPULLIT, ARMIKU NËN RUAJTJE, SHOQËRITË E ARMIKUT

Sidoqoftë, Spaçi u shndërrua në vendin kryesor të ndëshkimit të *armiqve nën ruajtje*, siç quheshin të burgosurit politikë.

Vërtet, burgu i Burrelit ishte më i rëndë për shëndetin dhe për sistemin nervor, por atje ndiheshe më i sigurt, sepse edhe liria e veprimtimit ishte më e kufizuar. Kurse kampi ishte më i hapur ndaj rreziqeve. Aty ndodhnin revoltat, aty kishte më shumë shanse për t’u arratisur, por edhe më shumë mundësi për të përfunduar i varur nga roja. Aty ishte edhe puna në galeri, e cila kishte rreziqet e veta. Në kamp kishte shumë më tepër të bëje me policinë; mjaftonin ato tre apelime në ditë, ku shpesh të linin të prisje në shi, vetëm për të të provokuar.


Aty kishe më shumë gjasa të grindeshe deri në vdekje me të dënuarit e tjerë, pasi kur punoje në galeri, kishe mjete të hekurta në duar. Kishte më shumë mundësi që të palosnin me akuza të rreme, sepse e kishin më të lehtë të gjenin dëshmitarë të rremë.¹

Veç të burgosurve politikë, kishte edhe të burgosur ordinerë që formësonin një ndarje binarike brenda kategorisë së të burgosurve.

Të burgosurit ordinerë ishin ata që kishin kryer vepra të zakonshme penale. Kurse të dënuarit politikë ishin ata që u kishte rënë për hise të klasifikoheshin si armiq të popullit. Armiku i popullit ishte njëherazi armik i klasës punëtore, i partisë, i atdheut dhe i shtetit. Ngjizja e popullit me partinë, me klasën punëtore dhe me shtetin realizohej nëpërmjet konceptit të diktaturës së proletariatit. Themi “u bie hise” sepse, më shumë sesa vërtetësia e akuzës, të dënuarit shpikeshin sipas valëve politike. Të burgosurit politikë ishin shpallur armiq sepse binin ndesh me vijën ideologjike. Se kur shkelej kjo “vijë”, këtë e zbulonte dhe e shpikte – apo shpik-zbulonte – vetë shtetiparti me në krye Udhëheqësin Kryesor.

I burgosuri ordiner mund ta kalonte më lehtë provën e burgut, duke mbetur me një shenjë riparimi që e ndiqte, por Partia dhe njerëzit e saj edhe mund ta heshtnin apo ta ripararonin; mund, por nuk ndodhte shpesh. I dënuari politik do të përndiqej gjithmonë nga shenja e armikut, edhe pse kampet e burgjet quheshin vende riedukimi, ato ishin më shumë vende ridënimi dhe dënimesh të vazhdueshme (Pllumi, 1995, Lubonja 2018, 2021).

Dallori tjetër mes një të burgosuri ordiner dhe atij politik vinte nga kushti i luftës. Nëse do të shpërthente luftë me armiq të jashtëm, thuhej se të dënuarit ordinerë do të luftonin kundër tyre, me mundësinë për t’u shpallur dëshmorë, heronj apo ushtarë të dalluar, dhe kështu të shndërroheshin në familje patriotike ose familje dëshmori. Ose, të paktën, të kishin një histori të rikthimit. Në rast lufte, armiq të ende gjallë brenda burgjeve do të dënoheshin menjëherë me vdekje, sepse armiq të brendshëm supozohej se mund të ishin aleatë të armiqve të jashtëm.



Na ndante prej tyre një distancë ajrore rreth njëqind metra, por edhe një tjetër – më e madhe – në trajtim. Sa herë vinin autoritetet, i takonin dhe u thoshin se në rast lufte atyre do t'u jepnin armë për të luftuar për atdheun, ndërsa neve do të na pushkatonin.²

Qenia e të dënuarit, e aq më tepër e atij politik, nuk ishte thjesht një shpirt e trup më vete.

Trupi dhe shpirti i tij shtriheshin në farefisni – mes të gjallëve dhe të vdekurve, mes të lindurve, paraardhësve dhe pasardhësve. Rrethi farefisnor i armikut të popullit formësonte të ashtuquajturën “farefisni të prekur”. Politikisht, kjo përkonte me atë që quhej “familje me biografi me cene” ose “me biografi të keqe”. Shtrirja e këtij statusi në familje dhe përtej saj, në farefisni, varej nga humori politik i Diktatorit dhe i burokracisë partiake.

Koncepti më tronditës brenda të prekurve ishte ai i “bijve të armiqve”. Në autobiografi të ndryshme gjejmë shumë dëshmi që tregojnë se momenti më i rëndë për të burgosurit politikë ishte ai kur u thuhej publikisht ose në hetuesi, se ky status do të ndiqte edhe bijtë e tyre. Kësisoj, shpikja e statusit të armikut, karakterizohej nga rishpikja dhe rishpërndarja e këtij statusi në rrethin familjar e miqësor.

Pasosshmëria e statusit të armikut të popullit ushqehet nga kujtesa institucionale.

Kjo ndodhte nëpërmjet prodhimit të dokumenteve dhe ridënimit të personit, edhe kur ai/ajo vazhdonte të ishte i/e burgosur. Nëse ndodhte ndonjë harresë apo lapsus nga burokracia, dikush kujtohej të denonconte, demaskonte, zakonisht me anë të një letre. Ia rikujtonte Partisë se kush kishte qenë njëherë armik, mbetej armik përgjithmonë. Përhapja e dëshirës popullore për të interpretuar dëshirën e Partisë, sidomos përmes vigjilencës, dëshmon për kapilaritetin e konceptit të armikut. Dëshira e Partisë përkonte me mësimet e Udhëheqësit Kryesor, dhe të dyja këto shpreheshin edhe në ligjet e shtetit.

Në antropologjinë e armikut, dërgimi i *letrave* – qofshin publike apo anonime – do të duhej të konsiderohej një dëshmi kyç.

Çdo njeri që kërkonte një vend pune, që kandidonte për anëtar partie, që aplikonte për të drejtë studimi, promovim apo transferim, duhej të plotësonte një skedë. Skeda formulonte pyetje për biografinë personale dhe familjare. Ndër të tjera, pyetjet për qëndrimin e familjes gjatë Luftës së Dytë Botërore: ishte me “ne” apo me “ata”? Kjo ndarje, ndonëse erdhi pas Luftë, u kthye në pikënisjen e gjurmimit historik të armikut të brendshëm dhe të jashtëm. Këtu niste gjenealogjia e armikut të klasës. Më pas brenda klasës, u shfaqën armiq të tjerë sipas valëve politike. Strukturë të ngjashme me skedën e biografisë personale kishin pretencat e prokurorisë. Nisnin me historinë e fitoreve që pushteti popullor kishte arritur ndaj armiqve, e vijonte me armiq e fitore të pafundme, për të renditur si fitoren e radhës dënimet që duhej të jepeshin për të akuzuarin e radhës.

Nëse dikush nuk kishte qëndruar në anën “e drejtë”, nëse nuk ishte nga klasa e duhur sociale, nëse kishte të arratisur ose njerëz që banonin jashtë shtetit, atëherë biografia e mirë bëhej thuajse e pamundur. Megjithatë, përmes heshtjes, miqësive apo ndërmjetësimeve, mund të krijohej një lloj amnezie për biografinë e keqe – deri në momentin kur shfaqej ndonjë letër apo kritikë publike. Ndaj farefisnia nuk është vetëm një hallkë e shpërndarjes së të keqes, ka qenë edhe si vatër e rezistencës, por edhe e kompromiseve. Ndaj, shtoj se antropologjia e armikut nuk e rrok dot të gjithë shtrirjen kulturore të armikut politik, pa rrokur edhe rolin e farefisnisë në politikë.

Një farefisni politike, nga: “fillimi i botës së re” e deri në rënien e kësaj bote nganjëherë edhe sot në ndonjë parti, kërkohet të provohej. Kështu lindi një subjekt farefisnor ndërvarur me partinë shtet. Kjo i shtonte pasosshmërisë dhe sosshmërisë së statusit të armikut një tjetër dimension.

Për regjimin socialist duket se kanë qenë tabu dy vija, kalimi i këtyre vijave ka qenë prova kryesore e krijimit të armikut të popullit. Njëra simbolizonte Partinë, tjetra Atdheun, kalimi i tyre të bënte armik dhe tradhtar.

Këto dy vija janë vija e partisë dhe vija e kufirit, të dyja vijat janë kushtetuese në gjeografinë e regjimit totalitar. Vija e Partisë ushqehet nga urdhra, mësimet, ligje, libra, broshura. Vija e Partisë artikulohet dhe merr trajtat e Mësimeve të Diktatorit, dhe vetë Mësimet e Diktatorit ushqejnë vijën e Partisë. Ndërsa vija kufitare ka një marrëdhënie me atdheun dhe shtetin.

Atdheu dhe shteti shndërrohen në ‘socialist’. Në ‘shtet socialist’, ‘atëdhe socialist’, një ideal në letër, një industri terrori në përditshmëri. Brenda tyre kemi shoqëri socialiste, kulturë socialiste.

Vija e Partisë është ajo që ndan shoqërinë dhe njerëzit në miq dhe armiq. Kush ikte nga atdheu socialist, ose e mendonte apo imagjinonte, kishte konsumuar veprën penale të kalimit [ose tentativës] të paligjshëm të kufirit. Ta kalosh, tentosh apo planifikosh të lësh atdheun tënd socialist, konsiderohej tradhti. E para, të “arratisesh” prej vendit socialist, ishte të refuzosh “dhuratën” shtetërore e partiake për t’u bërë njeri socialist; e dyta, ti s’mund të lije një vend të tillë, pa pasur një plan kundër rendit socialist – pra vijës së Partisë. Shkurt, të dyja vijat pikëpriteshin duke formësuar një gjeografi dhune.

Shumë nga të burgosurit e Spaçit ishin njerëz që kishin tentuar të arratiseshin. Kështu dëshmojnë Agim Kollçaku, Ahmet Islami, Ali Leka, Demi Abazi, Gëzim Kulloli...

Siç dëshmon vetë Fadil Daja, kur ishte ushtar në Shishtavec, Kukës, u arratis për në Jugosllavi. Arrin në kampet e Lubjanës, teksa ishte në pritjen 6-mujore për të shkuar në SHBA ose Kanada, e sollën në Shqipëri, si pjesë e shkëmbimit në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Pas torturash dhe përcmimi në publik e dërguan në Tiranë. U bë gjyqi dhe u dënua fillimisht me pushkatim. Me sa duket, përveç shkeljes së kufirit, iu bashkuan edhe akuza të dezertimit nga ushtria dhe bashkëpunimit me armikun. Më pas ia falën jetën. Gjyqtari i kërkon të shprehet se çfarë do të thotë ai për këtë falje që po i bënte Partia. Përgjigjja e Fadil Dajës: “Faleminderit Partisë që më edukoi dhe më dënoi!”.

Edhe Doktor, personazh te *Jetë Burgu* (shih Lubonja, 2021:206-218) që kishte dashur të arratisë për të takuar të dashurën e vet, ushtronte tradhti ndaj shtetit. Kur ra komunizmi, historia e tij u bë film dokumentar në Çeki. Pak kohë doktor i zhvendos me banim në Pragë. Por historia e jetës së tij mbyllet me vetëvrasje. U tha se u hodh nga kati i dytë. Bashkë me veten, vrau edhe shumëkënd! Na la dëshminë se dhimta e formësuar nëpër burgje ia kalon kohës politike. E se, disa kohë politike nuk dinë, nuk munden, ose nuk duan të ndihmojnë në kalimin e kësaj dhimte.

Të burgosurit e tjerë ishin shkelës të Vijës së Partisë, të cilët ose kishin qenë që në krye të herës, ose ishin shndërruar në të tillë.

RIDËNIMI I VAZHDUESHËM ISHTE PRAKTIKË E ZAKONSHME.

Kishte të dënuar, si Lazër Radi, që nga direktivat e para të Enver Hoxhës, para vitit 1944, e deri në fundin e regjimit, mbetën të burgosur – duke jetuar një gjendje të pasosur burgimi. Ky ridënim zgjatej paralelisht me dënimin duke shkatërruar çdo shpresë për lirim, duke rrënuar ose vënë në provë marrëdhëniet familjare. Kjo ndërvarësi ishte dypalëshe. Edhe të burgosurit mund të dënoheshin më rëndë për shkak të veprimeve të të afërmeve që ishin shpallur rishtazi armiq.

Siç shkruan Solzhenitsyn tek *Arkipelagu Gulag*:

O, të bekuara qofshin ato tirani të pamëshirshme, ata despotizma, ato vende të egra, ku një person i arrestuar njëherë nuk mund të arrestohet për herë të dytë! Ku, duke qenë në burg, nuk mund të riburgoset. Ku një person i gjykuar njëherë nuk rigjykohe më për të njëjtën vepër! Ku një i dënuar nuk mund të dënohet sërish! ... Por në vendin tonë, çdo gjë është e lejueshme.³

[3]

Solzhenitsyn, A. (2012).
Arkipelagu Gulag (f. 245).
Tiranë: Princi.

KUFIZIME TË IMËTA E TË THELLA - TË PAPARASHIKUARA

Rroba të përcaktuara; ngjyra të përcaktuara; hapësirë vetëm për burra; kohë e kontrolluar; muzikë e kontrolluar; leximet e rregullta nga “mësimet” e Diktatorit; ushqim i kufizuar, në sasi dhe cilësi; pjesë të caktuara – veç ujë, cigare, ilaçe, dhe mjekim i kufizuar sipas humorit të administratës së burgut. Lajmet ishin të përcaktuara: vetëm për sukseset e Pushtetit Popullor dhe për humbjet e armiqve, që thyheshin në burgjet e çelikut të unitetit Parti-Popull.

Ngjyrat ndryshojnë në varësi të bjerrjes së veshjeve, ngjyrat e veshjes në vartësi të kohës së dënimit, frontit të punës, nivelit të bashkëpunimit me Pushtetin, e më pak nga këto, nga mundësia dhe higjiena e shija estetike e të dënuarit. Si ngjyra e rrobave ndryshonte edhe ngjyra e lëkurës dhe e shëndetit të të burgosurit. Ditët numërohen me orë dhe duken të pasosshme, gjymtime trupi, herë si torturë, herë si mënyrë për të shmangur punën rraskapitëse dhe pa përfitim. Në frontin e punës ka dallime.

Mjerë ai që ka për të bërë shpime. Megjithatë, ka syresh që gjejnë një kënaqësi të vetëshkurtimit të ditëve të jetës, si formë përgjigjeje ndaj burgut. Ka prej tyre që shkelin moralin, jo vetëm socialist, por edhe të armikut të popullit, teksa ndokush imagjiron martinelin si një *fallus* që ushtrohet me gjithë vitalitetin e tij. Privimi seksual, loja e jeta seksuale në burg, duket sikur janë gëzimi kryesor i shtetit totalitar. Them këtë se ky vjen si dënim i heshtur – i heshtur nga kodet kulturore, heshtur nga shteti.

Statusi politik e familjar, dhe vetë dënimi, lidhej me pjesën akoma më të heshtur nga politika apo akti kundër Pushtetit Popullor – seksualiteti. Të dënuarit klasifikoheshin nga ligji, por po aq rreptë edhe nga njëri-tjetri për sjelljen seksuale.

Ardhja e “autoburgut” ishte e lidhur me ardhjen ose jo të ‘mishit’ të ri. Mishi i ri ishte simbolikë e djemve të rinj, potencial për të dashur apo për t’u dhunuar. Kishte të rinj që ishin në burg dhe sosën jetën në burg pa pasur kurrë një përvojë seksuale jashtëburgase. Kishte të dënuar pse kaluan kufirin për të shkuar tek e dashura e tyre që jetonte ‘jashtë shtetit’. Kishte të burgosur që pengun e jetës kishin se nuk u martuan dot kurrë, apo s’patën fëmijë. Kishte të burgosur që nuk e ndanë gruan që befas u klasifikua si armike apo spiune, pas shtetësisë së saj. Në vendimet e të dënuarave, krahas dënimit e ridënimeve, shënohej statusi martesor. Kur sheh aty-këtu të divorcuar, kupton se këtu, më shumë se askush, ndërhyri Partia, për ta ndarë botën e armikut me botën e Partisë!

Burgu ka një mensë, vend që përsëritet riti i të ngrënit dhe më tepër, i urisë. Uria shfaqet te disa të burgosur si psikozë. Ka një kuzhinë, që në gjirin e totalitetit të pronësisë së përbashkët quhet ‘Private’. Hapësirë tjetër janë banjat, një vend për t’u takuar, shkëmbyer ndonjë marrëdhënie të dhunshme, por edhe ndoshta dashurie, aq sa ç’kishte lënë mundësi ajo hapësirë përulëse. Banja shërben edhe si vend për të fshehur gjëra të vogla, marrë apo vjedhur. Në burg vidhej, blihej, shitej, dhurohej, por mbi të gjitha duket se shkëmbehej, si shenjë e të qenit subjekte që japin e marrin. Shkëmbim sendesh si shkëmbim fjalësh – herë veç për hir të shkëmbimit, herë për të marrë atë që të duhet më shumë nga ajo që jep, herë për hir të njohjes me tjetrin. Sende që flasin, sende që heshtin, sende që spiunojnë, sende që dëshmojnë apo që duket që spiunojnë.

Burgu është gjithnjë një vend sprove e dinjitetit njerëzor. Burgjet politike akoma më shumë. Si vend veçimi, izolimi, dënimi e ridënimi, burgu bëhet vend njohjeje e shpërnjohjeje. Njohje e pakujt që mund të rezistojë e kultivojë dinjitetin më të epërm. Shpërnjohje e shpërbërje e dinjitetit të njeriut nën kurthin e lloj-lloj sprove. Siç vijnë dëshmitë, çdo burg politik ka pasur një rrjet të burgosurish që ishin bashkëpunëtorë. Më shumë se uria, i ftohti, lëndonte prania e bashkëpunëtorit. Shndërrimi i të dënuarit në bashkëpunëtorë të sigurimit, dëshmon mosndalimin e përçmimit, përluljes dhe dënimit të pasosshëm. Në fakt dëshmon shkallën më cinike të pushtetit. Për shkak të pranisë së bashkëpunëtorit, hijes dhe ekzistencës reale të tij, burgu është vend besimi dhe mosbesimi ekstrem. E megjithatë, figura e bashkëpunëtorit ka një shpëtim për të mos qenë e fundit në hierarkinë e burrnisë së burgut! Më poshtë qëndron figura e pederastit. Me e ulëta e të ulëtave është bashkimi i figurës së pederastit dhe të spiunit në një.

Pas këtyre paralajmërimeve, një i burgosur i ri që shihte se i afrohej një “pervers” ngase e shihte si femër, si “bythqirë” apo si “sumçe”, dhe se mund ta tallnin për këtë në rastin më të parë. Duhej të tregonte se nuk ishte i tillë. Përndryshe i takonte të pranonte poshtërimet, që ishte edhe më i rëndë se sa poshtërimet e pësuar nga ata që kishin pranuar të bëheshin spiunë.⁴

[4] Lubonja, F.
(2021). *Jetë burgu*. Tiranë:
Skanderbeg Books.

Veç dënimit dhe ridënimit, që shpallen në dokumente zyrtare, ka edhe disa dënime tjera, që sërish cimbërojnë thellë në ndërgjegjen dhe shpirtin e të burgosurit. Edhe ato janë pjesë e sistemit të shkëmbimit, ose shkëmbimprivimit! Këto dënime s’janë të vogla, por të imëta e intime, ndaj ato janë therëse e të thella. Nuk kanë dënime kapitale, por kapilare, jo publike, por të heshtura dhe tinëzare (Pllumi, Lubonja, 2018, 2021).

Hegja e pasqyrës si mjet për ta parë shndërrimin e vetvetes çdo ditë nuk ishte e shkruar ndokund. A të duhet gjë të shihesh në pasqyrë kur je duke vuajtur burgun si armik i popullit?! Për atë që është jashtë burgut ngjan e pakuptimtë, por duket se ndalimi i pasqyrës ka qenë zbulim i një humori të administratës së burgut. Më duket një hegje e së drejtës për të parë shndërrimin tënd të shkaktuar nga burgosja e dhimbje të tjera, paraparë e mosparë nga ligji. Të burgosurit e Spaçit kishin tregtuar copa pasqyrash.

Dënim tjetër therës ishte vrasja e kafshëve që depërtonin a lindin në burg. Fatkeqë ishin ato kafshë që lidheshin me të burgosurit. Herët a vonë këto kafshë dënoheshin pa gjyq! Diku në kthinat e burgut. Për shembull, vrasja e maces që rriste dikush. Dikush që kishte macen si fëmijë, të tjerë që e shikonin si mundësinë e vetme për të shprehur dashuri e respekt. Dënime cinike ishin rreshtoret, lëniet në pritje, ndryshimi i fronteve të punës, mosvënia në dijeni për çfarë pritet të ndëshkohet apo se ku do të transferohet i burgosuri e plot të tjera si këto.

Lirimi dhe dënimi, ose dënimi dhe lirimi, u ndërlidhën me vijimësinë e regjimit. Për të ekzekutuarit me vdekje do duhet folur një tjetër herë. Vijimi i dënimit dhe i ridënimit të eshtrave të tyre, kërkojnë të tjera energji për të reflektuar. Zhdukja e eshtrave, dënimi i të vdekurit pas vdekjes e për rrjedhojë, edhe statusi politik i eshtrave të ‘armikut’, shkurt kufizimi dhe heqja e së drejtës së varrimit dhe varrit të armikut të popullit, është një kalim tabuje. Shkelja e tabusë së të drejtës së varrimit është hapje e një humnere kulturore. Për të nisur të kuptuarit e kësaj humnere ndihmon disi tragjedia *Antigona*, e Sofokliut. Por, kur humnera bëhet pjesë e ligjit penal, atëherë duhet parë çfarë humnere kulturore krijon prania historike e Anti-Antigonës. S’është tepri të hedhim mëtime për një “shoqëri të armikut”, formësuar me breza nga e shkuara dhe e ardhmja, varësisht revolucionit shtetëror.

NJË ANTROPOLOGJI PËR BURGUN DHE SHOQËRINË E ARMIKUT

Për një antropologji të armikut është e nevojshme ndërtimi i një hermeneutike që ngërthen, brenda vetes, gjuhën dhe praktikën e luftës dhe të revolucionit si elemente përbërëse të regjimit. Regjimi socialist, në variantin e tij stalinist, shpiku dhe institucionalizoi një *gjendje të jashtëzakonshme*, e cila në teorinë politike duhej të ishte kalimtare dhe atribut i sovranit (Schmitt, 2005). Për më tepër, kjo gjendje e jashtëzakonshme u përfut në sistemin ligjor dhe politik. Përkohshmëria e tij u ngjiti

tek ideja se socializmi ishte një rend kalimtar drejt komunizmit, por që askush nuk e dinte se kur do të përfundonte regjimi socialist.

Kjo gjendje e jashtëzakonshme, përveçse e justifikuar me arsye time ideologjike, mori formën e një lufte me tri dimensione, ose të trefishtë: fillimisht, si luftë kundër botës së vjetër dhe pushtuesve të jashtëm; më pas si mbrojtje e arritjeve të revolucionit socialist; dhe së fundi, si luftë klasash brenda vetë shoqërisë, në kuadër të një kalimi të përhershëm drejt komunizmit. Brenda kësaj triade të luftës, revolucioni shfaqej si projekt pa fund – *revolucion permanent*, në kuptimin që nuk përmbillet kurrë, por rinis gjithmonë për të përmbushur një qëllim gjithmonë të paarritur (Arendt, 1973; Szakolczai, 2017).

Në këtë kontekst, figura e armikut nuk kishte më funksion vetëm mbrojtës: ajo bëhej figura themeluese e rendit politik. Lufta dhe revolucioni nuk mund të përfundonin pa eliminuar armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, dhe pa formësuar njeriun e ri. Kjo kërkonte sakrifica të vazhdueshme – sakrifica trupash, ndërgjegjesh dhe vlerash – të cilat përdoreshin si garanci morale dhe politike për rrugën drejt së ardhmes (Girard, 1977). Veçse figura e armikut nuk ishte e denjë për sakrificë. Armiqtë, realë apo imagjinarë, duhej të zhdukeshin. Nevoja për ta shpikur figurën e armikut prodhonte, në të njëjtën kohë, edhe nevojën për *gjendjen e jashtëzakonshme* dhe për vazhdimin e revolucionit (Goldman, 2011).

Askush nuk ishte realisht i përjashtuar nga mundësia për t'u shpallur armik. Ligji nuk kërkonte më një shkelje konkrete; lypsej vetëm ekzistenca e një nevoje politike për armiq. Në këtë mënyrë, totalitarizmi nuk funksiononte thjesht si rend i dhunës, por si rend i *pasosshmërisë së dënimit*, ku ligji zhdukej për t'i hapur rrugë një etike të dënimit të autorit, dhe përjashtimit të pafund të tij e të të afërmeve (Arendt, 1970; Mbembe, 2019).

Kjo gjendje politike mund të lexohet si një *liminalitet i institucionalizuar* (Szakolczai, 2017; Thomassen, 2014), i prodhuar nga shteti i kapur prej partisë, i cili merrte përsipër të realizonte kalimin e popullit nga një rend inferior në një rend superior, nga historia në utopi. Shteti-parti bëhet kështu një makineri e kohës dhe e hapësirës, që jo vetëm udhëheq, por edhe krijon justifikime për dështimet nëpërmjet ekzekutimeve dhe privimeve. Në këtë regjistër regjimor, sakrifica nuk mjafton: nevojitet edhe *antisakrifica* – figura e atij që pengon kalimin, që sfidon shenjtërinë e mësimeve ideologjike dhe që, për këtë arsye, duhet eliminuar.

Një tjetër mekanizëm i brendshëm i kësaj logjike shtetërore është *dëshira mimetike* (Girard, 1987). Përtej veprimit të drejtpërdrejtë të organeve shtetërore të dhunës, është dëshira për imitim të dhunës që e kapilarizon shpikjen e armikut dhe nevojës për sakrifica dhe dhunë të imët e të vazhdueshme. Kjo dëshirë mimetike mund të shndërrohet edhe shoqërore dhe shndërrohet në energjinë kryesore për t'u përfshirë në procesin e përjashtimit dhe zhdukjes së tjetrit, e shpërndan dhunën në të gjitha porët e jetës shoqërore, duke e bërë atë të përditshme dhe banale. Ndërsa në kohën kur ky regjim bie, duket se këtë dëshirë të shpërhapur sociale, e mbulon më mirë se asgjë tjetër një amnezi mimetike dhe instrumentale.

Në këtë kuptim, pra pikënisur prej antropologjisë së burgut, totalitarizmi nuk është thjesht një regjim i kontrollit dhe i dhunës, por një regjim i pamundësisë për paqe dhe në thelb i pamundësisë për politikë pa armiq; njëfarë shpirti i politikës spartane - do të thoshte Platoni. Figura e armikut nuk është vetëm emergjente, por ontologjike për rendin totalitar, dhe vetë prania e shpikja e armikut ia hap gjithnjë shtegun një kulture totalitarizuese. Dënimi dhe përjashtimi nuk janë instrumente kalimtare të drejtësisë, por rituale të përhershme të *konstituimit të rendit përmes dhunës* dhe, njëherazi, përpjekjes së pasosshme për të legjitimuar këtë dhunë, si të domosdoshme dhe madje, pjesë të misionit të shenjtë. Shfaqja e termit të shenjtë në fund të kësaj eseje nuk është rastësore, por është një ftesë për të parë se si edhe e *shenja* përvetësohet e përthithet brenda botës totalitare. Pasi rendi socialist u mundua të zaptojë brenda trupit të vet jo thjesht një luftë apo revolucion dosido, por edhe materialist dhe të shenjtë.

REFERENCA

Arendt, H. (1970). *On violence*. New York: Harcourt, Brace & World.

Arendt, H. (1973). *The origins of totalitarianism*. New York: Harcourt, Brace & World.

Girard, R. (1977). *Violence and the sacred* (P. Gregory, Trans.). Baltimore: Johns Hopkins University Press.

Girard, R. (1987). *Things hidden since the foundation of the world*. Stanford: Stanford University Press.

Goldman, W. Z. (2011). *Inventing the enemy: Denunciation and terror in Stalin's Russia*. Cambridge: Cambridge University Press.

Historiku i Repartit Nr. 303. (1979). Dosje e Objektit të Rëndësisë së Veçantë [deklasifikuar]. Ministria e Punëve të Brendshme.

Lubonja, F. (2018). *Ridënimi*. Tiranë: Përpyjekja.

Lubonja, F. (2021). *Jetë burgu*. Tiranë: Skanderbeg Books.

Mbembe, A. (2019). *Necropolitics* (S. Corcoran, Trans.). Durham: Duke University Press.

Pllumi, Z. (1995). *Rrno për me tregue*. Tiranë: Shtëpia Botuese “55”.

Schmitt, C. (2005). *Political theology: Four chapters on the concept of sovereignty* (G. Schwab, Trans.). Chicago: University of Chicago Press.

Schmitt, C. (2007). *The concept of the political* (G. Schwab, Trans.). Chicago: University of Chicago Press.

Szokolczai, A. (2017). *Permanent liminality and modernity: Analysing the sacrificial flow of capitalism and democracy*. London: Routledge.

Thomassen, B. (2014). *Liminality and the modern: Living through the in-between*. Farnham: Ashgate.

*KAMPI SI LABORATOR
I KONTROLLIT TË DYFISHTË:
ROLI I EFEKTIVIT
NË MAKINERINË E SPAÇIT*

ANNA SHKRELI





Shtysa për t'u ndalur në këtë përmasë më erdhi pas ditësh që bluaja me vete takimin e fundit me Zenel Drangun, ish i burgosur politik në kampin e punës dhe burgun e Spaçit. Gjatë takimit tonë më goditi paqja e tij, mungesa e dëshirës për hakmarrje dhe dy-tri herë më mbeti në vesh fjalia “ishte djallë i mirë”, teksa u referohej efektivëve të ndryshëm që kishin shërbyer gjatë viteve. Ika me mbresën e kësaj marrëdhënieje shumëdimensionale dhe me pyetjen mbi identitetin jo aq personal, sa institucional të këtyre efektivëve. Kjo pyetje më oshtiu sërish në vesh tek lexoja esenë e Arba Baxhakut, ku drejt fundit rithërret shqetësimin e filozofit Agamben rreth shumësisë së zërave të përfshirë në përfaqësimin e memories (Agamben, 1995).

Siç edhe ravijëzohet në format e veta të ndryshme gjatë eseve në këtë libër, në kujtesën kolektive dhe dokumentacionin historik, Spaçi përfaqëson simbolin e represionit shtetëror të ushtruar ndaj “armiqve të klasës” në Shqipërinë komuniste, si dhe shfrytëzimit të tyre. Në veprën e tij *Homo Sacer: Sovereign Power and Bare Life* (1995), Agamben argumenton se kampi – qoftë kamp përqendrimi, refugjatësh apo burg pune – nuk është një përjashtim nga rendi juridik, por përkundrazi “hapësira nomike” më karakteristike e tij, ku ligji dhe jeta biologjike përplasen. Në kamp, thotë Agamben, jeta zhvishet nga çdo status politik dhe reduktohet në një *bare life* (jetë e zhveshur) – një trup që mund të dënohet, kontrollohet, manipulohet dhe, në fund, edhe të vritet pa pasoja juridike.

Spaçi, në këtë kuptim, nuk ishte thjesht një institucion ndëshkimi, por një hapësirë e përjashtimit të përhershëm, ku të burgosurit jo vetëm që nuk kishin më qytetari, por as subjektivitet të njohur nga shteti. Ata përjashtoheshin nga “jeta politike” dhe mbaheshin gjallë vetëm si trup punëtor. Reduktimi i individit në njësi të prodhimit, vlerësimi i tij sipas normës ditore dhe ndëshkimi për sjellje “indiferente” apo për mosqëndrim “pozitiv”, përkon saktësisht me përshkrimin që Agamben (1995) bën për formën e jetës së zhveshur.

Një lexim tjetër i dokumenteve të Repartit 303 na vendos përpara një dimensionit më pak të trajtuar të kësaj jetë të zhveshur, por po aq të rëndësishëm: roli i rojeve, ushtarëve dhe oficerëve si një trupë e disiplinuar, e indoktrinuar dhe e ndëshkueshme, e vendosur mes përgjegjësisë për të mbikëqyrur dhe frikës për t'u mbikëqyrur, si dhe i asaj linje të hollë që qëndron mes detyrës dhe abuzimit. Këtë linjë vetëm dëshmitë personale dhe përvoja e jetuar mund ta përcaktojë, duke njohur

këtu të metat dhe mungesat e mëdha të çdo interpretimi që do të mund t'i bëhej secilit dokumentacion të shqyrtuar, në rrekjen për të kuptuar sadopak ingranazhet e ndërlikuara burokratike dhe shoqërore. Spaçi nuk ishte vetëm një burg për të dënuarit politikë, por edhe një laborator shtypjeje, ku vetë efektivit shndërrohej në trupëzimin e kontrollit dhe njëherësh objektin e kontrollit. Edhe pse dhuna sistematike e ushtruar në Spaç kishte për objekt kryesor të dënuarit, dokumentet tregojnë se vetë efektivët dhe rojat ishin gjithaq pjesë e këtij sistemi represiv që i nënshtrohej rregullisht kontrollit ideologjik, raportimit të detyrueshëm dhe presionit për bindje absolute. Çdo shenjë dobësie, hezitimi moral apo mungesë vigjilence mund të interpretohej si devijim politik nga “vija” dhe të sillte pasoja serioze. Në këtë kuptim, rojat dhe oficerët ishin njëkohësisht zbatues dhe viktimë të logjikës së frikës dhe disiplinës së hekurt që e karakterizonte shtetin totalitar; pjesë e një makinerie që kontrollonte jo vetëm trupin e të dënuarve, por edhe ndërgjegjen e atyre që mbanin armët.

Struktura e komandës në Spaç pasqyronte modelin stalinist të bashkëveprimit mes autoritetit ushtarak dhe atij ideologjik. Në krye qëndronin komandanti i repartit dhe komisari, të cilët kishin përgjegjësi të barasvlershme në drejtimin e kampit, por me theks të ndryshëm: njëri në aspektin operacional dhe ushtarak, tjetri në mbikëqyrjen politike dhe ideologjike të të gjithë strukturës. Nën ta qëndronin rojat e armatosura, oficerët e shërbimit, instruktorët, nënoficerët dhe kuadrot ideopolitike që kujdeseshin për riedukimin dhe mobilizimin e të dënuarve.

Stafi i repartit duhej të ishte vazhdimisht në gjendje gatishmërie. Urdhëresa të veçanta përcaktonin se çdo ushtar, polic, apo oficer, duhej të merrte pjesë në stërvitje të përmuajshme me armë, në simulime alarmesh të përgjithshme dhe në ushtrime të emergjencave të organizuara për të përballuar arratisje të mundshme apo “agresione të jashtme”. Mbi të gjitha, ishte thelbësore ruajtja e vigjilencës së lartë, veçanërisht ndaj elementëve të konsideruar armiq të pushtetit popullor. Në rast të një arratisjeje, urdhrat ishin të qarta: përdorimi i armës ishte jo vetëm i lejuar, por i kërkuar. Prania e një arsenali të gjerë dhe të sofistikuar armatimi, i cili e tejkalon përmasën e një kampi të zakonshëm burgimi dhe i afrohet strukturës së një njësie të gatshme ushtarake. Inventari i datës 3 janar 1980, që regjistron armët dhe municionin në dispozicion të repartit, tregon jo vetëm dimensionin fizik të frikës që mbizotëronte në Spaç, por edhe mënyrën se si dhuna

[1] Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1979). *Dosja Nr. 107: Evidencë statistikore e armatimit për vitin 1979* (f. 3).

ishte e institucionalizuar si prani e përhershme, e heshtur dhe potencialisht fatale.¹

Në dokument regjistrohen më shumë se 20 kategori armësh, përfshirë:

154 pistoleta të tipit 54, në përdorim nga efektiv, 122 pushkë vetëmbushëse model 56,

111 automatikë model 56 me kundërdrurë,

mortaja 82 mm dhe 120 mm, të afta për përdorim në

luftime tokësore, topa P.S. model 56, një armë luftarake e dimensioneve të mëdha,

si dhe armë sinjalizuese, granatahedhës, pushkë snajper, mitraloza për tanke dhe pushkë speciale për ndjekje në errësirë.

Prania e një armatimi të tillë brenda një kampi të izoluar në veri të Shqipërisë, i banuar nga të burgosur politikë e ordinerë dhe efektivë të rregullt, nuk mund të justifikohet as me nevojat për siguri, as me ndonjë kërcënim të jashtëm real. Ky arsenal dëshmon për një logjikë tjetër: atë të frikës së përhershme të shtetit ndaj së brendshmes, ndaj pakënaqësisë, shpërthimit apo rezistencës, që mund të lindte nga vetë sistemi që kishte prodhuar.

Paralelisht me përgatitjen ushtarake, një rëndësi e veçantë i jepej indoktrinimit ideologjik. Oficerët dhe rojat merrnin pjesë në mënyrë të rregullt në seminare politike mbi mësimet e Enver Hoxhës, luftën e klasave, rrezikun e liberalizmit, dhe misionin historik të Partisë së Punës në ruajtjen e diktaturës së proletariatit. Çdo muaj zhvilloheshin diskutime dhe trajtime

tematike mbi dokumentet e Kongreseve të PPSH-së, si dhe leksione të posaçme mbi rrezikun e propagandës së huaj dhe nevojën për ta demaskuar atë. Njëri nga formulimet tipike në këto plane është urdhri për “të përgatitur një temë ideologjike mbi luftën e klasave të lidhur ngushtë me komplotin që u shpartallua nga Partia dhe Pushteti jonë”, duke e kthyer kështu çdo diskutim teorik në një instrument të drejtpërdrejtë të disiplinës dhe frikës.

Në aspektin rregullator, kuadrot dhe efektivit i repartit ishin të detyruar të njihnin në hollësi rregulloren e re të kampit, të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Kjo përfshinte njohuri mbi klasifikimin e të dënuarve, mënyrën e ndarjes së tyre nëpër kapanone, masat higjieno-sanitare, ndërtimin e ambienteve të izolimit, si dhe mbikëqyrjen e korrespondencës. Nëpërmjet një kalendari strikt të seminareve dhe provimeve me shkrim, testi ideologjik dhe teknik i personelit ishte i vazhdueshëm. Çdo pjesëtar i efektivit duhej të raportonte në mënyrë të rregullt mbi shërbimin e kryer, mbi informacionet që kishte marrë dhe mbi çdo devijim që vërente, si te të dënuarit, ashtu edhe te kolegët.

Roli i oficerëve dhe rojave nuk kufizohej vetëm në ruajtjen fizike të kampit. Ata ishin pjesë aktive e procesit të riedukimit politik të të dënuarve. Këshillat e riedukimit, që mbledheshin periodikisht, ishin platforma ku oficerët raportonin mbi sjelljen, produktivitetin, qëndrimin ideologjik dhe “përmirësimin” e të dënuarve përmes punës së detyruar. Produktiviteti në minierë, cilësia e prodhimit dhe përmbushja e normave mujore ishin indikatorë të “suksesit” të riedukimit. Oficerët kishin detyrë të mbikëqyrnin normat kolektive, të nxisnin konkurrencën mes të dënuarve dhe të raportonin çdo lloj devijimi, mosbindjeje, apo refuzimi për të punuar. Në dy dokumente, policët N. D. dhe Gj. Gj. ndëshkohen për vonesë në detyrë prej 1 ore e 30 minutash, çka, sipas raportit, solli vonesë në nxjerrjen e të dënuarve në punë.² Këto vonesa interpretohen si “pasoja ekonomike” dhe trajtohen si shkelje të rëndësishme të rregullores, duke theksuar faktin se edhe produktiviteti i të burgosurve vlerësohej si përgjegjësi direkte e rojave. Në rastin e mungesës së kontrollit në shpërndarjen e ushqimeve dhe materialeve bazë (drurë, mish etj.), mungesa e efikasitetit shihet si shkelje politike, sepse cenon moralin e të dënuarve dhe besimin në drejtësinë e regjimit. Kritikohen hapur figura si N/Oficer V. B. dhe shoku Z. M., për mosushttrim kontrolli ndaj sektorëve kyç si furnizimi.³ Kjo dëshmon se çdo neglizhencë

[2] Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1980). *Dosja Nr. 180: Relacion e informacion dërguar Drejtorisë së Kuadrit, Drejtorisë së Zbatimeve Penale dhe Sektorit të Kuadrit të Degës së Punëve të Brendshme Mirditë për disa masa ndëshkimore që janë marrë ndaj disa kuadrove e policëve për ulje të figurës, etj.* (ff. 3–28).

[3] Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1980). *Dosja Nr. 121: Informacion mbi gjendjen shëndetësore e higjieno-sanitare të efektivit të repartit për vitin 1980, dërguar degës së shëndetësisë* (ff. 3–4).

administrative trajtohej si devijim ideologjik dhe jo si thjesht paaftësi menaxheriale. Kështu, çdo paaftësi për të kontrolluar të dënuarit në aspektin kohor, fizik apo moral, i faturohej efektivit si dështim politik. Ky sistem ndëshkimi brenda vetë efektivit krijonte një klimë të qëndrueshme frike dhe autocensure, ku çdo gabim i vogël, çdo devijim nga zelli revolucionar, çdo moment pasigurie apo lodhjeje, mund të interpretohej si shkelje ideologjike. Termat si “mospërputhje me moralin revolucionar”, “mungesë respekti për kolektivin”, “sjellje e papërshtatshme para të dënuarve” apo “mosrespektim i urdhrave të eprorëve”, shfaqen si formula standarde për një regjim ku autoriteti ishte absolut, por edhe i brishtë, duke kërkuar vazhdimisht rithemelimin e vetes përmes ndëshkimit të shfaqjeve të “dobësisë”.

Një element kyç i funksionimit të kampit ishte ruajtja e sekretit ushtarak dhe kontrolli i informacionit. Rregulloret parashikonin ndëshkime për çdo rrjedhje informacioni, ndërsa komandat përpilonin raporte të veçanta mbi mënyrën se si ushtarakët përmbushnin “detyrën për ruajtjen e sekretit”. Ky dimension shtesë i kontrollit shtonte frikën dhe autocensurën në të gjitha nivelet e hierarkisë, duke e kthyer Spaçin në një hapësirë ku mbikëqyrja ishte e dyfishtë: ndaj të dënuarve dhe ndaj vetë efektivit. Përmes këtyre dokumenteve, Spaçi shfaqet jo vetëm si një vend i dënimit fizik, por edhe si një laborator politik ku Partia synonte të krijonte “njeriun e ri” në sajë të një përzierjeje të dhunës, punës së detyruar dhe edukimit politik. Rrjeti i rreptë i komandës, i raportimit dhe përgatitjes politike e bënte Repartin 303 një model të përkryer të dhunës administrative të shtetit komunist shqiptar.

Bazuar në dokumentet e analizuara, raporti për gjashtëmujorin e parë të vitit 1977, përfaqëson një dëshmi të qartë mbi ndërthurjen e funksionit represiv të shtetit socialist me strukturën e tij ushtarake dhe ideologjike brenda kampit të punës së detyruar.⁴ Dokumenti paraqet një përpjekje të vazhdueshme për të përforcuar edukimin ideopolitik dhe disiplinën ushtarake-profesionale, si mjet për të garantuar zbatimin e “planit të shtetit” dhe për të mobilizuar efektivin kundër “armikut të klasës”.

Oficerët, komandantët dhe policët vlerësoheshin dhe ndëshkoheshin mbi bazën e sjelljes së tyre politike, organizative dhe operative, siç dëshmojnë rastet e qortimeve apo të ngritjeve në detyrë, siç trajtohet dhe më poshtë, për shkak të “shkeljeve të rregullave të disiplinës”, “uljes së vigjilencës” apo për “sjellje

[4] Reparti i riedukimit 303 Spaç, (1977). *Dosja Nr. 35: Raport për gjendjen moralo-politike të efektivit për 6-mujorin e parë të vitit 1977* (ff. 3–10).

[5] Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1980). *Dosja Nr. 180: Relacion e informacion dërguar Drejtorisë së Kuadrit, Drejtorisë së Zbatimeve Penale dhe Sektorit të Kuadrit të Degës së Punëve të Brendshme Mirditë për disa masa ndëshkimore që janë marrë ndaj disa kuadrove e policëve për ulje të figurës etj.*

[6] Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1979). *Dosja Nr. 84: Propozim dërguar Drejtorisë së Kuadrit dhe degës së organizimit për stimulimin e disa ushtarëve me rastin e zbulimit dhe asgjësimit të një të dënuari i cili tentoi të arratisesh nga kampi (ff. 3–5).*

të padenjë ndaj Partisë”. Dosjet disiplinore tregojnë për raste qortimesh dhe penalizimesh për “llafazanëri”, “afrimitet me të dënuarit”, “mospërmbushje të normës së vigjilencës”. Dosja 180 i Sektorit të Komandës, dëshmon se shprehja e çdo emocioni jashtë kodit të aprovuar, si mëshirë ndaj të dënuarve, skepticizëm ndaj urdhrave apo thjesht lodhje njerëzore, sanksionohej si devijim politik. Në këtë mënyrë, struktura e kampit përforconte jo vetëm bindjen vertikale, por edhe një regjim të frikës horizontale, ku kolegët vëzhgonin njëri-tjetrin dhe kolektivi përdorej si mjet ndëshkimi simbolik.

Një nga rastet më domethënëse të ndëshkimit për “afrimitet të tepruar” me të dënuarit është ai i policit P. Gj. N., i cili në janar 1980 u qortua publikisht nga komanda për faktin se kishte pranuar nga një i dënuar një pipëz cigareje.⁵ Ky gjest minimal, i padëmshëm në përmasat e tij konkrete, u interpretua si shkelje e disiplinës ideologjike dhe si një formë “sjelljeje jo të denjë” për një efektiv të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Marrja e një objekti nga një i dënuar konsiderohej akt simbolik i rrezikshëm, që fshinte kufirin moral midis “ruajtësit të rendit” dhe “armikut të shtetit”, duke prodhuar dyshim mbi besnikërinë politike të rojës. Ky rast dëshmon se edhe gjestet më të vogla të njerëzores, në kontekstin e Spaçit, përktheheshin si devijime ideologjike dhe ndëshkoheshin për të ruajtur rendin absolut të frikës.

Në të njëjtën kohë, diametralisht, efektivë të tjerë shpërbleheshin për “vigjilencë të lartë”, “shfaqje të moralit revolucionar” apo për “asgjësimin e elementit armik”. Në një dokument të 5 korrikut 1979 përmendet se një i dënuar që tentoi arratisjen më 11 qershor u “asgjësua”, dhe rojave iu propozua shpërblim.⁶ Kjo nuk është vetëm dëshmi e përdorimit të vrasjes si mjet sigurie; është prova e institucionalizimit të vrasjes si akt i lavdërueshëm ideologjik. Mekanizmi psikologjik që ndikon në tëhuajësimin e njeriut ndaj njeriut formësohet në masë të rëndësishme edhe nga gjuha. Një aspekt që cilëson këtë proces tëhuajësimi është përdorimi sistematik i një gjuhe burokratike të zbutur, që maskon dhunën me terminologji teknike dhe ideologjike. Eufemizmat, format pasive të fjalisë, mungesa e subjekteve të përgjegjshme dhe, në tërësi, strukturat shabllone dhe tautologjike përbëjnë një aparaturë gjuhësore që i shërben dhunës dhe deformimit psikologjik.

Fraza “zbulimi dhe asgjësimi i elementit armik” e formuluar në mënyrë jo personale nuk përmend as vrasje, as viktimë, as autor të aktit, vetëm një “element armik” që

është “asgjësuar”. Ajo çka është realisht krimi i vrasjes, i kryer nga efektivë të armatosur kundër një të dënuari që tentoi të arratisë, përkthehet në një sukses teknik të vigjilencës. Ky është shembulli më i qartë i dhunës administrative, ku veprimi fizik zhvendoset në një fushë semiotike të zbutur, e cila shmang përgjegjësinë penale dhe prodhon legjitimitet ideologjik. Kjo gjuhë shfaqet kudo në raportet e Repartit 303: të burgosurit që “sillen keq” kategorizohen si “elementë me qëndrim negativ”, ata që plagosen në punë janë “rezultat i pakujdesisë”, jo i kushteve të punës, ndërsa rrahjet përmenden si “masa disiplinore të ndërmarra për shkelje të rregullores”. Termi “neutralizim” përdoret në vend të “arrestim” ose “ndalim me forcë”, dhe “tendencë për arratisje” bëhet një formë e ndërmjetme mes aktit dhe qëllimit, një hap i mjaftueshëm për ndëshkim, por i pamjaftueshëm për të garantuar juridikisht.

Ky stil gjuhësor nuk është thjesht konvencional. Ai përbën një regjim vetë më vete, një sistem semiotik që e fshin subjektin dhe prodhon bindje pa nevojën për retorikë. Eufemizmi në këtë kontekst është një formë dhune: jo më e drejtpërdrejtë, por e distancuar, e abstraguar, e institucionalizuar. Duke e zhvendosur vëmendjen nga njeriu te kategoria, nga viktimat te termi ideologjik, shteti nuk e fsheh dhunën, e zëvendëson me një gjuhë që nuk e lejon më të identifikohet si e tillë, për ta bërë të të gjitha palët më të lehtë ushtrimin e saj.

Në këtë mënyrë, burokracia totalitare e Spaçit nuk shfaqet vetëm në komandat, armët dhe rregulloret, por jeton në fjalitë e raportit, në skemën e klasifikimit të sjelljeve, në vendimin për të përdorur “qortim para kolektivit” në vend të “poshtërim publik”. Dhe më shumë se çdo makinë tjetër, kjo gjuhë prodhon heshtje dhe deformim të njerëzores.

Në dokumentet e Sektorit të Komandës të Repartit, paraqiten disa raste flagrante ku oficerët dhe policët kanë tejkaluar kompetencat e tyre në mënyrë të paligjshme, duke marrë masa ndëshkuese pa autorizim dhe jashtë procedurave zyrtare. Raste të tilla, si ai i oficerit Gj. Gj. i cili vendoste dënime spontane pa analizuar thellësisht situatën, ose ai i Dh. K., që bazohej në dëshmi të pakonfirmuara për të marrë masa ndaj të dënuarve, tregojnë një klimë abuzimi me pushtetin të toleruar për aq kohë sa justifikohet ideologjikisht. Një nga rastet më të rënduara është ai i N/Oficerit D. Rr., i cili urdhëroi zhveshjen e të dënuarit në birucë, duke thënë se “ka dhënë urdhër komandanti”⁷ – një frazë që në vetvete zbërthen automatizimin e nënshtrimit dhe shpërdorimin e autoritetit hierarkik si

[7] Reparti i riedukimit 303 Spaç, (1971). *Dosja Nr. 4: Raport mbi konkluzionet e Byrosë Politike të K.Q. të PPSH për disa çështje të metodës së punës në organet e punëve të brendshme në rreth e në ministri.*

justifikim për veprime degraduese. Më tej, përmendet rasti i Xh. Ballës, i cili për shkak të mungesës së kontrollit lejoi humbjen e një prone shtetërore (pantallonat e një inxhinieri), çka shihet si dështim i rëndë ideologjik dhe organizativ.⁸

[8] Po aty, (ff. 11–15).

[9] Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1971). *Dosja Nr. 7: Analizë me oficerat e repartit për zbatimin e ligjshmërisë socialiste etj. me të dënuarit* (ff. 3–6).

Në këtë sistem, dhuna verbale dhe ofendimet ishin po aq të pranishme sa edhe dënimet fizike. Policë si Gj. Ç., F. L., N. L. përmenden për fyerje brutale ndaj të dënuarve, përfshirë kërcënime me vdekje dhe përdorim gjuhësh që përçmojnë jo vetëm individin, por edhe pozitën e tij politike si “armik klase”. Kjo tregon se, përtej ligjshmërisë së pretenduar, praktika reale e ndëshkimit ishte e mbështetur në një gjuhë që e legjitimonte çdo formë abuzimi në emër të riedukimit.⁹

Dokumentet zbulojnë edhe mënyrën se si këto shkelje trajtoheshin institucionalisht: jo si thyerje të së drejtës, por si gabime që dëmtojnë vijën e Partisë dhe që kërkojnë autokritikë, reflektim dhe korrigjim nga brenda. Figura si Sh. Xh., përmendet se ka kërkuar falje dhe është kritikuar për mungesë udhëheqjeje në Degën e Repartit. Kjo vetëkritikë paraqitet si pjesë e një rituali të pastrimit ideologjik.¹⁰

[10] Po aty.

Një mjedis i tillë s’do mend se do të ketë pasur një tension të lartë psikologjik. Raporti statistikor për gjashtëmujorin e parë të vitit 1977 (krahasuar me 1976) përfshin kategori si “plagosje nga pakujdesia”, “vrasje nga pakujdesia”, “zbrasje armësh” dhe “vërejtje për moszbatim të disiplinës”, duke treguar qartë një ambient me tension të lartë ushtarak, ku kontrolli, ndëshkimi dhe autocensura, apo siç thënë më lart, “heshtja”, ishin të institucionalizuara.¹¹ Në një rast, përmendet se një ushtar kishte marrë përsipër të shmangte kontaktet e të dënuarve me efektivin, duke i ndarë fizikisht dhe duke kufizuar komunikimin me “ushtarakët e lirë”. Këto masa synonin parandalimin e çdo forme afrimi njerëzor që mund të rrezikonte “pastërtinë ideologjike” të ushtrisë si dhe të korruptonte këtë tëhuajësim njerëzor të ngritur nga sistemi.

[12] Po aty.

[13] Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1979). *Dosja Nr. 104: Analizë e relacione për gjendjen moralopolitike të efektivit të repartit për 6-mujorin e parë dhe të dytë të vitit 1979* (ff. 3–19).

Kjo përzierje e disiplinës ideologjike, deformimit psikologjik dhe pranisë së shtuar të armëve me detyrën ushtarake, e shndërronte rojën në një entitet të dyfishtë: zbatues të dhunës dhe subjekt i saj. Në rastet kur vigjilenca nuk ishte “në nivelin e duhur”, apo kur mungonte “entuziazmi politik”, ndëshkimi ishte i menjëhershëm dhe i ashpër.¹² Në raportet e vitit 1979, përmenden disa raste të efektivëve që u hoqën nga detyra për shkak të “mungesës së korrektesës ndaj të dënuarve”, një formulim që shpesh përkthehej si dyshim për ndjeshmëri njerëzore apo sjellje jo të ashpër.¹³

Në këtë mënyrë, sistemi i Spaçit, përmes kontrollit vertikal nga shteti dhe mbikëqyrjes horizontale nga kolektivi, e shndërronte çdo efektiv në një trup të modeluar nga frika, dhuna dhe tëhuajësimi. Çdo roje kërkohet të përfaqësonte shembullin e “njeriut të ri”, por ky model nuk kishte ndjeshmëri, as individualitet. Leximi me guxim i këtyre dokumenteve ofron një dëshmi të drejtpërdrejtë të faktit se regjimi totalitar nuk ndërtohet vetëm mbi dhunën ndaj kundërshtarëve, por edhe mbi disiplinimin e atyre që e përfaqësonin. Në Spaç, terrori ideologjik nuk mbetej përtej telave me gjemba, ai përhapej brenda radhëve të rojave, zbriste në raportet e përditshme të shërbimit dhe ngjitej, sërish, në format e raportimit politik. Ai ishte një sistem i mbyllur, ku të gjithë ishin në shënjestër, dhe ku nënshtrimi total ishte kusht për mbijetesë.



REFERENCA

Burime parësore

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1971). *Dosja Nr. 4: Raport mbi konkluzionet e Byrosë Politike të K.Q. të P.P.SH për disa çështje të metodës së punës në organet e punëve të brendshme në rreth e në ministri.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1971). *Dosja Nr. 7: Analizë me oficerat e repartit për zbatimin e ligjshmërisë socialiste etj. me të dënuarit.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1977). *Dosja Nr. 35: Raport për gjendjen moralo-politike të efektivit për 6-mujorin e parë të vitit 1977.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1979). *Dosja Nr. 84: Propozim dërguar Drejtorisë së Kuadrit dhe degës së organizimit për stimulimin e disa ushtarëve me rastin e zbulimit dhe asgjësimit të një të dënuari i cili tentoi të arratisë nga kampi.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1979). *Dosja Nr. 104: Analizë e relacione për gjendjen moralo-politike të efektivit të repartit për 6-mujorin e parë dhe të dytë të vitit 1979.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1979). *Dosja Nr. 107: Evidencë statistikore e armatimit për vitin 1979.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1980). *Dosja Nr. 121: Informacion mbi gjendjen shëndetësore e higjieno-sanitare të efektivit të repartit për vitin 1980, dërguar degës së shëndetësisë.*


Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1980). *Dosja Nr. 180: Relacion e informacion dërguar Drejtorisë së Kuadrit, Drejtorisë së Zbatimeve Penale dhe Sektorëve të Kuadrit të Degës së Punëve të Brendshme Mirditë për disa masa ndëshkimore që janë marrë ndaj disa kuadrove e policëve për ulje të figurës.*

Burime dytësore

Agamben, G. (1995). *Homo Sacer: Sovereign Power and Bare Life.* Stanford University Press.

*MINIERA-KAMP E SPAÇIT:
MAKINA E KAPITALIZMIT
SHTETËROR*

ALLEN BEJKO



Vështirësia e parë tek mundohemi t'i avitemi studimit të historisë së minierës-kamp të Spaçit, e cila rëndom quhet dhe 'burgu i Spaçit', është se, në të vërtetë, nuk ka ekzistuar kurrë një i tillë. Burokratishtja kokëfortë e kohës, e cila na shfaqet në burimet arkivore, flet veçse për Objektivin e Rëndësisë së Veçantë, Repartin nr.303 Spaç. Pikërisht te kjo emërtesë e drunjte zë fill edhe leximi i Spaçit jo vetëm si vend dënimi, por edhe si vend shfrytëzimi, që do të mundohemi të shtjellojmë në vijim. Puna e papaguar e të dënuarve apo 'forcat e detyruara' kanë qenë element kyç i realizimit të objektivave infrastrukturorë e, më vonë, ekonomikë të regjimit. Praktika ishte marrë - kopjuar - nga Bashkimi Sovjetik dhe përmbushte funksionin e dyfishtë të mbajtjes së "izoluar elementin armik dhe keqbërës, që është dënuar nga gjyqet e popullit për krime kundër shtetit dhe për t'i aktivizuar ata në punë."¹

[1] Ministria e Punëve të Brendshme, Dega e Punëve të Brendshme Mirditë. A6-123-ORV REP 303 Spaç (f. 4).

Reparti nr.303 e nis jetën me urdhër të ministrit të P. Brendshme të datës 25 maj 1951, nën emrin kampi nr.2 dhe me vendndodhje në Peqin. Të dënuarit caktohen të punojnë në hapjen e kanalit Peqin-Kavajë, nën mbikëqyrjen e forcave të Policisë Popullore. Metoda e kohës e donte që këto kampe të mos ishin statike, por të zhvendoseshin sipas nevojave të punës që kryenin. Kështu, edhe në kampin nr.2, "si mbas rregullit në atë kohë shoqërimi i të dënuarve nga kampi për në frontin e punës, bëhej në këmbë duke patur si sektor një linjë prej 8 km. Dhe mbasi mbarohej 8 km kanal bëhej përsëri lëvizja e kampit."²

[2] Po aty, f.5.

Një historik i kampit gjurmon zhvendosjet e tij: Urë Vajgurore për ndërtimin e fushës së aviacionit, Qytet Stalin për hapjen e kanalit Devoll-Thanë, Fier për kanalin Vjosë-Levan-Fier, Rinas për ndërtimin e aeroportit në vitet 1955-9 dhe Tiranë për ndërtimin e Sanatoriumit të Shtetit, Kombinatit të Mishit, fermës "Gjergj Dimitrov" dhe një pjese të Uzinës së Traktorëve në vitet 1959-64, Vlorë për Uzinën e Sodës Kaustike më 1964 dhe Elbasan për Fabrikën e Çimentos më 1965, para vendosjes përfundimtare në lokalitetin e Kodër-Spaçit në maj 1968, ku sapo kish filluar punën miniera e piriteve.³

[3] Po aty, ff.6-15.

Itinerari i repartit nr.303 gjatë 17 viteve të zhvendosjeve të tij nëpër një pjesë të madhe të vendit nxjerr në pah rëndësinë vendimtare të punës së detyruar për realizimin e objekteve të mëdha ekonomike dhe infrastrukturorë të totalitarizmit. Në mungesë të mjeteve financiare dhe të krahut të punës, ishte domosdoshmëri jetike shfrytëzimi i të dënuarve për industrializimin dhe urbanizimin e sforcuar të dekadave të para të Pasluftës.



[4] Ministria e
Punëve të Brendshme,
Dega e Punëve të
Brendshme Mirditë.
A2 D4-13-ORV Miniera e
Bakrit Spaç (f. 44).

Parë kjo, bëhet edhe më e qartë pesha që i kushtonte regjimi nxjerrjes së piriteve dhe bakrit në Spaç, aq e madhe sa t'i kushtonte njërin prej reparteve më të mëdha të riedukimit, që numëronte thuhetse 1000 vetë kur u vendos fillimisht atje.⁴ Përmasat dhe kohëzgjatja e punës së të dënuarve në Spaç - e cila zgjati deri në vitin 1991 - e bëjnë atë shembullin emblematic të dukurisë së gjerë të punës të detyruar dhe të mënyrës se si struktura ekonomike totalitare u ngrit mbi shpinën e shtresave të shtypura të atij sistemi, duke i njohur Spaçit dhe një aspekt tjetër e njaq thelbësor për rolin e tij si vend kujtese.

Shtjella e dytë e historisë së minierës-kamp të Spaçit nis me orvatjet italiane për të krijuar një bazë ekonomike e industriale në Shqipëri gjatë periudhës së Pushtimit, së cilave nuk u shpëtoi as lokaliteti i Shën Palit në fshatin gjer atëherë pak të njohur të Kodër-Spaçit.

“Punimet për zbulimin e vendburimevet në këtë qendër pune kanë filluar qysh në të kaluarën, nga viti 1940-1941 gjeologët italianë kanë bërë kërkime, por këto kërkime kanë qenë të kufizuara - vetëm kërkime në kanale në sipërfaqe dhe janë përdorur thjeshtë vegla primitive. Me gjithë atë qysh në atë kohë italianët kanë gjetur shenja të bakrit.”⁵

[5] Ministria e
Punëve të Brendshme,
Dega e Punëve të
Brendshme Mirditë.
A6-123-ORV Rep 303
Spaç (f. 15).

Kërkimet e mirëfillta nisin më 1952 dhe duke nisur nga viti 1956, në fshat vendoset një ekip gjeologjik, i cili zbuloi xehrorë dhe mandej ia dorëzoi zonën për shfrytëzim minierës së Rubikut, e cila vendosi një repart në Spaç që filloi punë në fund të vitit 1964.⁶ Zbulimet e rezervave minerale të piritit dhe kalkopiritit (bakrit) qenë aq të rëndësishme, saqë u përfshinë menjëherë në planet ekonomike të regjimit.

[6] Po aty.

Duke u nisur nga sasia e rezervave të mineralit të cilat ishin të mëdhaja dhe me perspektive, me vendim të Qeverisë u vendos që në Rept të ndërtohet fabrika e pasurimit të bakrit e piritit. Mbi bazën e Spaçit është ndërtuar dhe fabrika e superfosfatit në Laç e cila si lënd' të parë përdor piritin e Spaçit.

Me që është e nevojshme për tu shtuar fuqija puntore, Qeveria vendosi që në Spaç të Rrethit Mirditë të bjeri Kampin e Riedukimit të Rep.303 me një fuqi puntore rreth 950 veta. Këta erdhën këtu në muajin Maj 1968. Nga këta rreth 450 veta u vendosën në Rept për ndërtimin e Fabrikës Pasurimit, kurse pjesa tjetër vajtën të punojnë në Galerit' e Spaçit.

*Fabrika e Pasurimit në Reps përfundoj' në muajin
shtator 1970 me ndihmën internacionaliste të R.P. Kinës e cila
na dërgoj' përveç makinerive dhe 6 specialist' nga Kina. Tani
fabrika punon në rregull dhe jep rezultate shumë të mira.*

Historiku i Minierës së Bakrit Spaç, bocë⁷

Ndjekja e secilës prej dy jetëve paralele të minierës-kamp të Spaçit dhe vëmendja për ndikimin e ndërsjellë mes njëra-tjetrës, na mundëson të shquajmë një aspekt tjetër të totalitarizmit - të cilin mund ta quajmë 'pragmatist' apo 'të ftohtë' për lehtësi - që megjithatë nuk është asgjë tjetër veç skllavërimit të paramenduar dhe të planifikuar të një pjese të popullatës për arsye të leverdisë a nevojës ekonomike të sistemit.

Siç del qartazi dhe nga burimet arkivore, fati i 1950 të dënuarve të repartit nr.303 vulozet përfundimisht, vetëm pas zbulimit të rezervave minerare aq të mëdha e të vlefshme sa të përlligjin ndërtimin e dy fabrikave posaçërisht për shfrytëzimin e tyre. Në çastin e vërtetimit të leverdisë ekonomike - kur regjimi i bie lapsit për të bërë llogaritë - merr fund maskarada e riedukimit të tyre nëpërmjet punës në veprat publike të monizmit, dhe kalohet drejt shfrytëzimit të pastër për përfitim ekonomik. Pashmangshmërisht, nuk mungon as pjesëmarrja e ndihma teknike e aleatit të madh kinez, njëlloj i interesuar për të siguruar zhvillim e një lloj autonomie ekonomike regjimit aq të kushtueshëm shqiptar.


Në këtë mënyrë, shfrytëzimi i këtyre të dënuarve si skllavër pune bëhet ingranazh jo vetëm i makinës së ekonomisë të planifikuar vendase, por dhe i atyre pak marrëdhënieve tregtare që vijonin ta lidhnin autarkinë gjithnjë e në rritje shqiptare me tregjet ndërkombëtare. Bakri dhe superfosfatet apo mbetjet kimike të prodhuara prej tij ishin mallra të tregtueshëm dhe, rrjedhimisht, të domosdoshëm për sigurimin e valutës së huaj që do të lejonte importet që mbanin në këmbë ekonominë totalitare - si rublën nominale të tregtisë me *klering* (clearing) në Kampin Socialist, ashtu dhe valutat perëndimore për ato çka nuk mund të gjendeshin tek ish-aleatët.

Spaçi përbën një ndër rastet e veçanta kur punës së detyruar - me vuajtjen e mundimet e tmerrshme që nënkuptonte ajo - mund t'i jepet një vlerë e thatë monetare, pra kur shtypjes e terrorit totalitar mund t'i gjendet një motivim thellësisht jo ideologjik përfund.

Kjo lidhje përbën tiparin e saj më të vyer, pasi na çel një dritare të re të studimit të totalitarizmit jo më vetëm përmes akteve të terrorit të madh, por edhe përmes terrorit të vijueshëm e të brendashkruar tij, i cili thuhet se normalizohet gjatë dekadave të regjimit.

Shndërrimi i individëve në kafshë punë për qëllime përfitimi tregtar, pikërisht nga ana e një regjimi që e kishte kredon më themeltare refuzimin dhe shkatërrimin e atij koncepti të jetës e të punës, është shembulli më goditës i asaj çka nënkuptonte realiteti totalitar, përkundër diskursit - propagandës - që prodhonte e vijon të prodhojë.

Gatishmëria për t'ia nënrenditur, qoftë dhe një funksion aq të rëndësishëm të regjimit sa shtypja e 'elementit armik' nevojës a dëshirës për përfitim, na vërteton sërish falimentin e tij të plotë jo thjesht ekonomik, por edhe sipas parametrave të vet ideologjikë e politikë. Fakti që këtë mundësi për ta zgjeruar diapazonin e studimeve të periudhës totalitare na e ofron puna e detyruar e të dënuarve të Spaçit, është jo vetëm shpagim poetik, por gjithashtu dhe një mundësi për ta mbajtur në jetë e për ta shpënë përpara kujtimin e përbashkët të asaj përvoje, në mënyrë të atillë që ajo brengë të na shërbejë për mirë ende sot, mbi tri dekada pas prishjes së repartit nr.303.



REFERENCA

Burime parësore

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dega e Punëve të Brendshme Mirditë. *A6, 123, ORV Rep. 303, Spaç – Administrativ.*

Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AIDSSH). *Dosja e Repartit nr. 303 Spaç: Historiku i Kampit nr. 2 dhe zhvendosjet deri në Spaç.*

Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), Arkivi i Ministrisë së Industrisë. (1968–1970). *Historiku i Minierës së Bakrit Spaç [Bocë arkivore].*

*SPAÇI
SI KRIPTË E FJALËS*

LEDI SHAMKU-SHKRELI

(Faint handwritten notes visible through the paper)

Abstrakt

Ky studim kërkon t'i qaset ligjërimin kriptik të thadruar në burgun e Spaçit. Ai përqendrohet më së shumti në mbizotërimin që mund të marrë Kuptimi mbi Domethënien në kushte të pazakonta komunikimi, siç janë kushtet e mungesës së plotë të lirisë, si edhe të mosbesimit ndaj tjetrit, qoftë ky edhe një (në dukje) i ngjashëm. Kjo shprehje e raportit të drejtëzës mes Kuptimit dhe Domethënies, në fakt përmbys tiparin themelor të gjuhës – atë të kontratës sociale të bashkëndarë – duke u njohur fjalëve a formave kuptime që nuk i kanë. Por vëzhgimi nuk mjaftohet veç duke e konstatuar këtë shprehje. Ai kërkon të hulumtojë se si atribuimi i vullnetshëm i një kuptimi të ri bëhet edhe për të vendosur një kontratë të re sociale të ligjërimin të kriptuar mes të burgosurve që vendosin ta bashkëndajnë, duke e shndërruar kriptoshenjën gjuhësore në një element identitar, politik, kulturor e besueshmërie, njëjtë siç ndodh me një zhargon a gjuhë të fshehtë.*

Duke u mbështetur në teoritë e Ferdinand de Saussure, Ludwig Wittgenstein, Giorgio Agamben, Pierre Bourdieu dhe teoricienë të tjerë të gjuhës, si: Roman Jakobson, Victor Klemperer, Erving Goffman, apo studime nga James C. Scott dhe Mikhail Bakhtin, analiza shpalos se si kriptogjuha e Spaçit përmbys tiparin e saj si kontratë sociale e hapur për ta rindërtuar veten si një marrëveshje e re komunitare, me funksione mbrojtëse, identitare dhe politike. Paralele të ngjashme ndërtohen me rastet e Gulag-ut dhe Tuol Sleng për të kriptuar dimensionin universal të gjuhëve të fshehta në hapësira represive.

**Për këtë arsye është ndërtuar një kampion me të intervistuar, me të cilët janë kryer intervista të semistrukturuara.*

CEKASË

KRIPTAT GJUHËSORE TË SHPIRTIT

Në ligjërimin sektorial arkitekturor me “kriptë” kuptohet ajo hapësirë e nëndheshme, rëndom e gjendur nën një kishë a katedralë, e përdorur fillimisht për të ruajtur a mbrojtur relikte të shenjta a vendvarrime shenjtësh apo edhe laikësh të shquar. Fjala e ka burimin nga greqishtja *krypte*, e cila në vetvete don të thotë “e fshehtë” a “fshehkë” (vend i fshehtë). Në periudha turbullie a përmbysjeje rendesh, kriptat shpesh kanë qenë njëherësh edhe objekt profanimit, por edhe objekt sakrifice. Secila palë në konflikt ka synuar t’i përdhosë a t’i shpëtojë, e para duke i zhvarrosur e flakur, po edhe duke i nxjerrë në treg reliktet për qëllime fitimi; e dyta duke ndërmarrë pelegrinazhe të rrezikshme për shpëtimin e tyre dhe vendosjen në vend të sigurt. Cilado qoftë qasja, diçka është e sigurt: kripa në kuptimin e ngushtë të saj, atë të drejtpërdrejtë e konkret, nuk ka lënë të qetë asnjërën nga palët, ngase të dyja palët ia kanë njohur rëndësinë social-kulturore që bart për komunitetet, për mirë a për keq.

Veç kuptimit konkret e denotativ, kripa ka marrë edhe kuptim abstrakt, metaforik e konativ, siç paraqitet bie fjala te sintagma poetike “kripa e shpirtit”, në të cilat ndryhen në formë fjalësh ndjesitë e mendimet më të thella të dikujt a të një bashkësie, shpesh të pashprehura e për pasojë edhe të pashqyrtuara. Kjo ndrymje u jep atyre edhe tiparet e kodit trashdental, të përcjellë në mënyrë akritike e për pasojë të pandryshuar në formë e në përmbajtje. I shndërron në kode gati-gati formulaike.


Për si e pashë unë Spaçin si gjuhë, them se gjeta aty dy kripa gjuhësore: Kriptën e të dënuarve dhe Kriptën e dënuesve. Veçse kriptën e dënuesve nuk e gjeta veç në nëntokën e Spaçit, po edhe në nëntokën e krejt Shqipësisë.

KRIPTOGJUHA SI KONTRATË E RE E SI ELEMENT IDENTITAR

Ligjërimi i kriptuar është një formë shprehjeje gjuhësore, qëllimisht e tjetërsuar, apo e shurdhuar – le ta guxojmë këtë cilësor). Ky ‘shurdhim’ bëhet enkas për ta fshehur kumtin e vërtetë nga elementë të jashtëm të bashkësisë nga njëra anë, e m’anë tjetër për të ofruar një nivel të qartë kuptueshmërie nga anëtarët e gjithëpranuar, a më saktë nga ajo nënbashkësi të cilën sociolinguistika e kategorizon si “zona e konfidencës në rrjetin social-kulturor”. Kjo praktikë është një formë e kriptokomunikimit, në të cilën gjuha natyrore përshtatet me strategjitë e errësimit semantik përmes përdorimit të metaforave të koduara, aludimeve kulturore, elipsave të qëllimshme, përmbysjeve sintaksore, kuptimeve të dyfishta ose neologjizmave konvencionalë (Halliday & Hasan, 1985; Eco, 1976). Duke iu përmbajtur edhe më tej tiparit bashkësi-formues që ka ligjërimi i kriptuar, mund të themi pa drojë se grupimet që sendërtohen prej tij, janë të llojit “*community of practice*” - bashkësi praktikash komunikuese – (Eckert 2006). E nëse i këqyrim si të tilla, atëherë ligjërimi i kriptuar del të jetë një element identitar e jo thjesht një mjet pragmatik marrëveshjeje. Veçse për ta fituar thelbin identitar, atij i duhet të prishë një marrëveshje të mëparshme e të ndërtojë një marrëveshje të re, të posaçme, e cila më shumë sesa mbi semiotikën e re që krijon, bazohet mbi elementin social-kulturor prej nga lind. Semiotika e re është rrjedhojë e këtij ligjërimi, e jo shkas i tij, porse pikërisht kjo semiotikë e re merr funksion identitar.

Për nga këndvështrimi semiotik, kriptogjuha nuk përputhet me çka Saussure përshkruan kur analizon lidhjen mes shenjës, shënjesit e të shenjuarit – një sistem thuasje statik, i trashëguar e arbitrar ndaj përdoruesve të tij. Saussure e përkufizoi gjuhën si një sistem shenjash arbitrarë, të cilat marrin kuptim nëpërmjet marrëveshjes sociale. Por Spaçi e sfidon këtë model. Në këtë burg, ku mbijetesa kërkonte fshehtësi dhe ku çdo fjalë e thënë gabim mund të sillte pasoja fatale, fjala humbi lidhjen e saj të zakonshme me domethënien.

“S’kam fjetë mirë mbramë.
Dolën merimanga në qeli”



“Me kalimin e viteve vura re se zhargoni i burgut kishte shumë fjalë që nuk i kisha dëgjuar ndonjëherë më parë dhe ku terma si kaush, mish, dajë, kishin marrë një kuptim krejt tjetër.”¹

Të njëjtën qasje e konfirmojnë edhe intervistat tona me ish-të burgosur të Spaçit. Të pyetur se çfarë donin të dinin më së shumti nga jashtë gjatë takimeve të rralla me të afërmit, përveç gjendjes së familjarëve e miqve, ata të përgjigjen thuajse të gjithë: “Nuk prisnim thjesht me dalë ne vetë; edhe jashtë, prapë brenda kishim me qenë. Donim lajme se a po jep shenja me marrë fund sistemi”. Dhe këtu kërshtëria vjen e shtohet. Në ç’formë thënieje mund të pyesnin e të merrnin përgjigje nën kushtet e mbikëqyrjes totale? E ata të riprodhojnë një nga dialogët me të afërmit.

“Ne i pyesnim familjarët: ‘Si është daja?’. E ata na gjegjeshin: ‘Nuk â hiç mirë. I ka dalë diabeti i naltë e i ka dhanë shqetësime edhe në zemër’”.

Për veshin e kujtdo që nuk qe pjesë e kësaj marrëveshjeje semiotike (e sidomos për veshin e përgjuesit, ky dialog qe krejt neutral, pra i pashenjuar. Për zonën e konfidencës “daja”, siç na e dekodifikuan të intervistuarit, ishte Enver Hoxha, ndaj po merrnin lajme për sëmundjen e tij. Me shumë fjalë ndodhte një semiozë e tillë, e sidomos me gjuhën e solidaritetit mes të burgosurve. Kësisoj “merimanga” shenjonte tradhtarin mes tyre e gjendej në fjalitë: “S’kam fjetë mirë mbramë. Dolën merimanga në qeli”. Ndërsa “sinjali” shenjonte spiunin e ndërkalur enkas. Gjenden në leksikun e tyre edhe eufemizma ndaj formave të torturës, si fjala vjen “vathët”, fjalë me të cilën quanin torturat me korrent pas veshit, të cilat linin si pasojë shenja të qarta epiderme në bulat e veshit, si të ishin ornament. “A t’i paskan vu vathët?”. Shenjimi i torturës si ornament zbukurues flet për shpirtin e tyre sa njëmijë narrativa të marra së bashku.

Të intervistuarit tregojnë se edhe familjet, si pjesë e zonës së konfidencës, qenë po ashtu pjesë e marrëveshjes së gjuhës së kriptuar. Në të folmet e tyre ata shmangnin referencat e qarta ndaj politikës, gjyqeve ose persekutimit dhe përdornin fjalë kyçe për të komunikuar vendime ose ngjarje familjare (si vdekje, arrestime, dhunë etj.). I zëvendësonin emrat me nofka fëmijësh ose terma “neutralë” përzemërsie, ose u referoheshin citimeve nga proverbat, këngët popullore ose vargje fetare.

Shembull i referuar gjatë intervistave: “Të gjithë janë në vendin e tyre si më parë”.

Singeriteti në komunikimin me zonën e konfidencës, sidomos me familjarët mbetet parakushti kryesor psiko-emosiv për të dënuarit, në një botë krejtësisht të rrejshme, ku e rrejshmja as nuk përpiqej të kamufllohej, ngase dyshimi që i dyshuari i parë i sistemit, dhe më i rrezikshmi. Për rrjedhojë, për ta vazhduar komunikimin e singertë, të burgosurit dhe familjet e tyre zhvilluan strategji kriptolinguistike:

- Përdorimi i shprehjeve gjenerike, por të intensifikuara të dashurisë:
“Jam shumë mirë me shëndet. Jam fort mirë dhe gjithmonë mendoj për ju”. Shprehje e cila, sipas tyre tejçonte mesazhin: “Nuk jam mirë, por nuk mund ta them. Po qëndroj i fortë falë jush”.
- Aludime gjeografike, meteorologjike dhe sezonale:
“Këtu është shumë ftohtë, siç nuk ka qenë kurrë”. Kuptimi i referuar: përkeqësim i kushteve, izolim, ndëshkim.
- Fraza të kodifikuara ose të paqarta midis prindërve dhe fëmijëve, siç na referon një ish-mësues, i dënuar me 18 vjet në burg të Spaçit: *“Kujdes me librat, lexoji mirë”*, e cila sipas tij dekodifikohet në: *“Mos i beso asaj që lexon apo asaj që të mësojnë”.*

Së këndejmi, në leximin e gjuhës së kriptuar të burgjeve, para studiuesve del një çështje parësore: si ta lexojmë funksionin e saj, e për pasojë edhe natyrën e saj? Qasja më e thjeshtë, po sipas nesh e pasaktë, është ta klasifikosh ngushtësisht si varietet reagent me funksion shpëtues. Kësi shtegu je ndalur veç te forma, duke lënë jashtë krejt përkimet semantike e paradigmatiche të këtij varieteti me të ngjashmit e tij në të tjera vende totalitare e diktatoriale. Çfarë deshën të ruajnë duke kriptuar gjuhën këta të dënuar politikë? Vetën nga pasoja të tjera? Shumë pak ta thuash këtë. Vetën, po të donin, mund ta kishin ruajtur së pari duke mos e shprehur. Komunikimi midis të burgosurve politikë mes vetit si dhe me familjet e tyre në Shqipëri gjatë diktaturës nuk mund të lexohet linearisht: ai zhvillohet si një fushë semiotike mbijetese, përmes së cilës nuk kërkohet të mbijetojë thjesht I Gjalli, por Njeriu, jo thjesht Jeta, por Kuptimi i Jetës. Në të gjuha përkulet, maskohet, fragmentohet, por nuk shuhet. Liria, qëndresa, dinjiteti, dhimbja e shpresa kalojnë përmes fjalëve të thyera, heshtjeve

të ngarkuara, frazave në dukje banale, të cilat bëhen bartëse e kuptimeve të thella, të ndara vetëm brenda asaj marrëdhënieje intime dhe elastike.

Duke iu rikthyer semiozës së kriptimit, kjo shprehje e domethënies e vendos gjuhën në një gjendje liminale; ajo 'shurdhohet', është ende funksionale, por jo më transparente. Ky lloj varieteti gjuhësor hyn në atë që Agamben do ta quante "zona e përjashtimit", ku kuptimi ekziston, por jashtë rregullave normale të shenjimit. Në këtë këndvështrim, gjuha e Spaçit, për nga tipologjia e saj i afrohet më së shumti tipareve të një zhargoni grupi. Karakteristika kryesore sociolinguistike e zhargonit të grupit është se përmes semiozës tipike, zhargoni bashkon e ndan njëherësh, duke u bërë kështu elementi kryesor identitet-formues i grupit: bashkon të ngjashmit me të cilët bëhet marrëveshja e re gjuhësore, pikërisht se janë të ngjashëm, dhe lë jashtë të ndryshmit, duke mos i bërë pjesëtarë të semiozës, pra as të identitetit. Kjo pasi, ndryshe nga ligjërimi neutral, ligjërimi i kriptuar kalon nëpër procesin e semiozës së vijuar (varësisht nga besueshmëria e përdoruesve), është heterogjen dhe përmban kodifikimet e çdo idiolekti, të cilat më pas me marrëveshje e rimarrëveshje kolektive, aspak arbitrare, tejçohen duke u shndërruar në zhargon të grupit (a bashkësisë). Thënë ndryshe, ligjërimi i kriptuar përshtatet mirë me praktikat semiotike që Barthes (1970) i përcakton si *gjuhë e heshtjes*, tek e cila e pathëna dhe e thëna aluduese prodhojnë kuptimësitë. Ajo vepron si një gjuhë brenda gjuhës (Lotman, 1990), si një nënkod i ndërtuar enkas për të komunikuar në mjedise kontrolli, censure ose kërcënimi. E pikërisht në burgje, kjo formë diskursive merr vlera identiteti, solidariteti dhe mospajtimi kriptik.

Nga një perspektivë sociolinguistike, ligjërimi i kriptuar i burgut të Spaçit, e jo vetëm, mund të interpretohet si një praktikë diskursive e qëndresës dhe e mbrojtjes simbolike, e miratuar nga individë ose grupe në kushte të cenueshmërisë komunikuese, për shembull, në kontekste të mbikëqyrjes politike (Foucault, 1975), burgosjes (Goffman, 1961) ose shtypjes ideologjike (Scott, 1990). Në këto kontekste, komunikimi paraqet artikulum semantik të dyfishtë: ai ka një sipërfaqe gjuhësore neutrale dhe një nëntekst të dekodifikueshëm vetëm për ata që ia kanë farkëtuar atij semiozën (lidhjen dhe rilidhjen e vijuar mes formës dhe përmbajtjes).

[2] Instituti
i Studimeve për
Krimet dhe Pasojat e
Komunizmit. (2024).
Letters from hell
[Ekspozitë]. Piramida
e Tiranës, Tiranë,
Shqipëri.


Në kushtet e mungesës së plotë të lirisë dheurvejimit të vazhdueshëm, të burgosurit politikë në Spaç zhvilluan një formë të veçantë komunikimi — një gjuhë kriptike që u shërbente si mjet mbijetese dhe qëndrese. Kjo gjuhë përfshinte përdorimin e metaforave, simbolit dhe zhargonit të koduar për të shmangur zbulimin nga autoritetet. Për shembull, në ekspozitën “Letters from Hell”² në Tiranë, u shfaqën letra të shkruara nga të burgosurit që përshkruanin kushtet e rënda në burg dhe shpresën për ndryshim, duke përdorur shpesh gjuhë të koduar për të shmangur ndëshkimin. Kjo pasi në mjediset ekstreme, si Spaçi i Shqipërisë komuniste, gjuha përballet me një krizë ekzistenciale: marrëdhënia tradicionale mes shenjës dhe domethënies prishet. Në vend të një hapësire të lirë bashkëndarjeje, ajo shndërrohet në një sistem kriptografik ku fjala shërben më tepër për të fshehur, sesa për të zbuluar. Ky fenomen kërkon të kuptohet jo vetëm si shenjë represioni, por si një proces i ri i krijimit të një kontrate të veçantë sociale nga përdoruesit e tij. Wittgenstein (1953) thekson se kuptimi i fjalëve qëndron në përdorimin e tyre. Në Spaç, përdorimi nuk synonte më transmetimin e hapur të informacionit, por edhe ndërtimin e komunitetit:


Nëse do të dish për gjuhën e burgut, nuk do të gjesësh njohës më të mirë se unë sepse e kam jetuar burgun në tri kohë. Sepse zhargoni është gjuha e krijuar nga të burgosurit, kurse fjalët që i përdorin edhe gardianët janë pjesë e shqipes që përshkruan burgun. Janë huazime që i kemi nga gjuhët e atyre që na kanë sjellë burgun, siç kemi motor, karrocieri, kofano nga italianët që na sollën makinën. Gjatë vuajtjes së dënimit të parë mbaj mend se për burgun fjalët mbizotëruese kanë qenë nga gjuha osmane. Burgut vetë i thoshin më shumë hapsane, sesa burg, që vjen nga kështjellat në perëndim. Pastaj hynë fjalët sllave të kohës së burgut tim të dytë.³

Zef Male

[3] Po aty, ff.
76-77.

Një pasazh ky veçanërisht domethënës nga dëshmitë e Spaçit, i cili shpalos strukturën e ndërlikuar dhe historike të ligjëritimit kriptik. Teksa rrëfen se “zhargoni është gjuha e krijuar nga të burgosurit”, dëshmitari vendos një dallim të qartë midis fjalëve të zakonshme që përdorin edhe gardianët, dhe gjuhës së veçantë të të burgosurve, e cila shërben si formë identitare dhe mbrojtjeje. Në këtë narrativë, huazimet nga





gjuhë të huaja nuk janë thjesht çështje leksiku, por shënues historikë të pushtimeve dhe kontrollit: fjalët osmane i përkasin një epoke të hershme të burgosjes, termat italianë lidhen me kolonializmin dhe modernizimin autoritar, ndërsa fjalët sllave i përkasin fazës së dytë të burgimit, në periudhën e ndikimit socialist. Ky shtresëzim historik në gjuhën e përditshme të burgut dëshmon për mënyrën se si fjalët jo vetëm reflektojnë realitetin represiv, por edhe e regjistrojnë atë si një palimpsest i heshtur.

Kuptimi bëhet kështu praktik: ai u përket vetëm atyre që dinë rregullat e lojës. Zhargoni i burgut politik shndërrohet në një lojë të mbyllur gjuhësore, ku hyrja është privilegj dhe jo e drejtë universale.

Në intervistat me ish-të burgosur politikë të Spaçit bien në sy edhe dallime brenda ngjashmërive. Sipas dëshmive të mbledhura, të burgosurit nga Dibra kishin aftësi të veçantë për të përdorur një diskurs më të përkulur dhe metaforik, i cili u lejonte të komunikonin në mënyrë të fshehtë dhe efektive. Ata thanë disa herë: “Vetëm dibranët dinin të flisnin shumë mirë kështu... më të fshehtë, më metaforikë...”.

Kush e njeh karakteristikën e të folmeve dibrane, e në veçanti të zonave në të ashtuquajturën “Dibra Egër” (zonat malore), sikundër Muhurri e Luznia, e ka të qartë se edhe në jetën e përditshme ata shquhen për natyrën alegorike e metaforike të të folmeve (e mirënjohura alegori dibrane). Ajo çka vlen të thuhet për të burgosurit politikë dibranë në burgun e Spaçit pas kësaj dëshmie të shokëve të tyre, të cilët i veçojnë ata në aftësinë kriptuese, është që metaforizimi tradicional u bë kësodore një kapital i ri. Kriptogjuha tradicionale shërbeu si mjet dallimi dhe besueshmërie, duke ndërtuar një kontratë të re sociale që zëvendëson atë të mëparshmen, kur alegoria përdorej në një shoqëri ende të lirë.

Në sendërtimin e ligjërimit të kriptuar të Spaçit nuk u përfshi vetëm gjuha e folur, ajo në kuptimin klasik të saj verbal, e as vetëm heshtja domethënëse apo paralinguistika si gjuhë trupi. Nga dëshmitë e vuajtësve bën ferk edhe një tjetër element i rëndësishëm: “telefoni i murit”. Ç’na rrëfejnë se ishte kjo formë komunikimi? Trokitje në muret ndarëse të qelive sipas një kodi të caktuar: Tingulli A – një trokitje, meqenëse qe tingulli i parë i alfabetit. Tingulli B – dy trokitje e kështu me radhë. Ndarja mes fjalëve? Një heshtje më e gjatë mes trokitjeve. A lindi njëmend në burgje ky lloj komunikimi? Nga një studim i mëparshëm sociolinguistik (punim ende në vijim, rezultatet e të cilit nuk

janë finale), i cili synon të dokumentojë *post factum* ligjërimet e fshehta në zonat urbane për periudhën '44-'90, më rezulton se telefoni i murit, ndonëse më pak i artikuluar, qe shpikur dhe përdorej nga rinia qytetëse e aksioneve dhe zboreve në kushte izolimi, ta zëmë në raste veçimi nëpër kapanone për shkak epidemish. Përdorej kryesisht për të sinjalizuar orën ose largimin e personelit shëndetësor.

Në burgun e Spaçit ky kod i varfër komunikimi u artikulua edhe më shumë. Përdorej për të ndërtuar mesazhe njoftuese (prani spiunësh ose rojash), për mesazhe që jepnin kurajë a ngushëllonin, për mesazhe që pyesnin mbi shëndetin e të torturuarve. Arrinin të tejçonin me durim tekste të tëra duke i dhënë gjuhës përmasën më të vyer njerëzore edhe në kushte çnjerëzuese.

Afërmendsh, rrethi konfidencial i telefonit të murit qe ende tejet i shtrënguar, e meqë u përmend rrethi konfidencial, ia vlen të arsyetojmë edhe për ndarjen (grupimin) mes të burgosurve. Për së pari, ata dëshmojnë se ndaheshin në të burgosur ordinerë dhe të burgosur politikë, por dëshmojnë se mes tyre nuk kishte komunikim. Kjo jo vetëm për ndalesën e imponuar nga rojat, por edhe për vetë qasjen e të burgosurve ordinerë ndaj atyre politikë. Të intervistuarit tanë ngulmuan të na thonin se burgu i Spaçit përfundoi së ndërtuari në prill të vitit 1968, dhe u ndërtua nga të burgosurit ordinerë, siç i quanin ata, të cilët qenë të pranishëm kur mbërritën e u vendosën aty të burgosurit politikë. Sipas dëshmimeve të të intervistuarve, të burgosurit ordinerë e pritën ardhjen e tyre me fjalët: “Erdhën armiq’ e popullit. Këtu do t’jua bëjmë edhe varrin”, sigurisht kjo qasje, përveçse për klimën politike në Shqipëri, dëshmon shumë edhe *in strictu sensu* për si qenë të ndërtuara rrathët e konfidencës që përshkonte gjuha e kriptuar. Madje, sipas intervistave, kishte ndarje kategorish edhe brenda vetë Spaçit. Ish-të burgosurit na rrëfyn se dallonin dy nëngrupime të mëdha, të cilat i patën emërtuar kështu: “të përmbysurit” dhe “revizionistët”. Këta të dytët qenë bijtë e ish-anëtarëve të Byrosë Politike a gjithsesi të funksionarëve të lartë të nomenklaturës, të shpallur mandej armiq nga paranojat e pushtetit. Ndonëse shtynin së bashku vagonë me dhe mineral nëpër galeritë e Spaçit, “të përmbysurit” prireshin të mos e ushtronin gjuhën e kriptuar me “revizionistët”, pra kuptohet vetiu se ky varietet prirej fillimisht të mos i përfshinte këta të dytët në identitetin e grupit. Afërmendsh, ky veçim nuk qe aprioristik e kategorik *in toto*, sikurse nuk është e tillë asnjë dinamikë sociolinguistike e grupit social.

FUNKSIONI POETIK I KRIPTOGJUHËS

Në sistemet totalitare, kufizimi i fjalës nuk i mbyllet fjalët, i bën ato më të zgjuara. Dukuria e metamorfozës gjuhësore mund të rrokët edhe më mirë nëse ligjërimin e kriptuar të Spaçit nuk e shohim të izoluar në vetvete, por në një krahasim edhe me forma të gjuhës së koduar, të lindura në kushte represive, si fjala vjen me TAP-in (akronim për *Tyuremno-Lagernyi Argo*) e zhvilluar në gulagët sovjetikë.

Kjo metamorfozë besojmë se zhvillohet duke u mbështetur në një nga funksionet e posaçme të ligjërimin (Jakobson, 1962), e pikërisht te funksioni poetik i tij. Në vështrim të parë gjuha e kriptuar e burgjeve dhe funksioni poetik sipas Jakobsonit janë dy koncepte që u përkasin fushave të ndryshme: njëri është fenomen historik-social dhe tjetri një nocion teorik-linguistik. Por nëse analizohen në mënyrë krahasimtare, ato ndihmojnë për të kuptuar më mirë rolin kompleks të gjuhës në kushte të jashtëzakonshme të represionit ideologjik, e veçanërisht në mjedise dënimi sikundër burgjet e qelitë.

Në kontekstin e burgjeve, funksioni poetik i gjuhës merr një rol thelbësor në vetë gjuhën e kriptuar. Nëse funksioni poetik i ligjërimin krijon ndjeshmëri dhe lidhje emocionale, kriptogjuha ndërton solidaritetin e përdoruesve pikërisht bazuar mbi këto dy efekte. Viojmë më tej: Nëse metafora bëhet bartësja kryesore e ligjërimin poetik, kriptogjuha ndërton kuptimet e kriptuara duke u mbështetur mbi shtegtimin semantik të metaforës. E pikërisht duke u ndërtuar më së shumti mbi metaforën, në ligjërimin poetik rritet shumë roli i kontekstit dhe i kodit të përbashkët. E pikërisht kjo rritje e disafishtë e rolit të kontekstit përmes kuptimësive implicite krijon edhe kodifikimin e saj për një rreth të ngushtë njerëzish, të cilët duke ndjekur arsyetimet e Eckert (1992) mund t'i cilësojmë fare mirë si “bashkësi praktikash” (*community of practice*). Veçse do thënë qartë se funksioni poetik i ligjërimin nuk u përdor në burgje për qëllime mirëfilli artistike, por si një akt i qëndresës kulturore dhe shpirtërore. Madje nuk ngurrojmë të pohojmë se nga ky këndvështrim, kriptogjuha e Spaçit përfaqëson një nga përdorimet më të larta të funksionit poetik të gjuhës: jo për të bukurën estetike, por për të mbijetuar, për të ruajtur kujtesën,

për të ndarë dhimbjen dhe për të ndërtuar një botë tjetër brenda kufijve të lirisë së mohuar. Sjellim këtu për ilustrim të sa më lart, një strofë të mbijetuar nga një poezi e shkruar në Spaç, në një qoshk të përthyer gazete:

*Nën baltë e hekur rritet një lulë,
në heshtje çel, pa fjalë e pa za,
kush e sheh e din ç'mban në gji kjo bulë,
është fjala që jeton kur s'ka ma na.*

Lulja është pikërisht fjala e fshehtë, e cila mbin në baltë e hekur (metaforë për Spaçin), e për të cilën shkruesi i këtyre radhëve beson se ka me jetu përtej jetëve njerëzore të të dënuarve, të cilët sipas dëshmive që mblodhëm, nuk shpresonin të dilnin gjallë nga ai vend, porse, nga sa lexojmë, kanë shpresuar se fjala e lirë e tyre ka me rrojtë edhe “kur s'ka ma na”.

Le ta krahasojmë strofën e mësipërme me një strofë simotër, të mbijetuar ndër gulagë:

*Ajo që ndrin pa dritë,
e flet pa zë,
është ajo që nuk pushon kurrë –
fjala jonë.*

Të gjashta funksionet që Jakobson (1960) i njeh ligjëritimit në kushte lirie, realizohen po ashtu në kushte mohimi lirie, porse duke marrë secili funksion një specifikë të re situacionale.

Në dokument regjistrohen më shumë se 20 kategori armësh, përfshirë:

- 1 Funksioni referencial realizohet duke përcjellë informacion të qartë përmes kriptimit
- 2 Funksioni ekspresiv përmbushet duke shprehur ndjesi, bindje a qëndrime përmes figurave artistike të kriptuara e të bashkëndara
- 3 Funksioni konativ (bindës), realizohet pasi përmes tij nxiten veprime e qëndrime, apo edhe mosveprime
- 4 Funksioni fatik ruan kontaktin mes të burgosurve si dhe mes tyre e botës së tyre jashtë (e madje sot edhe mes vetë ish-të dënuarve e kujt shkruan këto radhë, ndonëse në tjetër mot e stinë)
- 5 Funksioni metalinguistik përmbushet duke treguar dije e vetëdije për kodin e përdorur si një kriptogjuhë
- 6 Funksioni poetik, siç edhe e arsyetuar, përqendrohet i gjithi te forma, për të strehuar brenda saj përmbajtjen.

Po rendisim më poshtë disa shembuj krahasues të kriptimit mes shenjave gjuhësore të Spaçit dhe atyre të TAP-it ndër gulagë. Afria e fortë tipologjike mes përzgjedhjeve është edhe afria e fortë që kanë qeniet e vetëdijshme ndaj vlerës së lirisë.

Kuptimi	TAP (Gulag)	Kriptogjuha (Spaç)
Dhunë fizike	Teatr (teatër)	Furra, pjekja
Gardian	Beryoza (thana)	Kali, syri
Spiuni	Shestërka (gjashta)	I ngrysuri, vëllai i gjatë, merimanga
Qelia e izolimi	Pika	Kutia, kaushi, shpella
Arratisje	Fluturim	Udhëtimi për liri
Letër e koduar	Listok	Letra e natës, lutja
Arrestim i ri	Ftohje	Ra shi në Spaç
Torturë hetuesie	Mjekësi e zezë	Mishi i qengjit, opera
Vrasje e fshehtë	Shtrati i bardhë	Bari i thatë
Shpresa		Flaka
I burgosur qëndrestar		Lisi
Mundësia për lajm		Dritarja
Lajm i mirë		Trëndafili
Lajm nga jashtë		Goca
Lajm i rremë nga brenda		Mjegulla
Spiun, informator		Çelësi
Bashkëpunëtorë Sigurimi		Gurët
Arratisja, dëshira për liri		Nusja
Gardiani i dhunshëm		Kali

Qelia e ndëshkimit	Shpella
Hetuesit	Bletët
Vend sekret letrash	Thesi
Grupi i të besuarve	Trupi
Lajm i mirë nga jashtë	Qumështi
Informacione të vogla	Thërrimet
Liri, informacion i mirë	Drita
Grua që sjell info	Goca
Ekzekutim a rrezik	Plumbi
Letër a dokument	Pllaka
Poshtërim në burg	Balta
Lëvizje e papritur	Rrota
Sinjale shprese	Xixat
I sapoburgosuri	Zogu
Lajm i hidhur	Buka e thatë
Bisedë e koduar	Kaseta
Person ndërlihdës	Ura
Mbledhës i heshtur lajmesh	Peshku
Fjalë që dëmtojnë	Helmi
Torturë psikologjike	Nata e gjatë
Alarm, rrezik	Tymi

Për ta rrokur një grimë kontekstin semiotik, po edhe emotiv të këtyre lemave të kriptuara, po sjellim veç fjalinë përmbyllëse të një “pllake”, pra të një letre që munda të dalë nga Spaçi:

“Në këtë natë të gjatë ku rrihet veç me hije, drita e nuses është shpresa ime. Gurët nuk do të ma presin rrugën time”.

NË VEND TË PËRFUNDIMEVE

Këto shënime nuk marrin përsipër të nxjerrin përfundime mbi një varietet ende gjuhësisht e antropologjikisht të pastudiuar të repertorit të shqipes, sikundër është ligjërimi i kriptuar në burgjet e diktaturës. Kjo cekasë studimore besojmë se vlen së paku për të treguar rëndësinë dhe nevojën që kripta gjuhësore e të dënuarve të çelet nga drita e shqyrtimit disaplanësh. Për këtë zbritje ka nevojë e gjithë shoqëria shqiptare.

Por, sikundër u tha në hyrje të kësaj cekase, edhe një kriptë tjetër gjuhësore që lidhet jo vetëm me Spaçin, Burrelin, Tepelenën, Savrën, po me gjithë Shqipërinë Totalitare, ka nevojë të çelet e të studiohet, e ndoshta duke u studiuar, edhe të deformulëzohet: kripta e gjuhës së tiranëve.

Në mbarim të intervistës e pyeta një ish-të burgosur, mësues që kishte kaluar plot 17 dimra në Spaç se cila ishte sot dhimbja e tij më e thellë.

“Do të ta kallxoj”, - më tha. – “Vjet erdhën në Spaç do maturantë. Në një nga këto vizitat shkollore përkujtimore iu afrova një nxënëseje dhe e pyeta: ‘Ç’është për ty burgu i Spaçit?’. E ajo, flakë për flakë, m’u gjegj me formulën e vjetër: ‘Është burgu i armiqve të popullit’. Kjo përgjigje e saj, tash në muzg të jetës sime, është edhe dhimbja ime më e thellë. Kur do shëlbohemi ne?”.

Ndaj, pa mëtuar të parashtrojmë përfundime, po i përmbylim këto radhë me grishjen për të çelur kriptat. Veçse çelësi i vetëm i kriptave mbetet studimi, jo propaganda. Kjo e fundit priret të përdhosë relikte e të amshojë demonë.

REFERENCA

- Agamben, G. (1998). *Homo sacer: Sovereign power and bare life*. Stanford, CA: Stanford University Press.
- Bakhtin, M. (1981). *The dialogic imagination: Four essays*. Austin: University of Texas.
- Barthes, R. (1970). *S/Z*. Paris: Éditions du Seuil.
- Bourdieu, P. (2001). *Langage et pouvoir symbolique*. Paris: Éditions du Seuil.
- Eco, U. (1976). *A theory of semiotics*. Bloomington: Indiana University Press.
- Foucault, M. (1975). *Surveiller et punir: Naissance de la prison*. Paris: Gallimard.
- Goffman, E. (1961). *Asylums: Essays on the social situation of mental patients and other inmates*. New York: Anchor Books.
- Gramsci, A. (1949). *Quaderni del carcere*. Torino: Einaudi.
- Halliday, M. A. K., & Hasan, R. (1985). *Language, context, and text: Aspects of language in a social-semiotic perspective*. Geelong, Australia: Deakin University Press.
- Jakobson, R. (1960). *Closing statement: Linguistics and poetics*. In T. A. Sebeok (Ed.), *Style in language* (pp. 350–377). Cambridge, MA: MIT Press.
- Klemperer, V. (2006). *Language of the Third Reich: LTI – Lingua tertii imperii: A philologist's notebook*. London: Continuum.
- Lotman, Y. (1990). *Universe of the mind: A semiotic theory of culture*. London: I.B. Tauris.
- Lubonja, F. (1994). *Ridënimi i fjalës*. Tiranë: ISHSH.
- Lubonja, F. (2023). *Jetë burgu*. Tiranë: Scanderbeg Books.
- Pllumi, Z. (1995/1997/2001). *Rrno për me tregue*. Tiranë: Hylli i Dritës.
- Rousso, H. (2002). *The haunting past: History, memory, and justice in contemporary France*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
- Saussure, F. de. (2002). *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*. Tiranë: K&B.
- Scott, J. C. (1990). *Domination and the arts of resistance: Hidden transcripts*. New Haven: Yale University Press.
- Solzhenitsyn, A. (2002). *Arcipelago Gulag*. Milano: Mondadori.
- Wittgenstein, L. (1953). *Philosophical investigations*. Oxford: Blackwell.

*PEIZAZHI I HESHTJES
ARKIVORE:*

*RASTI I REPARTIT 303,
SPAÇ, MIRDITË.*

SOKOL ÇUNGA



Shfaqja e shkrimit duket se përkrah shfrytëzimin, jo ndriçimin e njerëzimit. [...] Nëse hipoteza ime është e saktë, funksioni kryesor i shkrimit si mënyrë komunikimi është të lehtësojë skllavërimin e qenieve të tjera njerëzore.

(Claude Levi-Strauss, “A Writing Lesson” në: *Tristes Tropiques*, Criterion Books, 1961, fq. 292.)

Legjendat historike thonë se sistemet e diktaturës totalitare kishin gjithçka nën kontroll, deri në hollësitë më të parëndësishme. Legjendat thonë, po ashtu, se çdo informacion i dobishëm për sistemin, ruhej me rigorozitet në një arkiv të fshehtë dhe të organizuar në mënyrë të përkryer. Ndërkaq, praktika flet për realitet krejt tjetër: si në çdo vend me procedura burokratike, edhe vendet që kanë kaluar nën sisteme të diktaturës, mes tyre Shqipëria, kanë specifikat e veta në sferën arkivore, pa premtuar asgjë të çuditshme.

Njëra specifikë e arkivave nën diktaturë është ndalimi i shfrytëzimit të lëndës arkivore, duke e përligjur këtë me ruajtjen e sekretit prej armikut. Gjatë periudhës së Shqipërisë socialiste 1945 – 1992, shumëçka klasifikohej “sekret” dhe “tepër sekret” prej organeve ligjvënëse dhe ligjzbatuese në Shqipëri. Sipas “*Udhëzim nr. 11, datë 14/12/1961, mbi çështjet sekrete që nuk duhet të botohen*” miratuar nga Këshilli i Ministrave, ndalohej botimi i të dhënave për çështje si: numri i popullsisë, lindjet dhe vdekjet vjetore, vdekshmëria foshnjore, kilometrat e rrjetit hekurudhor dhe rrugor, metrat lineare të rrjetit elektrik dhe të prodhuara nga uzinat vendase, PBB dhe konsumi etj., të cilat konsideroheshin sekret. (Edhe vetë Udhëzimi është i klasifikuar “tepër sekret”.) Këto të dhëna u shërbeheshin vetëm një grusht personash të autorizuar, ndërkaq mund të publikoheshin vetëm si shifra statistikore krahasuar me vitet e mëparshme, jo si shifra të sakta.



Brenda së njëjtës frymë sekreti ruheshin, natyrisht, dhe e gjithë lënda dokumentare që kishte të bënte me repartet e riedukimit që vepronin në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Një nga pikat e “Udhëzimit” të mësipërm citon konkretisht se ndalohej botimi për: “Çështjet që u përkasin Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe që u referohen mbrojtjes dhe sigurimit të shtetit”, pa specifikuar asgjë më tej. Çka do të thotë se, përmes statusit “sekret” publikut i ndalohej informimi, ndër të tjera, për të dënuarit me akuzën “Për agjitacion dhe propagandë”, “Kalim i paligjshëm i kufirit”, “Tradhti ndaj atdheut”, “Sabotim”, e krime të tjera të natyrës politike. Publiku nuk kishte informacion në shifra për të dënuarit me vdekje për këto akuza, as për të burgosurit dhe të internuarit.

Teksa kohërat ndryshuan, dhe në Shqipërinë pas-totalitare u deklasifikuan dokumentet që ndaloheshin të konsultoheshin, publiku i interesuar për të shkuarën u informua në përputhje me normat ligjore të vendit. Mirëpo, a mjafton lënda dokumentare e krijuar dhe e ruajtur prej sistemit të shkuar për të kuptuar realitetin e kohës? Këtu hapim një parantezë të shkurtër teorike.

“Të shumtën e herëve më intereson ajo që nuk ndodh, territori mes ngjarjeve, ajo që quhet zbrazëti. Kjo zbrazëti ekziston në zonat apo mjediset e pashkruara dhe boshe, aty ku nuk i hedhim sytë kurrë” thotë Robert Smithson, kur flet për çështje të muzeologjisë”.¹ Ndonëse në planin global kjo zbrazëti merret, së shumti, me të shkuarën kolonialiste, casus-i që trajton vlen edhe për realitetin e Shqipërisë në periudhën e socializmit. Prej dekadash është e qartë se arkivat nuk janë mjedise neutrale mes shoqërisë dhe pushtetit (Michel Foucault, Jacques Derrida, Joan M. Schwartz-Terry Cook etj.). Arkivat janë instrumente të pushtetit, ndaj dhe zbrazëtia e mësipërme, ose heshtja e rafteve arkivore, nuk është kurrsesi rastësore.² Peizazhi i kësaj heshtjeje përbëhet, zakonisht, prej pakicave kombëtare, pakicave racore, grupeve gjinore, grupeve financiarisht të përjashtuara dhe, në rastin tonë, prej klasave shoqërore të goditura prej luftës së klasave dhe diktaturës së proletariatit.

Heshtja e arkivit gjatë periudhës së Shqipërisë së realizmit socialist nuk është e njëanshme. Është heshtje me barrë të dyanshme, pasi, nga njëra anë, duke mos i siguruar qytetarit të drejtën për të zotëruar dokument arkivor, nuk i jep argument mbi të cilin ai do të mundej, për çfarëdo arsyeje, të mbështeste

[1] Smithson, R. (1996). *What is a museum: A dialogue between Allan Kaprow and Robert Smithson*. In J. Flan (Red.), Robert Smithson: *The collected writings* (f. 44). Berkeley: University of California Press. [Marrë nga Carter, R. G. S. (2006). *Of things said and unsaid: Power, archival silences, and power in silence*. *Archivaria*, 61(September), 215–233.]

[2] Për termin “heshtje arkivore” shih: Carter, Rodney G.S. 2006, op.cit.

[3] AIDSSH,
Arkivi i MPB, DPB
Mirditë. A6, 123,
ORV Rep. 303, Spaç-
Administrativ.

Arkivi i MPB,
DPB Mirditë. A2, D4-13,
ORV Miniera e Bakrit
Spaç – Industrial.

zërin e tij. Nga ana tjetër, zëri i pakicës apo i të marginalizuarit nuk arrin të bëhet pjesë e arkivit, për arsye të thjeshtë se këto kategori nuk janë pjesë që i shërbejnë pushtetit. Mirëpo, kur ndodh ky përjashtim, nuk ndikohet vetëm grupi i prekur prej heshtjes së arkivit, por e gjithë shoqëria e vendit, si në kohën kur ndodh ngjarja, ashtu dhe më pas.

Kur vijmë te rasti i Repartit të Riedukimit nr. 303, ndryshe njohur si Kampi i Spaçit, lënda arkivore lidhur me të përbëhet prej dy dosjeve, ose fashikujve, arkivorë që përmbajnë veprimtarinë agjenturore brenda territorit të Repartit 303 dhe në Fabrikën e Pasurimit të Bakrit në Reps (Mirditë). Dosjet janë krijuar për nevojat e Degës së Punëve të Brendshme, kanë qenë pjesë e Arkivit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe sot administrohen nga AIDSSH.³ Në “Dosjen “tepër sekret” të Objektit të Rëndësisë së Veçantë të Repartit 303 Spaç” ruhen gjithë veprimet agjenturore mes të dënuarve. Dokumentet përmbajnë raportet e oficerëve përkatës të Degës së MPB, deklaratat e bashkëpunëtorëve (agjentë, rezidentë, informatorë), procesverbalet e marrjeve në pyetje të të dënuarve, përshkrime të veprimtarisë së të dënuarve para dhe gjatë dënimit, e të tjera të dhëna që oficeri përkatës ka gjykuar të rëndësishme. Mes deklaratave të bashkëpunëtorëve hasim, gjithashtu, dhe plot banalitete, të cilat zor se i hyjnë në punë Degës apo regjimit në përgjithësi.

Nëse përfytyrojmë veprimtarinë e përditshme të të dënuarve, qartazi shohim se prej lëndës arkivore të krijuar nga Reparti 303 nuk zotërojmë:

- Dokumentim të jetës së përditshme të të burgosurve, veç rregullores së burgut. Nëse kemi informacion të kësaj natyre, dokumentimi na vjen nga dëshmitë e atyre që vuanin dënimin, jo prej institucionit shtetëror.
- Nuk kemi të dhëna për ushqimin, veshjen, kushtet e higjienës dhe të banimit, veç dëshmimeve të të dënuarve.
- Nuk kemi të dhëna për ndëshkimet disiplinuese të të dënuarve, por vetëm dëshmitë e këtyre të fundit.
- Nuk dimë prej informacioneve zyrtare vendet e varrosjes së atyre që u vranë në përpjekje për t'u arratisur apo ndërruan jetë duke vuajtur dënimin.
- Nuk kemi dokumentacion teknik (projekt, planimetri, plansheta etj.), lidhur me ndërtimin e ndërtesave të banimit të të burgosurve dhe për ndërtesat e personelit të Repartit 303.

[4] Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), shih në: Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Neni 15.

[5] Për marrëdhënien e arkivistit me pushtetin që buron prej punës së tij dhe paafësisë së arkivistit për të qenë neutral, shih: Schwartz, Joan M.; Cook, Terry. 2002. “Archives, Records, and Power: The Making of Modern Memory”, Archival Science 2: 1-19, 2002; për arkivin si instrument pushteti, shih: Derrida, Jacques. Archive Fever: A Freudian Impression, The University of Chicago Press, 1996.

Nga çështjet e mësipërme, informacioni që kemi sot në dorë ka ardhur i mbledhur përmes dëshmive të të dënuarve, intervistave dhe librave të shkruar e të botuar prej tyre, dhe për ta. Ndërkaq, aparati shtetëror, ai i cili duhej të garantonte ekzekutimin e drejtë dhe të ligjshëm të dënimit, shohim se nuk i ka dokumentuar çështjet e mësipërme, qoftë se i ka konsideruar të panevojshme, qoftë se nuk ka dëshiruar të dokumentohen shkeljet dhe abuzimet që prej dëshmive të mësipërme dimë se kanë ndodhur (në Spaç dhe gjetiu). Ose, ajo që nuk duhet të përjashtohet, gjithë dokumentacioni i munguar është lënë në harresë, pa kujdes dhe pa trajtimin e duhur sipas ligjeve lidhur me arkivat dhe lëndën arkivore, duke sjellë, si pasojë, asgjësimin e tij.

Pavarësisht arsyeve që sollën mungesën e kësaj lënde arkivore, tipet e dokumenteve të mësipërme, sipas rregullave në fuqi në kohën kur janë prodhuar, por edhe sipas atyre të sotshme për punën me dokumentet, nuk bëjnë pjesë në listën “tip” të dokumenteve që kalojnë në regjim ruajtjeje të përhershme.⁴ Madje, sikur cilido arkivist i trajnuar profesionalisht të kishte sot në tryezën e punës ato dokumente me detyrën që t’i përpunonte, do t’i kishte etiketuar “për regjim ruajtjeje të përkohshëm”, po të mos kishte urdhër të dytë. Sepse kështu funksionon burokracia arkivore.⁵

Qoftë janë prodhuar dokumentet e mësipërme, qoftë jo, ato nuk përbëjnë interes për historinë “e madhe”, pasi në kohën që krijohen janë thjesht ngjarje “banale”. Ndërkaq, janë pikërisht ato histori që dëftojnë me saktësinë e filmit dokumentar, (apo si kamerat e një *Big Brother-i*), mekanizmin çnjerëzor që vepronte në institucionet e vuajtjes së dënimit gjatë Shqipërisë socialiste.

Kështu, teksa arkivi është konceptuar për të shërbyer si instrument që vërteton kryerjen e detyrës nga i ngarkuari, elementi funksional i agregatit shtetëror, mungesa e dokumentacionit flet për individin dhe vullnetin e tij për të vepruar në një mënyrë, ose një tjetër. Individin në detyrë, oficeri, apo më tej arkivisti, reflekton ankthin burokratik të pushtetit, njëherazi edhe zbrazëtinë e qeverisjes: duke mos regjistruar të përditshmen e të dënuarit, shteti dëften se nuk i intereson arsyeja pse vdes i dënuari, por pse nuk nënshtrohet, pse nuk punon, pse nuk sillet si skllav etj.

Teksa jo gjithçka është shkruar, ose është ruajtur e shkruar, dikush mund të thotë: “E ç’rëndësi ka, dihet se çfarë ndodhte në Spaç, dimë shifrën e të burgosurve dhe të të vdekurve/ ekzekutuarve”. Pikërisht, ky qëndrim nënkupton këtu një *common sense* të një realiteti të jetuar. Mirëpo, ky realitet, bashkë me këtë *common sense*, vlen për kohën dhe njerëzit që i kanë jetuar, nuk bartet domosdo te pasardhësit dhe çdokush i interesuar, teksa kohërat dhe e përditshmja ndryshojnë. Nga ana tjetër, ajo që nuk është shkruar, ose nuk është ruajtur, lë hapësirë për të menduar se nuk duhej të shkruhej dhe / ose nuk duhej të ruhej. Këtu skllavërimi i njeriut, duke iu referuar fjalëve të Claude Levi-Strauss (1961) që përmendim në krye, nuk ndodh përmes shkrimit, por përmes mungesës së shkrimit.

Sa më i madh të jetë numri i të dëbuarve, të burgosurve, të ekzekutuarve, aq më shumë humbet mes shifrave aftësia për të perceptuar krimin. Atëherë kur çdo padrejtësi njerëzore, përligjur me mantelin e ligjit dhe të “ashtu ishte koha” apo “bëra detyrën”, të ndriçohet dhe të këqyret me imtësi, do të jetë më e qartë tragjedia që i ka ndodhur individit e më pas kolektivit. Për të kuptuar këtë, nevojitet jo thjesht empati, por informacion. Teksa informacioni sot vjen, kryesisht, nëpërmjet shifrave statistikore, e vetmja mënyrë për të rindërtuar historinë vetjake të çdo të dënuari është duke përfytyruar atë për të cilën dokumentet e arkivuara heshtin, atë që nuk transmetohet përmes gjuhës së shkruar.

“Vendosa që dosjen e Objektivit të Rëndësisë Veçantë të repartit riedukimit 303 Spaç-Mirditë ta arkivoj me afat ruajtje përgjithmonë, pasi ky repart është shkri (suprimuar) dhe se dokumentacioni i kësajë dosje ka vlera historike” (sic). Këto janë fjalët e fundit të fletës së fundit në Dosjen “tepër sekret” të Objektivit të Rëndësisë së Veçantë të Repartit 303 Spaç (deklasifikuar më 05.04.2018 nga AIDSSH). Kështu përfundon burokracia.

Nga viti 1992 qeveritë e njëpasnjëshme në Shqipëri janë përpjekur të vënë në vend drejtësinë tranzitore për të përndjekurit politikë në periudhën 1945 - 1992. Janë akorduar dëmshpërblime në shuma monetare për të dënuarit dhe / apo trashëgimtarët, janë akorduar të drejta studimi, bursa studimi etj., janë krijuar institucione që merren me studimin e përndjekjes dhe ndëshkimit politik në periudhën e mësipërme, vazhdimisht akordohen fonde që mbështesin veprimtarinë kërkimore dhe kulturore, e me radhë. Kanë mbetur ende gjëra për t'u bërë. Një nga ato raste për të cilat drejtësia tranzitore do ta ketë vështirë të kryhet është dhe gjetja e eshtrave të të vdekurve në Repartin 303, apo që u dënuan me vdekje, teksa vuanin dënimin në atë repart. Historia individuale e çdonjërit prej të dënuarve politikë, e argumentuar prej dokumentit arkivor, do të ishte tjetër çast i kryerjes së drejtësisë tranzitore. Pa ndodhur kjo, historitë që kanë për t'u shkruar më pas kanë për të qenë pikëtakimi i dokumentacionit të pjesshëm dhe i kujtesës së mugët.

REFERENCA

Burime parësore

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Arkivi i MPB, DPB Mirditë, A6, 123, ORV Rep. 303, Spaç–Administrativ.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Arkivi i MPB, DPB Mirditë, A2, D4–13, ORV Miniera e Bakrit Spaç – Industrial.

Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë (AQSH i RSH). Fondi “Këshilli i Ministrave”, Viti 1961, Dosja 61, fletët 4–7.

Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. (2003). Në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Neni 15, Lista tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me rëndësi historike kombëtare (RHK).

Burime dytësore

Carter, R. G. S. (2006). Of things said and unsaid: Power, archival silences, and power in silence. *Archivaria*, 61(September), 215–233.

Derrida, J. (1996). *Archive fever: A Freudian impression*. Chicago: University of Chicago Press.

Lévi-Strauss, C. (1961). A writing lesson. In *Tristes tropiques*. New York: Criterion Books.

Schwartz, J. M., & Cook, T. (2002). Archives, records, and power: The making of modern memory. *Archival Science*, 2, 1–19.

*MUZEALIZIMI I SPAÇIT?
(OSE RREZIKU I HARRESËS SË
XHELATËVE DHE VIKTIMAVE
TË TYRE)*

ARBA BAXHAKU



Në shoqëritë post-totalitare, trajtimi i vendeve të dhimbjes dhe represionit politik është një nga sfidat më delikate të kujtesës kolektive. Spaçi, ish-burgu famëkeq politik në Shqipëri, përfaqëson një nga ato hapësira që ruajnë gjurmët e dhunës shtetërore, por edhe të qëndresës njerëzore. Transformimi i një vendi të tillë nga një “vend harrimi” në një hapësirë përkujtimoreje e muzealizuar, ngre pyetje të mëdha etike dhe kulturore: si mund të ruhet autenticiteti dhe intensiteti emocional i historisë pa e banalizuar atë? Si të shmanget kthimi i dhimbjes në një produkt të konsumueshëm për turistë?

Po aq thelbësore është nevoja për të shpalosur të dyja anët e historisë: jo vetëm të dënuarit dhe vuajtjet e tyre, por edhe urdhëruesit dhe zbatuesit e dhunës, ata që ushtruan kontrollin dhe e zbatuan sistemin represiv. Në Shqipëri mungon ende një transparencë e plotë mbi strukturat, emrat dhe dokumentet që dëshmojnë rolin e përgjegjësve institucionalë e individë në kryerjen e krimeve të komunizmit.

Në këtë kontekst, paralelja me konceptin e “banalitetit të së keqes” të filozofes Hannah Arendt (1963) bëhet ndriçuese: shpesh, dhuna nuk ushtrohet nga figura monstruoze, por nga individë që ndjekin verbërisht rregulla dhe urdhra, duke pezulluar përkohësisht përgjegjësinë personale.

“Ajo që ishte më tronditëse te Eichmann,” shkruan Arendt, “ishte një normalitet alarmues... fakti se shumë njerëz nuk ishin as fanatikë, as sadistë, por ishin dhe janë ende tmerrësisht normalë”.¹ Të kuptosh këtë dimension të së kaluarës nuk do të thotë të relativizosh fajin, por ta artikulosht atë si pjesë të edukimit publik dhe të reflektimit kolektiv.

Spaçi përfaqësonte fytyrën më të ashpër të stalinizmit shqiptar. I rezervuar kryesisht për të burgosurit politikë, ai i nënshtroi të burgosurit me punë të detyruar në kushte të rrezikshme në miniera, me privimin e lirisë, me torturë dhe dhunë ekstreme psikologjike. Më shumë se 2,000 të burgosur duruan kushte aq mizore sa kampi u bë sinonim i terrorit shtetëror të asaj kohe.

Siç vërtetohet në dokumentet arkivore të Sadik Bejkos, në librin e tij me dokumente historike për Revoltën e Spaçit, të burgosurit punonin në kushte ekstreme, nga temperaturat prej -10 °C jashtë deri në më shumë se 45 °C brenda minierës.² Mosarritja e normave ditore sillte dënime të rënda në biruca, ku izolimi, ftohtësia dhe tortura ishin norma. Edhe rezistenca kulturore ndëshkohej ashpër. Kjo arriti kulmin me Revoltën e 1973-it, ku u ngrit flamuri kombëtar pa yllin komunist.

[1] Arendt, H. (1963). *Eichmann in Jerusalem: A report on the banality of evil*. Viking Press.

[2] Bejko, S. (2018, 21 maj). *Revolta e Spaçit, 1973 – në një libër dokumente arkivore*. Alb-Spirit. <https://alb-spirit.com/2018/05/21/sadik-bejko-revolta-e-spacit-1973-ne-nje-liber-dokumente-arkivore>



Revolta u shtyp me egërsi: katër udhëheqës u ekzekutuan dhe shumë të tjerë u torturuan.

Pas rënies së regjimit komunist, Spaçi, një nga burgjet më famëkeqe të diktaturës, mbeti si një plagë e hapur në peizazhin shqiptar. Vendi ku shumë prej më të guximshmëve u burgosën dhe u torturuan, u shpall monument kulture i kategorisë së dytë. Ky ishte hapi i parë drejt njohjes zyrtare të rëndësisë së tij historike, por rruga drejt kthimit të tij në një vend të denjë kujtese sapo kishte filluar.

Megjithëse që prej vitit 2007 Spaçi ishte shpallur zyrtarisht monument kulture, përpjekjet konkrete për ta kthyer këtë vend në një hapësirë muzeale mungonin ende. Vendi vazhonte të mbetej në harresë, i braktisur dhe i rrethuar nga rrënojat e kohës. Në këtë kontekst, në vitin 2014 organizata Cultural Heritage Without Borders (CHWB) ndërmori nismën “Dialogët për Spaçin”, e cila synonte të krijonte një platformë bashkëpunimi ndërmjet ish-të burgosurve politikë, komunitetit lokal dhe ekspertëve të trashëgimisë kulturore. Kjo nismë përbën një moment kthese në trajtimin e këtij vendi: për herë të parë Spaçi filloi të shihej jo vetëm si një objekt fizik i rrënuar, por si një hapësirë potenciale për dialog shoqëror, kujtesë kolektive dhe reflektim kritik mbi të kaluarën.

Në vitin 2015, rëndësia e kësaj trashëgimie mori një tjetër dimension, kur World Monuments Fund e përfshiu Spaçin në listën e 50 monumenteve më të rrezikuara në botë³. Ky akt ndërkombëtar e vuri Shqipërinë para pasqyrës: ruajtja e Spaçit nuk ishte më vetëm një çështje lokale.

Në vitin 2017, me mbështetjen e qeverisë suedeze, organizata Cultural Heritage Without Borders (CHWB) ndërmori ndërhyrje emergjente për stabilizimin dhe ruajtjen e strukturave ekzistuese të godinave në kampin e Spaçit, me qëllim ndalimin e mëtejshëm të degradimit fizik të tyre⁴. Këto veprime u konkretizuan një vit më pas përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës (2018)⁵, e cila synonte të hidhte bazat për procesin e memorializimit të kësaj hapësire. Megjithëse ndërhyrjet fillestare ishin kryesisht simbolike dhe me natyrë krejtësisht teknike, ato shenjau një pikënisje të rëndësishme drejt angazhimit institucional për ruajtjen e Spaçit si një vend i kujtesës kolektive dhe ndërgjegjësimit historik.

[3] World Monuments Fund. (2015). 2016 *World Monuments Watch includes 50 at-risk cultural heritage sites in 36 countries*. <https://www.wmf.org/press-releases/2016-world-monuments-watch-includes-50-risk-cultural-heritage-sites-36-countries>

[4] Cultural Heritage without Borders. (2017). Making a place for dialogue: Results from the Spaç Prison focus groups. https://openarchive.icomos.org/1977/1/4_ICOA_1487_Eaton_SM.pdf

[5] Cultural Heritage without Borders Albania. (2018). *Cooperation agreement with Ministry of Culture for the Spaç Prison site*. CHWB Albania. Marrë më 5 shtator 2025, nga <https://chwb.albania.org/portfolio/spac-prison-a-place-of-dialogue-and-action-addressing-communist-era-heritage>

[6] Worcester Polytechnic Institute. (2019). *Albanian Spaç Prison: Creating a Digital Reconstruction of the Spaç Historical Site*. <https://digital.wpi.edu/show/00000276r>

[7] Fondazione Santagata. (2024). Plan i ri menaxhimi për ish-burgun e Spaçit: Rezistenca dhe ngjarjet historike kyçe. Fondazione Santagata.

Një nismë tjetër erdhi në vitin 2019, kur studentë nga Worcester Polytechnic Institute ndihmuan në krijimin e një rikonstruksioni digjital të Spaçit⁶. Përmes kësaj platforme online, historia e vendit mund të eksplorohej edhe nga ata që nuk mund të shkonin fizikisht aty.

Në vitin 2024, Fondazione Santagata prezantoi një plan të ri menaxhimi për ish-burgun, duke e vendosur theksin te rezistenca dhe ngjarjet kyçe historike si Revolta e Spaçit. Kjo përpjekje synonte jo vetëm të ruante vendin, por edhe ta riaktivizonte atë si një hapësirë edukimi dhe reflektimi⁷.

Procesi i transformimit të hapësirave si Spaçi në vende muzeale, apo destinacione vizitueshmërie, përballat me sfida të shumta materiale dhe konceptuale. Në aspektin fizik, struktura e kampit nuk ishte projektuar për qëndrueshmëri afatgjatë. E ndërtuar në një zonë të thellë malore të Mirditës, në kushte të vështira klimaterike dhe me materiale të një cilësie të ulët, infrastruktura e mbetur ndodhet sot në një gjendje të avancuar degradimi. Në mungesë të një procesi të kujdesshëm konservimi, rreziku i humbjes së autenticitetit historik bëhet i pashmangshëm, duke cenuar rëndësinë dokumentare dhe përjetuese të vetë vendit.

Territori ku ndodhet kampi i Spaçit paraqet një kompleksitet të veçantë për sa i përket ruajtjes dhe ndërhijes. Pjerrësia e theksuar dhe terreni i thepisur përbëjnë rrezik për erozion dhe rrëshqitje dherash, veçanërisht nëse ekspozohen ndaj vizitorëve. Kjo mund të sjellë dëmtime të pakthyeshme në infrastrukturën origjinale, si rrugicat apo ndërtimet ndihmëse. Po ashtu, minierat nëntokësore, hapësirat më të ngarkuara simbolikisht për shkak të kushteve ekstreme në të cilat u detyruan të punonin të burgosurit, përbëjnë një sfidë të veçantë. Hyrja e publikut në këto zona do të kërkonte ndërhijje të konsiderueshme sigurie, të cilat do të rrezikonin të zhbënin përjetimin e frikës, ankthit dhe mbylljes që ato mbartin ende sot në gjendjen e tyre të paprekur.

Birucat, si hapësirat më të izoluara dhe represive të kampit, përfaqësojnë një nga komponentët më delikatë të kujtesës së dhunës. Ndërhijjet që synojnë sigurinë fizike, si zëvendësimi i dymëve origjinale, apo mbyllja e mureve të degraduara, rrezikojnë të zbehin ndjeshëm intensitetin emocional që këto struktura përcjellin. Po ashtu, përfshirja e elementeve të infrastrukturës turistike, si ndriçimi artificial, panelet informuese apo rrugët e kalimit të standardizuara, mund të ndërhijnë në mënyrë të pakthyeshme në peizazhin

historik. Këto transformime nuk prekin vetëm estetikën e vendit, por edhe vetë mënyrën se si përjetohet dhe kuptohet trauma historike, duke rrezikuar të zhbëjnë autenticitetin narrativ të Spaçit si një dëshmi e gjallë e përvojës së vuajtjes dhe qëndrësës.

Pierre Nora na paralajmëron për këtë fenomen me fjalë të qarta: “The less memory is experienced from the inside the more it exists only through its exterior scaffolding and outward signs”.⁸ Kujtesa rrezikon të shkëputet nga përvoja kolektive dhe të kthehet në një konstrukt jashtë strukturës së saj historike - një monument pa emocion, i cili mund të lehtësohet e konsumohet pa kuptuar të thellën morale që ajo ushtron. Në këtë kuadër, Spaçi rrezikon të shndërrohet në një “tregim të konsumueshëm”, pa thellësinë dhe udhërrëfimin që dhimbja kolektive dhe përvoja historike kërkojnë, duke humbur kështu rëndësinë e tij morale dhe historike. Përpyekjet për të kthyer Spaçin në një hapësirë përkujtimoreje janë intensifikuar vitet e fundit, mes debatesh mbi ruajtjen e autenticitetit dhe shmangien e banalizimit turistik. Ndërkohë që vendi vazhdon të degradojë fizikisht, janë ndërmarrë disa ndërhyrje minimale për ruajtjen e tij. Megjithatë, propozimet për ta bërë më të aksesueshëm për vizitorët kanë ngjallur shqetësime, pasi ndërhyrje si instalimet moderne, apo hapja e birucave e galerive, rrezikojnë të zhbëjnë karakterin përjetues dhe të paprekur të vendit.

Një aspekt thelbësor, që shpesh mbetet i nënvlerësuar në diskutimet për muzealizimin e Spaçit, është zhdukja fizike e disa godinave përgjatë këtyre tridhjetë viteve. Disa struktura janë rrënuar nga koha, të tjera janë shembur qëllimisht, duke i shërbyer një forme të heshtur fshirjeje të gjurmëve të krimeve të së kaluarës. Këto ndërhyrje përbëjnë jo vetëm humbje materiale, por edhe ndërhyrje në vetë kujtesën kolektive. Muzealizimi i një vendi ku boshllëqet janë krijuar qëllimisht kërkon një kujdes etik të veçantë: jo për të mbushur zbrazëtirat me rikonstruksione spekulative, por për t'i bërë ato të dukshme, për të treguar që mungesa është vetë një dëshmi. Në këtë kuptim, gasja përkujtimore duhet të përfshijë jo vetëm atë që ka mbetur, por edhe atë që është zhdukur: të dokumentojë jo vetëm atë që shihet, por edhe atë që mungon. Siç sugjerojnë shumë studiues të kujtesës, mungesa vetë mund të flasë, nëse përballet me ndershmëri dhe përgjegjësi; ajo mund të bëhet një element aktiv i narrativës për të treguar se historia është deformuar, censuruar ose fshirë. Në Spaç, ato boshllëqe janë plagë që nuk duhen mbuluar, por emërtuar.

[9] Agamben, G. (1999). *Quel che resta di Auschwitz: L'archivio e il testimone*. Torino: Bollati Boringhieri.

Në procesin e muzealizimit të vendeve të dhimbjes si Spaçi, një aspekt që shpesh mbetet në hije është pikërisht historia e atyre që urdhëruan, zbatuan dhe racionalizuan dhunën – pra, jo vetëm e viktimave, por edhe e torturuesve të tyre. Shfaqja ekskluzive e një narrative të njëanshme, ku vetëm vuajtja e të dënuarve artikullohet, rrezikon të krijojë një kujtesë të fragmentarizuar dhe, në fund, të reduktuar. Filozofi Giorgio Agamben⁹, duke reflektuar mbi dëshminë në kampet naziste, thekson rëndësinë e “mungesës së dëshmisë” dhe të zërave që nuk mund të artikulojnë më – si të viktimave që “kanë prekur fundin”, por edhe të atyre që e ushtruan dhunën dhe vazhdojnë të mbeten enigmatikë për nga motivet dhe njerëzillëku i tyre i deformuar. Në këtë kuptim, përballja me Spaçin si hapësirë kujtese kërkon të shkojë përtej përjetimit empatik dhe solemnitetit memorial: ajo duhet të synojë të kuptojë strukturën e dhunës, logjikën e zbatuesve të saj dhe mekanizmat që e bënë të mundur, në mënyrë që të ndërtohet një “tokë e re etike”, e cila nuk ndan thjesht të mirët nga të këqijtë, por e vendos në qendër njeriun në të gjitha kompleksitetet dhe dështimet e tij morale.

Ndër zërat më kritikë në këtë debat janë vetë ish-të burgosurit. Ata kanë shprehur frikën se çdo formë e komercializimit do të përbënte një tradhti ndaj kujtesës së vuajtjeve të tyre. Për ta, Spaçi nuk duhet të bëhet një vend ku turistët kalojnë në mënyrë sipërfaqësore për të bërë foto apo për të ndjekur ture të strukturuar, por një hapësirë reflektimi, heshtjeje dhe nderimi. Fatos Lubonja dhe personalitetet e tjera kanë theksuar se Spaçi duhet të ruajë ashpërsinë e tij, duke mbetur një dëshmi tronditëse e së kaluarës represive.

Në këtë kontekst, dilemat etike janë thelbësore: A duhet të lehtësohet qasja për të siguruar që historia të njihet nga më shumë njerëz, apo duhet të mbrohet vendi nga ndërhyrjet që mund ta dëmtojnë natyrën e tij dëshmuese? Ky debat është reflektuar edhe në praktikant ndërkombëtare.

Shembuj të rëndësishëm muzealizimi të ngjarjeve traumatike të historisë europiane që ofrojnë modele të vlefshme për reflektim janë: Muzeu Hebraik në Berlin, Memoriali dhe Muzeu i Auschwitz-Birkenau, Muzeu i Rezistencës në Romë, Muzeu i Stasi-t në Berlin, Muzeu i Terrorit në Budapest, si dhe Muzeu i Shërbimeve Sekrete “Shtëpia me Gjethe” në Tiranë. Këto institucione janë ndërtuar jo vetëm si hapësira edukimi dhe përkujtimi, por edhe si forma ballafaqimi kolektiv me të kaluarën represive të shteteve respektive. Muzeu Hebraik në Berlin vlerësohet për mënyrën se si i vendos vizitorët përballë

[10] Reynolds, D. (2016). *Consumers or witnesses? Holocaust tourists and the problem of authenticity*. *Cultural Studies*, 30(2–3), 345–369. <https://doi.org/10.1080/00220166.2016.1191111>.

[11] Gruber, R. E. (2015, 10 shtator). *Balancing tourism and memory at Auschwitz*. *Jewish Telegraphic Agency*. Marrë nga <https://www.jta.org/2015/09/10/ny/balancing-tourism-and-memory-at-auschwitz>

[12] Brody, R. (2012, 13 korrik). *The inadequacy of Berlin's "Memorial to the Murdered Jews of Europe"*. *The New Yorker*. <https://www.newyorker.com/culture/richard-brody/the-inadequacy-of-berlins-memorial-to-the-murdered-jews-of-europe>

brutalitetit të regjimit nazist, duke luajtur një rol qendror në procesin gjerman të përballjes me të kaluarën (Vergangenheitsbewältigung). Po ashtu, Muzeu i Auschwitz-Birkenau ruan me rigorozitet autenticitetin e vendit të gjenocidit dhe shërben si një përkujtesë e gjallë për brezat e ardhshëm, ndonëse sfida e tij më e madhe mbetet menaxhimi i ndikimit të turizmit masiv mbi përvojën e përkujtimit¹⁰.

Të gjitha këto përvoja dëshmojnë për potencialin e muzealizimit si një mjet i fuqishëm për ruajtjen e kujtesës, edukimin ndërbreznor dhe promovimin e një narrative që synon të parandalojë përsëritjen e dhunës shtetërore. Megjithatë, ato tregojnë edhe nevojën për ndjeshmëri të thellë ndaj traumës së përfaqësuar dhe rrezikun e sensacionalizimit ose trivializimit të vuajtjes¹¹. Për Spaçin, këto modele ndërkombëtare ofrojnë jo thjesht frymëzim, por edhe paralajmërim: muzealizimi duhet të ndërtohet mbi baza etike, përmes një procesi që ruan autenticitetin e vendit, përfshin zërat e të mbijetuarve dhe shmang transformimin e dhimbjes kolektive në objekt spektakli apo konsum kulturor. Një ndër shembujt më domethënës të memorialeve bashkëkohore që trajtojnë ngjarje traumatike është Memoriali i Holokaustit në Berlin, vepër e arkitektit Peter Eisenman. I konceptuar si një fushë me mbi 2,700 paralelopipedë betoni të përmasave dhe lartësive të ndryshme, memoriali është një hapësirë që nuk ofron një narrativë të qartë apo të shkruar, por i fton vizitorët të ecin në mënyrë introspektive mes strukturave, duke përjetuar ndjesinë e humbjes, hutimit dhe izolimit. Minimalizmi i tij formal synon të përçojë një formë abstrakte të kujtesës kolektive, që nuk imponon domethënie të vetme, por krijon hapësirë për interpretim individual.

Ndërkohë që shumë e kanë vlerësuar si një akt të guximshëm përballjeje me të kaluarën naziste, memoriali ka qenë gjithashtu subjekt i debatit të vazhdueshëm. Kritikët kanë ngritur shqetësime mbi natyrën e tij jopersonale dhe mungesën e informacionit historik në vetë strukturën fizike, duke theksuar se pa kontekst edukativ plotësues, vizitorët mund të mos kuptojnë thellësinë dhe specifikën e krimeve të Holokaustit¹². Të tjerë e kanë akuzuar për rrezikun e shndërrimit në një atraksion turistik, duke humbur solemnitetin dhe ngarkesën emocionale që kërkohet nga vende të tilla.



Burgu i Idealit,
Prishtinë

[13]
LearnedWriters. (n.d.).
Peter Eisenman's
"Memorial to the
Murdered Jews of
Europe". Marrë nga
<https://learnedwriters.com/peter-eisenmans-memorial-to-the-murdered-jews-of-europe>

Nga ana tjetër, disa studiues dhe kuratorë të kujtesës argumentojnë se pikërisht kjo paqartësi është vlera e tij themelore: përmes mungesës së figurës, emrit apo kronologjisë, ai nxit një përjetim emocional dhe filozofik të humbjes, që rezonon më gjerësisht me konceptin e kujtesës postmoderne¹³. Zgjidhja për të shoqëruar memorialin me një qendër informacioni nëntokësore shërben si një shembull i balancës mes abstraksionit dhe edukimit historik – një praktikë që mund të frymëzojë edhe trajtimin e rasteve si Spaçi.

Në këtë kuptim, Memoriali i Eisenman nuk është vetëm një monument, por një deklaratë mbi mënyrën se si kujtesa mund të ndërtohet në hapësirë – një formë që sfidon vizitorin jo për të marrë përgjigje, por për të bërë pyetje. Për vendet si Spaçi, që mbartin një dhimbje të ngjashme historike, ky shembull nxit reflektimin se si të ndërtohen forma përkujtimeve që ruajnë intensitetin emocional pa shkarë në didaktikë apo konsum kulturor.

Për Spaçin, zgjidhja nuk është e lehtë. Është e qartë se vendi ka nevojë për ndërhyrje urgjente konservuese për të parandaluar shkatërrimin total fizik, por çdo hap drejt muzeifikimit duhet të bëhet me kujdes të jashtëzakonshëm për të mos e shndërruar këtë hapësirë të dhimbjes në një produkt të konsumueshëm apo spektakël turistik. Shembujt ndërkombëtarë të lartpërmendur dëshmojnë se trajtimi i kujtesës kërkon një ekuilibër të ndjeshëm midis përjetimit emocional dhe edukimit historik. Rasti i ish-burgut të Prishtinës ofron një shembull të rëndësishëm të një qasjeje etike dhe gjithëpërfshirëse ndaj vendeve të kujtesës. Hapja e ekspozitës "Burgu i Idealit" në vitin 2020 shënoi një hap simbolik drejt muzealizimit të hapësirës, duke përfshirë në proces ish-të burgosur, institucione dhe studiues¹⁴. Përdorimi i materialeve autentike, përfshirë mbishkrimet, krijimtarinë artistike dhe dëshmitë personale, dëshmon për një qasje minimale dhe të kujdesshme, që ruan intensitetin emocional të vendit pa e kthyer atë në spektakël. Megjithatë projekti vazhdon të jetë në zhvillim, ai pasqyron qartë tensionet midis ruajtjes së autenticitetit dhe nevojës për akses publik, duke u bërë një pikë referimi e vlefshme për diskutimet mbi të ardhmen e Spaçit.

[14] KultPlus.
(2022, 12 korrik).
Me ekspozitën e
përkohshme "Burgu i
Idealit", u hap Muzeu
i Burgut të Prishtinës.
Marrë nga <https://www.kultplus.com/arti-pamor/me-ekspoziten-e-perkohshme-burgu-i-idealit-u-hap-muzeu-i-burgut-te-prishtines>

Në këtë kontekst, Spaçi nuk duhet të trajtohet thjesht si një destinacion vizitash, por si një hapësirë etiko-historike ku ndërhyrjet arkitekturore, muzeale dhe interpretative duhet të udhëhiqen nga parimet e kujtesës kritike, autenticitetit dhe respektit të thellë ndaj përvojave të viktimave. Dialogu i vazhdueshëm mes institucioneve, shoqërisë civile, komunitetit të ish-të burgosurve dhe brezave të rinj është kyç për ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, që jo vetëm ruan Spaçin si dëshmi historike, por e forcon atë si hapësirë reflektimi të domosdoshme për të ardhmen.

Në fund, rasti i Spaçit përmbledh tensionet thelbësore që shoqërojnë muzealizimin e vendeve të dhimbjes: ndërmjet ruajtjes së të vërtetës historike dhe presionit për ta bërë vendin të vizitueshëm. Nëse përvoja e vizitorit vërehet mbi integritetin moral të dëshmisë, ekziston rreziku i zbutjes, i zvetënimit të historisë. Prandaj, çdo ndërhyrje në Spaç duhet të ndërtohet mbi një etikë kujtese që respekton dëshmitë e të mbijetuarve, ruan gjurmët e dhunës shtetërore dhe refuzon spektakularizimin e vuajtjes. Vetëm përmes një procesi bashkëpunues midis institucioneve, ish-të dënuarve politikë, studiuesve dhe shoqërisë civile, Spaçi mund të shndërrohet në një hapësirë reflektimi të thellë, ku kujtesa kolektive nuk imponon, por nxit pyetje, ndërgjegjësim dhe ballafaqim të ndershëm me të kaluarën.

REFERENCA

Agamben, G. (2002). *Remnants of Auschwitz: The witness and the archive* (D. Heller-Roazen, Përkth.). New York: Zone Books. (Vepra origjinale botuar në 1999).

Arendt, H. (1963). *Eichmann in Jerusalem: A report on the banality of evil*. Viking Press.

Bejko, S. (n.d.). *Revolta e Spaçit, 21–23 maj 1973: Dokumente arkivore*.

Eisenman, P. (2004). *Notations of affect: An architecture of memory* (Pathos, Affekt, Gefühl).

Williams, P. (2007). *Memorial museums: The global rush to commemorate atrocities*. Berg.

World Monuments Fund. (2015). 2016 World Monuments Watch includes 50 at-risk cultural heritage sites in 36 countries. <https://www.wmf.org/press-releases/2016-world-monuments-watch-includes-50-risk-cultural-heritage-sites-36-countries>


Cultural Heritage without Borders. (2017). *Making a place for dialogue: Results from the Spaç Prison focus groups*. https://openarchive.icomos.org/1977/1/4_ICOA_1487_Eaton_SM.pdf

Worcester Polytechnic Institute. (2019). *Albanian Spaç Prison: Creating a digital reconstruction of the Spaç historical site*. <https://digital.wpi.edu/show/00000276r>

Young, J. E. (2000). *At memory's edge: After-images of the Holocaust in contemporary art and architecture*. Yale University Press.

*DIELLI
KA NGJYRËN
E PIRITIT*

ANTONELA PEPKOLAJ



Teksti i mëposhtëm është histori e fiksionalizuar, bazuar në materiale dhe dëshmi që ekzistojnë mbi kampin e riedukimit 303, apo burgu i Spaçit. Metoda e trillimit është zgjedhur për të risjellë atmosferën e burgut si dhe për të dhënë dimensione të ndryshme të eksperiencës njerëzore në burg, pa u përqendruar te një narrativë e vetme.

Mendoj, kam qenë i arsyeshëm në refuzimin e atij instinkti që justifikon çfarëdolloj prirjeje të jetës me besëtytni apo yshtje. Nuk besoj se shpirti im bart ndonjë borxh kozmik, e as se veprimet e mia kanë lënduar ndokënd. Në tërësi jam i sigurt në bindjet e mia. E di se unë, bashkë me të tjerët, jemi një sakrificë që po kryhet në emër të një kotësie. E di se jeta nuk është zgjedhje mes martirizimit dhe mbijetesës. Nuk jam i çmendur. Nuk jam. Shoh qafën e mbufatur të djerrinës përballë, mal i shkretë që m'i merr sytë, me ato shkorretet që sikur orvaten t'i zënë frymën. Herë pas here, i përdëllyer në vetminë time nga bukuria mizore e këtij peizazhi, qaj; nuk gjej asnjë lloj ngushëllimi tjetërkund. Pastaj kthjellem për tmerrin e këtyre bokave, kam frikë se dheu do t'na avullojë të gjithëve, në rastin më të mirë, për ne do dëshmojnë vetëm shkresurinat gjysmake të këtyre analfabetëve.

Të drejtën time për t'u ndier i shpaguej e ushtroj vetëm në fantazitë e mia: shikimi im përhumbet në skena gati-gati apokaliptike. Çdo ditë, gjatë dyorëshit të leximit fantazoj se si një dorë, nga lart, ndërhyr me një sens revanshi hyjnor, gjatë të cilit xhelatët e murrme grumbullohen të gjithë në galerinë, e cila shembet dhe i bën përsesh. Apo se si mitralozat marrin jetë dhe çohen për t'i masakruar, se si digjen dhe bëhen hi nën prozhektorët e karakollëve, dhe mandej të gjithë ne rendim të lirë përtej rrethimeve, duke gulfuar hareshëm si të kishim prekur parajsën. Ditë të tjera brezi i malit përfund luginës shkundet për ta spastruar veten nga ndërtesat e kampit, gjithçka shembet për poshtë, ne na zbulohet një rrugë nga e cila ia mbathim. A është vallë xhelozia apo mjerimi stofi i përbashkët i këtyre njerëzve, të cilët u pushtuan kaq shpejt nga shpirti i persekutimit? Si mund të jetë njeriu dele, pastaj xhelat, dele dhe xhelat, nën aksiomën “ne ia falëm jetën partisë, dhe prandaj ajo do t'na shpërblejë”. A është e mundur që nevoja për t'u diktuar dhe nevoja për të legjitimuar në mënyrë perverse ndjenjën e epërsisë me lejen e një diktuesi, të jenë thelbi i psikologjisë së masës? Metoda revolucionare dhe lufta e klasave për mua janë reduktuar në manifestimet e një trupi social të përbërë prej hienash, që nuk ngurren të zdërhallet në banalitetin e krimin si shenjë privilegji, dhe që nga ana tjetër, në bjerren e po këtij trupi si armik, nuk ngurren të bëjë qyqarin, pa e humbur kurrë esencën prej servili. Në formë krejt tinëzare, disfatën e tyre – ekonomike? – e maskojnë si një luftë përtej interesit të klasës: luftimi i armikut të klasës.


Gjatë viteve '70, që shënojnë botimin e projektkushtetutës


dhe kodit penal për afirmimin juridik të marksizëm-leninizmit, (komunizmit, totalitarizmit), lufta ndaj liberalizmit la pas shumë viktime. Prej kapriços dhe paranojës, shumë akte të jetës normale rrasen si vepra të dënueshme nën nenin 55 dhe 73; shpesh dënimet kryhen pa gjyq; hetuesitë janë strofa torturash. Dënime jepen edhe për familjaritet, spontanitet, butësi ndaj armikut, arrogancë, vetëkënaqje, sjellje humanistike etj.. Unë isha “deviator i djathtë” me “prirje liberalo-anarkiste” dhe “element armik antiparti”, pse një shkrim imi mbi një vepër letrare në organin e Lidhjes së Shkrimtarëve përmbante aludime pohuese mbi shtresën e privilegjuar.

Mëria ime e brendshme për palegjitimitetin e akuzës ndaj meje u bjerr shpejt; shpresa se ndonjë irrelevancë apo pasaktësi mund të shërbenin si mrekullia që do e pastronte imazhin tim dhe të më kthenin lirinë, u zhbë në mënyrë të prerë. Madje, e vërteta ime dhe e të tjerëve këtu, tallej hapur me çfarëdolloj impulsi ligjshmërie dhe dialogu që mund të lindte. Të qenit diversant ideologjik a politik ishte, deri diku, e fisme: në mendjen time ky ishte hapi i parë i një plani të madh që do të zbulonte një hero (mua), përkundrejt këtyre frikanëve që nuk dinin e kuptonin asgjë. Me këtë ndjenjë revanshi lartësues isha në kaush, prej nga të gjithë të burgosurit shpërndaheshin nëpër burgjet përkatëse, i sigurt se gjithçka do të binte në vend, pavarësisht torturave, për të cilat diçka kishim dëgjuar. Por në kaush m'u shpërfaq vetëm hapi i parë i një serie të gjatë ngjarjesh denigruese, makabre dhe, patjetër, të tmerrshme.

Përballja me një shumësi njerëzish të dekurajuar, të sëmurë, konformë, të dërrmuar deri në sakati dhe trullosje mendore prej labirintit të ridënimit; kjo panoramë e një jete të humbur më sinjalizonte braktisjen e të gjitha besimeve dhe idealeve të mia thellësisht njerëzore. Misionit tim të madh, atij të jetës sime, i kishte ardhur fundi.

Mbërrij rreth 7 km nga Repsi, në perëndimin e një përroi që ngjante si zorrë e hapur lateriti, ku dy tërësi ngrehinash ndodheshin përbri njëra-tjetrës në largësi 150 metra. Kompleksi, përveçse i izoluar nga vargmali që shtriqej përqark sikur do të të binte mbi krye, mbështillej edhe nga tri rrethime me tela me gjemba të kapur në shtylla betoni, nga roja të jashtme, të brendshme dhe kulla vrojtimi, gjithmonë në gatishmëri për të hapur zjarr. Fill pas zonës së administratës, ndodhej komanda, mandej kampi me kapanonet e fjetjes, mensën dhe infermierinë, ku kryenin dënimin me punë të detyruar në minierë për nxjerrjen e bakrit dhe piritit rreth 1000 veta: të burgosur politikë dhe ordinerë.





Dy herë në muaj kishim të drejtë vizite nga familjarët, shpesh për të na ndëshkuar shpiknin vonesa burokratike letrash për t'i shtyrë vizitat apo për t'i anuluar, pasi kishin mbërritur tashmë dhe bërë rrugë të gjatë për në Spaç. Duke qenë se rruga nga Repsi në Spaç ishte e vështirë dhe e gjatë, me temperatura ekstreme gjatë verës dhe gjatë dimrit, kishte vizitorë që merrnin kamionin e druve për vajtje-ardhje. Ka të burgosur që as e dinë se u ka ardhur ndokush për vizitë, pavarësisht se familjarë mund të kenë ardhur disa herë. Të burgosur të tjerë dëshmojnë se rojat gënjejnë qëllimisht sidomos vizitorët gra për të ndenjtur në kamp, duke e ditur që vijnë nga larg dhe e kanë të pamundur të kthehen brenda dite. U ofrojnë të qëndrojnë në një dhomëz të vogël vizitorësh pranë hyrjes së kampit, ku, siç thonë, flenë me to kundër dëshirës së tyre.

E kuptova shpejt, sapo mbërrita në burg, teksa mora uniformën time dhe shtrojën prej kashte, përballë zgjimit në orën 05:30, orëve të leximit të detyruar, dy vakteve me perime të kalbura dhe ushqim të krimbur, rreshtimeve të përditshme, apeleve të pafundme dhe vëzhgimit të pandërprerë: aparati ideologjik, lobimi deri në terror i “vijës”, edukimi politik dhe ndëshkimi nuk ishin gjë tjetër veçse diplomacia e skllavërimit. Diplomacia dhe angaria ishin vetë zemra e burokracisë së partisë sonë - diplomacia si ekzekutim i një platforme politike, angaria si instrumentalizim i nevojave tona njerëzore.

Esenca dhe kuptimi im janë galeria; jeta ime është norma; qëllimi im është turni, gjithçka tjetër është një tepri e cila menaxhohet me dhunë dhe përbuzje në sajë të histerisë së skllavërimit.

Në mëngjes herët, dielli në lindje kuqëlon aq fort mu në skaj të krejt sipërfaqes si hinkë që na strehon, saqë shpesh e gjej veten, pa vetëdije, duke imagjinuar ndonjë ferr përpirës në anën tjetër të maleve, gati të na shkrumbojë. Çdo mëngjes fantazia përtërihet kështu, për t'u shkurajuar sapo ngjisim 2000 metrat për në galeri, kur dielli gati arrin pikun dhe më zbulon një peizazh krejt indiferent e të shkretë, një zheg platitës që e bën dheun të duket sikur po qelbet. Një fytyrë e thatë zeshkane me sytë tepër të hapur, emrin e të cilit s'e mësova deri vonë, rrugës shpesh na rrëfente se si ishte i mallkuar, pse është larë me ujë xhenazeje kur ishte në një varrim; detajet nuk i rrëfeu asnjëherë, thotë se i ngritën kurth. E kam pritur me kohë hakun e kësaj ndodhie – thotë – Spaçi, pa dyshim. Për t'i shpëtuar frontit të punës vrau veten duke injektuar naftë.

Thjesht nuk ishte më mes nesh, sakraliteti i kujtimit të tij na përçohej përmes ndjenjës së përbashkët të lemerisë, sepse e drejta e varrimit nuk ekziston për armiqtë e popullit; me gjasë ishte varrosur diku përreth, thonë se te pjerrina përballë nesh. Kishte nga ata që me humor të zi shpreheshin se të paktën Allahu i mundësoi njëfarë riti varrimi në të gjallë, meqë këtu i humbi nami dhe nishani; i vetmi solemnitë i varrimit ishte veshja me rroba të reja burgu. Dy prej nesh do të vrisnin veten ose ekzekutohesh çdo muaj kësisoj, shpesh vetëgjymtoheshin ose hidheshin në tela, sepse e dinin që do vriteshin.

Dëshpërimi ishte tipari ynë i përbashkët: mjaft prej nesh e shihnin këtë të keqe si rrugëtimin drejt veteje të lartë, gati-gati gjeniale, drejt një vepre të përsosur e të pamohueshme; të tjerë, e shihnin si pjesë e shugurimit tokësor për në parajsë: gjithmonë një e keqe e epërme, thuajse fisnike, kuptim të cilin e merrte nga objekti i saj. Për mua ishte, pa diskutim, simptoma e një rodi injorant, dhe ne viktimat mjerane të një tarafi gjakpirësish, pa ndonjë mision, me kohën dhe trupin në gatishmëri. I vetmi qëllim disi naltues që mund të fshehë mbushja e një vagoni 1-tonësh në ditë ishte gënjeshtria që i thoshim vetes.

Megjithatë, biruca, tortura dhe vdekja nuk ishin më të tmerrshme sesa sfilitja e përditshme dhe uria sistematike, prandaj i kam dhënë vetes lirinë të imagjinoj arratinë time. I kam shquar me kohë disa pika në rrethimet, aty ku teli ngulet në beton, te të cilat, me zor a me hatër, mund të kisha depërtuar për t'ia mbathur me ndihmën e një çekiçi të vogël metalik, të vjedhur nga miniera. Duke qenë se lëvizja në kamp monitorohej imtësisht, ishte thuajse e pamundur arratisja nga aty: për banjën merrej leje dhe shkohej me roje; dushi bëhej në mënyrë kolektive brenda 10 minutave; qelia e fjetjes mbyllej me çelës, biruca po ashtu. Gjatë orëve të natës mund të arratisesha nga kampi, por si mund të dilja nga qelia e gjumit? Njëjtë edhe po të gjeja mënyrën që të kaloja një natë në infermieri. T'u kërkoja bashkëpunim të burgosurve apo ndonjë prej rojave ishte tejet e rrezikshme prej spiunëve. Pasojat e të qenit bashkëpunëtor ishin shumë të mëdha, as fshatarët përreth nuk guxonin të strehonin të arratisur, por i dorëzonin: duhej të planifikoja gjithçka vetëm. E vetmja mënyrë ishte arratia nga galeria, ku ideja e mbajtjes nën kontroll të të burgosurve ishte dytësore në raport me normën; për më tepër që isha larg nga komanda, mund të ikja pak më larg gjatë kohës së mobilizimit të tyre për në galeri. Do i kisha hyrë kollaj kësaj pune, pa hezitim, pa frikë. Por herë pas here e ndieja nevojën e

një shtyqe, mjerisht, një shtyqe emocionale, të cilën kurrresi nuk mund ta gjeja në këtë vend që personin tim e kishte çuar veçse në mpirje dhe degradim.

Një vizitë nga Maria, ime shoqe, i vetmi njeri që kisha pas shpirti, e cila nuk do të vononte, sigurisht, e imagjinoja si çastin e një nostalgjie dhe përdëllimi kthjellues. Në të gjitha përvojat monotone të ndjesive të mia, imazhi i Marisë më mundësonte një kthim tek impulset të cilat ma ngjallnin dëshirën për jetën. Prania e saj në realitetin tim do të ishte oguri i fundmë fatlum, siç është shfaqja e gjakut në një makth; ideja se pesha e shortit tim mbahet sadopak edhe nga tjetërkush, i jep kuptim lirisë. Nëse arratisesha unë, duhej të arratisesh edhe Maria, braktisja e saj prej meje nënkuptonte pasoja tepër të mëdha për të, ndër të cilat, kryesorja, internimi.

Në mes të kësaj trazire mendore që luhatej mes frikës dhe pritjes, ankthi i ngjarjeve pasuese ka përfshirë krejt genien time. I sigurt që diçka do ndodhë, dhe me mendjen e ndarë se diçka duhet të ndodhë, isha vazhdimisht në një gjendje vigjilence dhe paranoje. Dheu i errët i orës 5 së mëngjesit, betoni i zhgërryer, ndryshku, vagonët që duken të sapombirë nga fundi i tokës, me një aciditet e të krimbur, në masën që më përçojnë një gjendje vreri drejt e në fyt, e shtojnë padurimin tim në masën e neverisë. Për net me radhë e kisha të pamundur të flija, në gjendje zhgjëndrre shihja hijet e të burgosurve të vdekur që vinin për të folur me miqtë e tyre, hije të cilat, për t'u shpëtuar plumbave nxitonin kodrinës përtpjetë si një luzmë gjëmuese; kur zgjohesha duke u dridhur, pamja e 57 vetave në dhomë të përçudnuar pranë njëri-tjetrit, nuk ishte ngushëlluese. Arsyeja e vërtetë e ankthit tim qëndronte te 18 rojat e jashtme dhe 7 të brendshmet të frontit të punës; duke lëvizur natën dhe në kohën e ndërrimit të turneve, kisha mundësi që të realizoja një arrati të suksesshme, rreziku reduktohej në vetëm përgjegjësit e ndërrimit.

Kështu ditë pas dite, derisa më lajmëruan për vizitën e Marisë. Dihej që nuk mund të zgjaste më shumë se çerek ore, dhe me rojën të pranishëm gjatë gjithë kësaj kohe, nuk e di se si mund t'i thosha për planin tim. Më zhvendosin te dhoma e takimit, ankthi në kraharor kishte marrë trajtën e një organi masiv mbytës, ndjesia e dheut që ngjishet nën këmbë jehon drejt e në tëmthat e mi, si shija e athët e një imazhi turbullues. Megjithëse shume e bardhë dhe shumë e dobët, silueta e saj i ruante proporcionet ndjellëse, për të cilat më kishte marrë malli. Më hodhi një shikim të dhembshur; ndoshta edhe unë kam rënë në peshë?

Nuk jam Vrioni siç e mban mend, jam një zhublan i shpërlarë në gri të zbërdhulët. Gjithsesi, nuk kisha kohë për keqardhje.

– Mari!

– Vrion! Kam ardhë disa herë edhe më përpara, por në kohë të gabuar, mezi doli leja nga lart.

Maskarenjtë.

Na lejohet të prekim vetëm majat e gishtërinjve përmes një rrjete metalike; të dy kërrusur drejt njëri-tjetrit, nuk kemi liri të shprehemi, sidomos me tone nënkuptuese, pale kritikë dhe ankesat e hapura mund të përfundonin në dhunë për mua.

– Të kam parë në ëndërr, sonte – i them. – Ishim Masha dhe Vladimiri te Stuhia e borës, veçse në ëndërr, ne arrijmë të martohemi natën e takimit të tyre, te kreshta mbi luginë.

– Kuptoj, po, – tha me nxitim dhe ndërruam temë. Koha mbaroi shpejt, më nxorën nga dhoma e vizitorëve. U përshëndetëm dhe i thashë se e dua shumë.

Sonte gjatë turnit të tretë duhej të gjeja me ses bën një mënyrë për t'u arratisur nga fronti i punës, ku jashtë me siguri do t'më priste Maria, e cila po shpresojta se do të synonte të ngjiste majën e malit, rreth 600 metra nga dalja e komandës për në Reps, do të kthente për lart në një monopat të tatëpjetë rreth 800 metra - e vetmja rrugë e shqeshme - që do ta çonte në majën e malit që sheh për nga Shëmria; unë nga ana tjetër, do synoj njësoj për majën e malit, dhe me të arritur do marr mandej për nga jugu, derisa të ndesh në Marinë, e cila s'ka dyshim se duhej të ishte në atë linjë rruge edhe nëse ngjitet më shpejt. Brigadierëve u nxjerr justifikime pune për të lëvizur, thjesht duhet të pres çastin e ndërrimit të turneve.

Nën mëngë, në llërë, mbaja një çekiç të vogël, në gatishmëri të lajmërimit të nënoficerit për ndërrim, i cili nuk vonoi. Menjëherë u nisa drejt rrethimit të parë, pak i kërrusur, me çekiçin gati sipas nevojës. Sapo kaloj tabelën e zonës së ndaluar, bëj të hidhem në fundin e telave, kur dëgjohet nga kulla e vrojtimit, "Ndal se do të qëlloj!". Shpërthen një alarm si britma e territ në pickatë. Çohem dhe kthehem me fytyrë nga kulla. Afrohen ushtarë dhe nënoficeri. Ndiej valën e gjakut dhe adrenalinës që ma ngroh kryet nga grushtet dhe shqelmat: një tendosje e përgjithshme sikur po më bie pika. Më pyesin për emrin dhe një zë vë në pah me cinizëm se, mikesha e sotme, imja, po mendohej t'ia mbathte në tjetër anë nga shtëpia e vizitorëve. Isha në gjunjë dhe në krizë ulërimash.

Si ia bënë që Maria të qëndronte në shtëpinë e vizitorëve? Kanë përdhunuar Marinë? E kanë mbajtur aty duke i thënë se mund të largohet me kamion të nesërmen? E kanë kapur teksa lëvizte dyshimtë nëpër mal për t'u bashkarratisur? Ndoshta s'ka kuptuar asgjë nga çfarë po mundohesha t'i sinjalizoja. Është e mundur ta kem gënjyer veten deri në delir? Nuk shihja më asnjë rrugëdalje për vete, as Marinë. Unë do përfundoja në mos i ekzekutuar, të paktën në birucë për kushedi sa kohë dhe Maria e internuar. Shqyej sytë sikur po marr frymë me to. Shoh dheun poshtë gjunjëve të mi dhe veç për një çast më ndërmendet ndjesia e shuqarjes së piritit në thepinat e tokës, me atë nuancën e verdhë si gjëndër e kalbur. Pastaj shoh lart. Terrina e dendur s'jep shenja se do çelë agu.

REFERENCA

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1973). *Dosja Nr. 10: Relacion dërguar Drejtorisë së Policisë dhe Degës së Punëve të Brendshme Mirditë për kapjen e të dënuarit Ylli Malo Ahmetaj i cili tentoi të arratisesh nga kampi.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1977). *Dosja Nr. 29: Repart i Komandës së repartit për arratisjen e dy të dënuarve për krimin kundër shtetit si dhe plani i masave lidhur me këtë ngjarje.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1977). *Dosja Nr. 30: Relacione shkoqitëse për ngjarjet me të dënuarit për 6-mujorin e parë e të dytë të vitit 1977 dërguar Drejtorisë së Policisë.*

Reparti i riedukimit 303 Spaç. (1979). *Dosja Nr. 84: Propozim dërguar Drejtorisë së Kuvendit dhe degës së organizimit për stimulimin e disa ushtarëve me rastin e zbulimit dhe asgjësimit të një të dënuari i cili tentoi të arratisesh nga kampi.*

Lubonja, F. (2021). *Jetë burgu*. Skanderbeg Books.


RTV Klan. (2025, 11 qershor). Opinion – *Dëshmi tronditëse nga burgu i Spaçit* [Video]. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=iMYXFeTmje0>

RTV Klan. (2025, qershor). *Pjesë nga dëshmia e Agron Hoxhës* [Video]. YouTube. https://www.youtube.com/watch?v=_Cgr5NhgDRc

RTV Klan. (2025, qershor). *Dëshmia e Fatos Lubonjës, të dënuar politik në Spaç* [Video]. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=USI-JPsVsWA>

RTV Klan. (2025, qershor). *Dëshmia e Hysen Haxhijaj, të dënuar politik* [Video]. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=bXbyO8q0Ll4>





CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Puto, Artan

Terrene / Artan Puto, Nebi Bardhoshi, Anna Shkreli, Alen Bejko, Ledi Shamku-Shkreli, Sokol Çunga, Arba Baxhaku, Antonela Pepkolaj;

përgat. për bot. Anna Shkreli

2025, 136 f. ; 17x22 cm

ISBN 9789928368379

I. Bardhoshi, Nebi II. Shkreli, Anna III. Bejko, Alen

IV. Shkreli (Shamku), Ledi V. Çunga, Sokol

VI. Baxhaku, Arba VII. Pepkolaj, Antonela

1.Sundimi komunist, 1945-1991 2.Kampe të përqëndrimit,

3.Historia 4. Studime 5. Spaç (Mirditë)

343.811(496.5) "1945/1990" (082)

ISBN 9789928368379



9

789928

368379

